

**Konventa ndërkombëtare mbi
eliminimin e të gjitha formave të
diskriminimit racor**

Udhërrëfyes për OJQ-të

KONVENTA NDËRKOMBËTARE MBI ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT RACOR:

UDHËRRËFYES PËR OJQ-të

© Grupi Për të Drejtat e Pakicave dhe LNKDR 2001
Të Drejtat e Autorit.
Materiali nga ky publikim mund të riprodhohet për
mësimdhënie ose për qëllime tjera jokomerciale.
Asnjë pjesë nuk duhet riprodhuar për qëllime
komerciale pa lejen paraprakëng bartësit e të
drejtave të autorit.
Për informata më të hollësishme ju lutemi drejtohuni
GDP-së.
Një katalog për këtë publikim u bë I mundshëm nga
Libraria Britanike.
ISBN 1 897693 73 7.
Publikuar më Janar 2001.
Dizajni nga Kavita Graphics
E shtypur në letët të recikluar.

Mirënjohje

GDP dhe LNKDR dëshirojnë ta falenderojnë
përkrahjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të
Britanisë së Madhe dhe Komonuelthit, Fondacionin
Charles Stewart Mott, Ministrinë e Punëve të Jashtme
të Mbretërisë Daneze dhe të gjithë organizatat dhe
individët të cilët dhanë ndihmesë financiare ose të
ndonjë lloji tjetër për këtë publikim.
LNKDR dhe GDP I janë mirënjohës të gjithë personelit
dhe lexuesve ekspertë të pamvarur të cilët dhanë
kontributin e tyre për këtë publikim, veçanarisht
Geoffrey Gowlland dhe Ryo Onoyama (Redaktorët e
LNKDR-së) dhe Margot Salomon (MRG Programme
Coordinator) and Katrina Payne (Redaktorit të GDP-
së).

AUTORËT

Autorët e këtij doracak janë personeli i LNKDR-së. Atsuko Tanaka, Përfaqësues i LNKDR-së në KB është autori kryesor me ndihmën e Yoshinobu Nagamine dhe me një bashkëpunim të veçantë me Theo van Boven, Anëtarë i Këshillit Drejtues të LNKDR-së.

GRUPI NDËRKOMBËTARË MBI TË DREJTAT E PAKICAVE (GDP)

GDP-ja është organizatë joqeveritare ndërkombëtare e cila punën për sigurimi e të drejtave përpakicat etnike, fetare dhe gjuhësore në të gjithë botën dhe ta avancoj bashkëpunimin midis bashkësive.

GDP-ja:

- i shqyrton dhe publikon raportet mire të hulumtuara, librat dhe Letrat mbi çështjet e pakicave.
- Promovon të drejtat e pakicave nëpërmjet një avokimi direct nëpër forume ndërkombëtare dhe në biseda me qeveritë.
- Mbështetet në rrjetin global të organizatava që kanë mision të njëjtë dhe komuniteteve të pakicave për bashkëpunim në çështjet e të drejtave të pakicave.

Të gjithë porositet për këtë doracak duhet të dërgohen te GDP-ja.

Për informata më të hollësishme kontaktoni:

Minority Rights Group International
379 Brixton Road
London
SW9 7DE
UK
Tel: +44 (0)20 7978 9498
Faks: +44 (0)20 7738 6265
E-mail: minority.rights@mrgmail.org
Website: www.minorityrights.org

LËVIZJA NDËRKOMBËTARE KUNDËR TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT DHE RACIZMIT (LNKDR)

LNKDR-ja është organizatë ndërkombëtare joprofitabile, joqeveritare mbi të drejtat e njeriut që angazhohet për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në të gjithë botën. Krijon solidaritet ndërkombëtarë në mes të diskriminuarve – dhe avancoj regjimin ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut. E formuar në vitin 1988 nga një ndër pakicat më të mëdhaja në Japoni, Burakumin, LNKDR-ja është rritur që të bëhet një rrjet botëror për qytetarët e shqetësuar dhe pakicat nëpër komisonet rajonale në Azi, Amerikën Veriore, Latine dhe Evropë. LNKDR-ja është kyçur në projekte ku bëjnë pjesë pesë sfera programesh: eliminimin e racizmit dhe diskriminimit racor; mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të pakicave; përparimin e viktimave që kanë qenë nën diskriminim të shumëfishtë; ndihmesë për zhvillimin e njerëzve vendas.

LNKDR-ja ka edhe status këshillimor me Këshillin Social dhe Ekonomik të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC).

Për më shumë informata kontaktoni:

LNKDR
3-5-11 Roppongi, Minato-ku
Tokyo 106-0032
Japan
Tel: + 81 3 3586 7447
Fax: + 81 3 3586 7462
E-mail: imadris@imadr.org
Website: www.imadr.org

Fillimisht publikuar si The International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination: A Guide for NGOs, © Minority Rights Group, London, UK dhe International Movement Against All Forms of Discrimination and Racism Tokyo, Japan, 2001.

Ky edicion © ADI, Gostivar, Maqedoni 2001 Përkthimi shqip © ADI, Gostivar, Maqedoni
ISBN 9989-133-07-7

Asociacioni për Inicijativa Demokratike dhe Minority Rights Group i falemenderohen Charles Stewart Mott Foundation, European Commission i UK Department for International Development - Know How Fund për përmbajtjen e tyre financiare e projektit për përkthimin në shqip.

Përktheu: Neim Tahiri
Tirazhi: 1.000 copë

Lektura: Lulzim Haziri

Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor: Udhërrëfues për ojq-të

PËRMBAJTJA

Fjalorthi.....	i
Parathënie.....	ii
PJESA I — ICERD dhe Organi i tij Mbikqyrës	7
1. Historiku	7
2. Çka është ICERD-i ?	7
3. Organi Mbikqyrës I ICERD-it: Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD).....	11
A. Natyra e CERD-it	11
B. Ecuritë e punës.....	12
a) Sistemi i raportimit.....	12
b) Ankesat Ndër-Shtetërore.....	13
c) Komunikimet individuale.....	13
C. Procedurat novative të mëtutjeshme.....	14
D. Ndikimi i ICERD-it mbi shtetet	16
PJESA II — Kontributi i OJQ-ve për punën e CERD-it	17
1. Procedura e Raportimit.....	17
A. Hapat që duhet të ndërmerren para se CERD-I ta marrë në konsiderim raportin e shtetit..	17
B. Gjatë shqyrtimit të raportit	21
C. Pas mbledhjes – hapat e ardhshme.....	22
2. Ecuritë individuale të komunikimit sipas Nenit 14 të ICERD.....	23
3. Aktivitete tjera që OJQ-të dëshirojnë ti marrin parasysht.....	26
Shtojcat	27
Shtojca I: Statusi i Konventës	27
A. Shtetet anëtare të ICERD-it, që nga 16 nëntor 2000	27
B. Deklaratat shteteve anëtare në ICERD	27
C. Ankesat individuale të marra parasysht nën ecurinë e paraparë në Nenin 14 të ICERD-it që nga 11 nëntori 2000.....	29
Shtojca II: Një format mustër për komunikata/ankesa	30
Shtojca III: Rekomandimet e Përgjithshme të miratuara nga CERD.....	31
A. Lista e Rekomandimeve të Përgjithshme.....	31
B. Tekstet e plota të Rekomandimeve të Përgjithshme.....	31
Shtojca IV: Tekstet e plota të deklaratave të miratuara nga CERD.....	45
Shtojca V: Teksti i ICERD-it.....	45
Shënime.....	52
Bibliografia e zgjedhur.....	54
Gjetja e dokumenteve dhe informatave në Internet.....	55
Adresa të dobishme.....	56

Fjalorthi

CERD-i — Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit Racor është një organ ekspert i cili është përgjegjës për mbykqyrjen e implementimit të përcaktimeve të ICERD-it nga shtetet anëtare.

Konkludimet — këta sigurojnë pikpamje kolektive dhe vlerësime për CERD-in në lidhje me paraqitjen e një raporti të shtetit anëtar. Konkludimet e kanë formatin e: hyrjes, faktorët dhe vështirësitë që e pengojnë implementimin e Konventës, aspektet pozitive, temat kryesore të brengosjes dhe sugjerimet dhe rekomandimet.

Masat e Hershme Paralajmëruese — këta u paraqitën në rendin e rregullt të ditës të CERD-it në vitin 1994. Ata synojnë që ti parandalin problemet ekzistuese që të eskalojnë në konflikte dhe përfshijnë masa për ndërtimin e besimit që të identifikoj dhe përkrah atë çka e forcon dhe përforcon durimin racor, Veçanarisht ta parandaj rifillimin e konflikteve paraprake.

Asambleja e Përgjithshme — Asambleja e Përgjithshme është organi deliberativ kryesor i Kombeve të Bashkuara e cila përbëhet prej anëtarëve të të gjithë shteteve anëtare dhe secili anëtarë ka të drejtë një vote. CERD- raporton një herë në vit, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, para Asamblesë së Përgjithshme për aktivitetet e veta, si dhe për sugjerimet (Konkludimet e Sqarimeve) dhe Rekomandime të Përgjithshme të cilat i miraton në bazë të shqyrtimit të raportit dhe informatave të pranuar nga shtetet anëtare.

Rekomandimet e Përgjithshme — këta janë përpiluar nga CERD-ti që të bëj interpretimin e përmbajtjes së neneve të ICERD-it. Edhe pse këta nuk janë obliguese ligjësisht, Rekomandimet e Përgjithshme kanë rëndësi të madhe dhe qëllimi i tyre është që t'u jape udhëzime shteteve anëtare për obligimet e tyre nën Konventën.

ICERD-i — Konventa Ndërkombëtare Për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor është njëra ndër gjasht marrëveshjet më të mëdhaja për të drejtat e njeriut e miratuar nga KB dhe ndër të parat që kanë formuar mekanizmin për mbikqyrje. ICERD-i është mjete ligjor ndërkombëtar më gjithëpërfshirës që merret me diskriminimi racor, e cila definohet si çfarëdo dallimi, mospërfshirje, kufizimi ose parapëlqimi në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes ose përkatësisë kombëtare ose etnike e cila ka për qëllim shfaqimin e njohjes, kënaqësisë ose ushtrimeve, në një rreth të barabart të të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut në sferën politike, ekonomike, sociale, kulturore ose të ndonjë sferë tjetër të jetës publike (neni 1.1). ICERDI ka 156 shtete anëtare (që nga shtatori 2000).

OJQ-të — organizatat joqeveritare janë organizata të pamvarura, jokomerciale, të cilat nuk janë të themeluara ose pronësi e qeverive ose organeve ndër qeveritare.

Mandati i tyre mund të jetë ndërkombëtar ose të vendit dhe synimet dhe aktivitetet e tyre mund të përfshijnë një hapësirë të gjërë të interesit të opinionit (p.sh. të drejtat e njeriut, mbrojtja e ambientit).

OJQ-të synojnë të sjellin ndryshime në fushëveprimin e tyre.

OJQ-të në status këshillimorë me Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) — dobite e statusit këshillimorë përfshijnë: qasje të lehtë deri te burimet informative në KB dhe pjesëmarrje në organe të ndryshme të KB-ve, si edhe në konferenca të mëdhaja ndërqeveritare. Një numër i madh i OJQ-ve kontribuojnë në punën e KB-ve duke siguruar informata dhe shkathtësi të dobishme dhe duke ofruar kontribut në hartimin e standardeve të reja ndërkombëtare.

Ecuria e Shqyrtimit — kjo u paraqit në agjendën e rregullt të CERD-it në vitin 1991me qëllim të shqyrtimit të implementimit të Konventës në raste kur raporti i ndonjë shteti vonohet për së tepërmi, duke e shfrytëzuar raportin paraprak të atij shteti dhe duke I marrë parasysh infotmatat tjera të rëndësishme.

Shtetet Anëtare — shtete të cilat e kanë ratifikuar ose kanë dhënë pëlqimin për ndonjë Konventë

Ecuritë urgjente — këta u paraqitën në agjendën e rregullt të CERD-it në vitin 1994 dhe iu përgjigjen problemeve që kërkojnë kujdes të menjëhershëm për parandalimin ose kufizimin e shkeljes së një numri serioz të Konventës. Nëpër këta ecuri, CERD-i e shqyrton gjendjen pa asnjë raportit periodik nga shteti anëtar në fjalë.

ICERD: UDHËRRËFYES PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Parathënie

Në vitin 1998 KB e festuan 50 vjetorin e miratimit të Deklaratës Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut. Ai festim ishte një moment i duhur historik anë e kënd botës për rifillimin e përpjekjeve për plotësimin e qëllimeve të Dekadës së Tretë të Luftimit të Racizmit dhe Diskriminimit Racor të KB-ve (1993—2003) dhe të Programit të ndryshuar Për Veprim për Decenien. Në këtë drejtim, Asambleja e Përgjithshme e KB-ve në mbledhjen e 52-të në vitin 1997 mori vendim që të konvokoj Konferencën e Tretë Botërore Kundër Racizmit, Diskriminimit Racor, Ksonofobinë dhe Jotolerancën e cila do të mbahej jo më vonë se viti 2001.

Në mesin e organizatave të shumta ndërkombëtare dhe kombëtare që e kanë shfrytëzuar mundësinë e tillë për veprim të rifilluar ka qenë Lëvizja Ndërkombëtare Kundër Diskriminimit dhe Racizmit (IMADR ose shqip LNKDR), OJQ-ja ndërkombëtare që lufton kundër diskriminimit racor dhe racizmit dhe Grupi Ndërkombëtar mbi Drejtat e Pakicave (MRG ose shqip GDP), OJQ-ja ndërkombëtare që punon për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe bashkpunimin ndërmjet komuniteteve.

Në nëntor të vitit 1998, IMADR-i, duke e pranuar rëndësinë e bashkëpunimit midis nivelit ndërkombëtar dhe atij lokal, filloi me Fushatën Ndërkombëtare për Eliminimin e Racizmit dhe Diskriminimit Racor 2001 (ICR 2001) për zbatimin efikas të programës për veprim dhe konvokimit të suksesshëm të Konferencës Botërore Kundër Racizmit. Në kornizën e ICR 2001, IMADR-i tenton të formojë një forum në të cilën OJQ-të do të mund ta ndanin përvojën e tyre dhe të pëfitojnë dijëni tjera për mjete që përdoren kundër diskriminimit, veçanarisht për Konventën Ndërkombëtare të vitit 1965 mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (ICERD).

Qysh në vitin 1998, MRG-ja ka krijuar dhe filluar me implementimin e Programit për Veprim rreth Konferencës Botërore dhe dhe ngjarjet përgatitëse, të cilët synojnë të përfitojnë dukshmëri dhe të promovojnë veprim për çështjet lidhur me diskriminimin, mospërfshirjen dhe disfavorin nga të cilat vuajnë pakicat në tërë botën.

Puna e MRG-së përqëndrohet në parimet e pjesëmarrjes dhe pronësisë së ecurive të Konferencës Botërore kundër Racizmit nga pakicat e margjinalizuara, kurse në një periudhë më të gjatë të punës përqëndrohet drejt zbatimit të përcaktimeve të ICERD-it — veçanarisht për ata që kanë të bëjnë me mospjesëmarrjen, duke përfshirë edhe mospërfshirje në ekonomi dhe margjinalizimin e pakicave dhe popujve vendas. MRG-ja synon të zhvilloj një program për veprim drejt dukshmërisë dhe

efikasitetit më të madh për mekanizmat ndërkombëtare dhe kombëtare për implementimin e ICERD-it.

Është në rregull ti zbatosh këta qëllime — dhe në kornizën e zmadhimit të bashkëpunimit midis IMADR-it, MRG-së dhe OJQ-ve tjera — se është identifikuar nevoja për zhvillimin e mjeteve për activistët, për hyrje dhe shfrytëzim të standardeve dhe mekanizmave ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e të drejtave. Ky doracak synon të sqaroj dhe analizoj punën e Komisionit Për Eliminimin të Diskriminimit Racor të KB-ve (CERD) dhe tu ndihmoj OJQ-ve dhe aktivistëve tjerë të cilët dëshirojnë të zhvillojnë fushata për mbrojtje nga diskriminimi.

Disa OJQ mund të dyshojnë në dobinë e një doracaku që nxit përdorimin e organeve të KB-ve si një mjet. Ata ndoshta kanë qenë të zhgënjyer nga proceset e gjata dhe mungesa e ndikimit të tyre në ndonjë situatë me të cilën merren ata dhe kështu parapëlqejnë tu shmangen ndërlikimeve të mekanizmave të KB-ve.

Involvimi i CERD-it sigurisht se nuk është mënyra e vetme që ti ndryshojë modelet e diskriminimit; ajo ka potencial, por, të jetë instrumentale që të ndikoj në plitikat dhe praktikata e qeverive. Komisioni poashtu është një mjet i rëndësishëm për ndërtimin e vetëdijës dhe shtypjes në nivelndërkombëtarë dhe t'u tërheq vërejtjen problemeve me të cilët ballafaqohen grupet ose individët. Të kesh dijëni për Konventën dhe punën e Komisionit do të thotë të kesh një mjet të fuqishëm për OJQ-të për fushatat dhe aktivitetet e tyre që i bëjnë për mbrojtjen e të drejtave.

Ky doracak ka dy qëllime: e para, tentojmë të sqarojmë duke u orvatur ta shmangim zhargonin ligjor, cilat janë përcaktimet kryesore të Konventës, dhe të hedhim pak dritë te ecuritë e punës së CERD-it; e dyta, ne sugjerojmë se çfarë roli mund të luajnë OJQ-të duke përfshirë edhe në punën e CERD-it dhe si OJQ-të mund ta shfrytëzojnë Konventën si një mjet efektiv për luftën kundër diskriminimit dhe racizmit.

ICERD: UDHËRRËFYES PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE

Dokumentet zyrtare të KB-ve dhe mendimet e ekspertëve të Komisionit lidhur me punën e OJQ-ve do të përmenden nëpër tërë doracakun. Poashtu edhe përvoja e OJQ-ve me CERD-in do të ilustrohet duke përdorur raste konkrete.

Dke pasur parasysh llojllojshmërinë e OJQ-ve në tërë botën, ky doracak nuk mund të jap udhëzime të plota për të gjithë masat e mundshme dhe rrugët të cilët mund të happen për të gjithë OJQ-t. Çdo OJQ përdor politikën e vet, mandatet, stilet dhe burimet; rrethet sociale dhe plitike në të cilët veprojnë OJQ-t janë shumë të ndryshme. Sugjerimet dhe rekomandimet e paraqitura në këtë doracak duhet të jenë një piknisje për konsiderime dhe veprime të mëtutjeshme; Do të varet

nga OJQ-ja individuale që ti zhvilloj këta më tutje dhe të përpilojnë strategji të tyre personale.

IMADR-i dhe and MRG-ja shpresojnë se ky doracak do të jetë i dobishëm për të gjithë ata që luftojnë kundër diskriminimit dhe racizmit kudoqoftë në botë.

*Lëvizja Ndërkombëtare Kundër Të Gjitha
Formave Të Diskriminimit Dhe Racizmit*

*Grupi Ndërkombëtarë Mbi Të Drejtat e Pakicave
Nëntor 2000*

Pjesa 1 – ICERD-i dhe organi i tij mbikqyrës

1. Historiku

Për shumë vite, lufta kundër diskriminimit racor ishte e lidhur ngushtë me antikolonializmin.

Në luftën për pavarësi politike, popujt ndër dominimin kolonial i akuzonin fuqitë koloniste për ushtrim të diskriminimit racor.

Termi diskriminim racor më shumë u drejtoheshte njerëzve të bardhë për shkak të diskriminimit të zezakëve. Kjo e shpjegon atë se pse fjala race ende përdoret në lidhje me ngjyrën e lëkurës, edhe pse mund të konsiderojmë se kjo fjalë tani është vjetërsuar ose shkencëtarisht është e pasaktë.

Në vitet e 50-ta 60-ta dhe 70-ta, me hyrjen e shteteve të Jugut në KB, KB-të zhvilluan norma ligjore dhe politike të konsiderueshme nëpërmjet disa instrumenteve si psh, Deklarata për Dhënie Pavarësi Shteteve dhe Popujve që ishin koloni (1960) dhe Deklarata Për Eliminimin e Të Gjitha Formave Të Diskriminimit Racor (1963). Megjithatë, duhet të përkujtohem se justifikimi i shumicës që qëndronin pas miratimit të këtyre deklaratave ishte që ti japin fund praktikave diskriminuese në shtetet tjera dhe u injorua fakti se diskriminimi mund të ekzistojë edhe mbrenda në vend .

Me paraqitjen e aparthejdit si një politikë dhe praktikë e institucionalizuar në Afrikën Jugore, dënimi unanim i pothuajse të gjithë shteteve çoi kah një hap të rëndësishëm përpara në luftën kundër diskriminimit. Ekzistonte bindja se praktikrat raciste të një shteti mund të jenë brendë legjitime e të tjerëve dhe në këtë mënyrë, e bënin kufizimin e parimeve të sovrenitetit kombëtarë. Pikërisht në këtë kontekst historik në vitin 1965 u miratua Konventa Për Eliminimin e Të Gjitha Formave Të Diskriminimit Racor (ICERD) nga Asambleja e Përgjithshme duke u referuar qartë për apartheidin në Nenin 3.

Në rast se paraqitej ndonjë regjim racist zyrtar si psh. apartheidi, shtetet e kishin lehtë të gjejnë konensus për ta dënuar. Kjo mundësoi që t'u siguroj KB-ve me një instrument të rëndësishëm për mposhtjen e diskriminimit Brenda shtetit. Mirëpo, në vitet e 70-ta dhe 80-ta, shtetet nuk kishin dëshirë të madhe të mbështeten te ICERD-i sepse nuk dëshironin të zbuloheshin para shteteve tjera, OJQ-ve, bile edhe para qytetarëve të vet për shkak të kritikave që mund të pasonin.

Mirëpo, sot, shohim një rilindje të ICERD-it dhe mund të përfitojë më shumë rëndësi në të ardhmen: diskriminimi fuqimisht gërshetohet me çështje sikurse marginalizim ekonomik, kriza financiare, migrim, fluks të refugjatëve, kontrabandë me njerëz, etj. Shkelja e të

drejtave të njeriut në një shtet lehtë mund të bëhet bringë serioze për të tjerët; fluksi masiv i refugjatëve, për shembull, mund të jetë pasojë e politikës diskriminuese të ndonjë qeverie kundër ndonjë grupi etnik ose spastrim etnik. Në raste të tilla, shtetet tjera mund të kenë interes legjitim për përqëndrimin e vëmendjes së bashkësisë ndërkombëtare për evidencën e dobët për të drejtat e jeriut në atë shtet të veçantë. Këtu CERD-i mund të veprojë si një sistem i rëndësishëm paralajmërues. Involvimi i një numri të mirë të OJQ-ve në luftën kundër diskriminimit poashtu mund të kontribuojë për një zbatim më efektiv të ICERD-it. Siqë do të bisedohet më vonë, OJQ-të mund ti bindin qeveritë tu përmbahen më së afërmi standardeve të ICERD-it dhe ta publikojnë punën e CERD-it.

2. Çka është ICERD-i?

ICERD-i mendohet të jetë instrumenti i vetëm ligjor dhe ndërkombëtarë i cili konkretisht iu adresohet çështjeve gjithëpërfshirëse të diskriminimit racor. ICERD-i ka themeluar një organ ekspertësh prej 18 ekspertëve të pavarur të cilët janë përgjegjës për mbikqyrjen e implementimit të përcaktimeve/klauzulave të Konventës. Një ndër aspektet kryesore të ICERD-it është raportimi i të drejtave jo vetëm të individëve por edhe ato kolektive, si është paraqitur, për shembull në Nenin 2 (a): çdo shtet anëtarë ndërmerr hapa që të mos ushtroj diskriminim racor kundër personave, *grup personash* ose institucionesh (kursivi i shtuar). Kjo është e rëndësishme në veçanti për pakicat dhe popujt vendas të drejtat kolektive të të cilëve shpesh diskrimohen. Gjatë ratifikimit ose hyrjes në ICERD, çdo shtet anëtar merr obligim që të dorëzojë raporte periodike te CERD-i, ose me kërkesë të CERD-it, në lidhje me masat që shteti i ka marrë për zbatimin e Konventës. (Hollësi për ecuritë e raportimit të ndonjë shteti janë dhënë më tutje në këtë doracak).

Me qëllim që tu ndihmoj shteteve anëtare në implementimin e obligimeve të tyre të parapara me Konventën, CERD-i paraqet disa sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme (të njohura si Rekomandime të Përgjithshme), të cilat janë paraqitur në Nenin 9.2 të ICERD-it dhe bazohen në shqyrtimin raporteve të shteteve anëtare. Rekomandimet e Përgjithshme zakonisht propozohen kur Komisioni nuk është në gjendje të gjej informata të mjaftueshme për nenet konkrete të ICERD-it e cila është e dobishme për Komisionin për konstatimin e fakteve të ndonjë raporti dhe në sublimimin e pikpamjeve të tyre. Këta Rekomandime të Përgjithshme i mundësojnë Komisionit dhe shteteve anëtare ti kuptojnë më mire llojet e çështjeve dhe problemeve ne të cilët ballafaqohen shtetet kur mundohen ti zbatojnë në praktikë formulacionet ligjore që i përmban ICERD-i. Rekomandimet e Përgjithshme mundet poashtu t'u ndihmojnë OJQ-ve që ta kuptojnë rëndësinë dhe nënkuptimin e klauzulave të ndryshme të Konventës. Megjithatë, ata nuk janë ligjësisht obliguese për shtetet anëtare. Përveç

Rekomandimeve të Përgjithshme, Udhëzime të Përgjithshme Lidhur me Format dhe Përmajtjen e Raporteve të cilat duhet të Dorëzohen nga Shtetet Anëtare sipas Nenin 9 paragrafi 1, e ICERD-it, e miratuar nga CERD, shërbejnë për implementimin efikas të kushteve të Konventës.

Konventa është e ndarë në dy pjesë: e para, e paraqitur me preambullë, i paraqet obligimet ligjore të shteteve anëtare; dhe e dyta e përshkruan përbërjen e Komisionit i cili e mbikqyr implementimin e Konventës nga ana e shteteve anëtare dhe metodat e tij. Në pjesën që vijon, në pjesën e parë (Nenet 1—7) është bërë një përmbledhje me komente dhe informata tjera për historikun, duke u bazuar në Rekomandimet e Përgjithshme të miratuara nga CERD-i. Në pjesën I do ta sqarojmë pjesën e dytë, pjesa 3 e këtij doracak, në cilën bëhet fjalë për evolucionin dhe novacionet e metodave të CERD-it. Teksti i plotë i Rekomandimeve të Përgjithshme si edhe për ICERD-in është dhënë nëpër Shtojcat e këtij doracak.

Neni 1—Definicioni për diskriminimin racor

Neni 1, paragrafi 1, e definon konceptin e diskriminimit racor si:

Cfarëdo dallimi, mospërfshirje, kufizim ose anësi e bazuar mbi racën, ngjyrën, prejardhjen ose përkatësinë etnike ose kombëtare e cila ka për qëllim shfuqizimin ose efektin e keqësimit të njohjes, kënaqësisë ose ushtrimit, në një drejtëpeshë të barabartë të të drejtave njerëzore dhe lirive fundamentale në sferën politike, ekonomike, sociale kulturore ose në çfarëdo sferë tjetër të jetës publike (theksi i shtuar).

ICERD-i DHE ORGANI I TIJ MBIKQYRËS

Definicioni i ICERD-it vlen të përmendet veçanarisht për sa i përket justifikimit të mosdiskriminimit të cilat shkojnë mbi kontekstin e kolonializmit dhe dominimit nga të bardhit me të cilën parapakisht merej Konventa dhe përveç races dhe ngjyrës i përfshinë edhe prejardhjen dhe përkatësinë etnike dhe kombëtare. Prandaj diskriminimi racor sikurse është definuar në ICERD mbulon një sipërfaqe të gjërë diskriminimeve, duke i përfshirë edhe ato diskriminime kundër pakicave dhe popujve vendas. Për shembull, edhe pse India e mban qëndrimin se ICERD-i nuk është i zbatueshëm për diskriminimin e kasteve por vetëm për diskriminimin racor, Komisioni e ka pranuar mendimin se termi prejardhje në nenin 1.1 nuk i referohet vetëm races dhe se Kastet i takojnë sferës së Konventës.³

Komiteti në Rekomandimet e Përgjithshme potencon XXIV (55) se disa Shtete Anëtare vendosin sipas vlerësimeve të veta për atë se cilët grupe janë frupe etnike ose popuj vendas që duhet pranuar dhe trajtuar si të tillë. Mirëpo, Komisioni është i mendimit se:

Përdorimi i kritereve të ndryshme dhe joobjektive me qëllim të caktimit të grupeve etnike ose popujve vendas, që çojnë kah pranimi i disave dhe refuzimi i disa të tjerëve, mund të ndodh që të shfaqet pakënaqësi nga grupet e ndryshme brenda shtetit për shkak të trajtimit të ndryshueshëm.

Mendimi i CERD-it është se identifikimi i individeve si anëtarë të ndonjë grupi të caktuar etnik ose racor, nëse nuk ekziston arsyetim i kundërt, duhet të bazohet mbi vetidentifikimin nga individët për të cilën bëhet fjalë. Lidhur me këtë, Komisioni konsideron se karakteristikat etnike të ndonjë populli janë të një rëndësie të veçantë gjatë shqyrtimit të raporteve të shteteve, dhe kështu nga shtetet anëtare kërkon që të japin informata për gjuhën e parë të popujve si një tregues për dallimet etnike, së bashku me ndonjë informatë tjetër për racën, ngjyrën, prejardhjen, përkatësia kombëtare dhe etnike, që mund të marin nga anketimet sociale ose regjistrimet e popullsisë. Përfshirja e informatave për gjendjen e gruas poahstu konsiderohet e rëndësishme për Komisionin që të shqyrtoj nëse diskriminimi racor ndikon ndryshe mbi gratë dhe burrat.⁶

Nenet 1.2 dhe 1.3 të ICERD-it, i lejojnë shtetet anëtare të bëjnë dallime, përjashtime, kufizime ose favorizime midis qytetarëve dhe joqytetarëve dhe ta interpretoj Konventën se nuk ndikon te ligji për nënshtetësi, kombësi ose marrjen e nënshtetësisë me kusht që ata të mos diskriminojnë asnjë kombësi.

Megjithatë, CERD-i është i mendimit se Konventa në përgjithësi është poashtu e aplikueshme edhe kundër diskriminimit të emigrantëve dhe të huajve. Ky interpretin ka lindur si rrjedhojë e praktikës në shumë shtete, veçanarisht në Evropë, në të cilat kriteri për dallim midis qytetarëve dhe të huajve duket se ndjek modele etnike dhe për nga natura e mbrendshme janë diskriminuese. Sipas kësaj, në Rekomandimin e Përgjithshëm. Komisioni kërkon që shtetet anëtare tërësisht të japin raport në lidhje me legjislacionin për të huajt dhe zbatimin e tij. Poashtu Komisioni është i mendimit se Konventa nuk duhet të interpretohet se i zvoglon të drejtat dhe liritë e secilit të njohura në instrumente tjera, veçanarisht Deklarata Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut, Kontrata Ndërkombëtare për Të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike dhe Qytetare (ICCPR). Ky konstatim është poashtu në përputhje me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 40/144 të 3 dhjetorit 1985, e cila njih se mbrojtja e të drejtave të njeriut duhet të sigurohet edhe për të huajt jo vetëm vendasit. Neni 1.2 ka të bëjë me pozitat dhe situatat ku dallimi midis qytetarëve dhe të huajve funksionon, si psh. në raste kur disave zyra publike u jipen të drjeta politike të caktuara. Duhet të theksohet se Konventa përfshinë edhe akte rrjedhoja e të cilëve mund të çoj pa qëllim drejt diskriminimit sikurse është paraqitur në nenin 1.1 e cila i referohet qëllimit ose efektit të shfuqizimit ose keqësimit. Shemull konkret është abolicioni i politikës për migrim tre-qarqesh në

Zvicër që u bë paradokohe, që i kategorizonte të huajt në bazë të përkatësisë kombëtare. Kur raporti fillestar i Zvicrës shyrtohej nga CERD-i në mars të vitit 1988, qeveria argumentonte se politika a saj për migrim në asnjë mënyrë nuk ka qenë diskriminuese dhe racore. Mirëpo, Komisioni konsideroi se koncepti dhe pasoja e kësaj politike ka qenë e njollohur dhe diskriminuese dhe kundër parimeve dhe klauzulave të Konventës. CERD-i e vërtetoi këtë në Rekomandimet e Përgjithshme të tij (42) kur theksoi se dallimi është kundër Konventës nëse ka për qëllim ose pasojë dëmtimin e të drejtave dhe lirive të caktuara.

ICERD: UDHËRRËFYES PËR ORGANIZATAT JOQEVERTITARE

Më tutje, me qëllim të arritjes jo vetëm të barabarsisë racore *de jure* por edhe barabarsinë *de facto*, Neni 1.4 i Konventës lejon masa të veçanta si psh veprime pohuese (ose diskriminim pozitiv) për të mirën e grupeve ose individeve racor ose etnik të marginalizuar. Këta masa konsiderohen të jenë legjitime me kusht që:

Masat e tilla të mos çojnë kah mirëmbajtja e të drejtave të veçanta për grupe të ndryshme dhe se ata ndërpriten pasi të arrihen qëllimet a parapara.

Mirëpo, një veprim gjykohet i kundërt me Konventën kur ka ndikim të paarsyetueshëm dhe të ndryshueshëm mbi një grup që dallohet nga raca, ngjyra, prejardhja ose përkatësia etnike ose kombëtare. ¹⁰ (shih poashtu Nenin 2.2 të ICERD-it).

NENI 2 —Obligimi për eliminiimin e diskriminimit dhe promovimin e mirëkuptimit

Spas Nenit 2.1, shtetet anëtare kanë obligim jo vetëm të sigurojnë se të gjithë institucionet dhe pushteti, local dhe nacional, nuk e praktikojnë diskriminimin racor, por edhe të marin masa efikase ti rishqyrtojnë politikatat shtetërore, nacionale dhe locale dhe ti ndryshojnë, anulojnë ose shfuqizojnë të gjithë ligjet ose dispozitat që krijojnë diskriminim racor. Më tutje, ata janë të obliguar ta ndalojnë dhe ti japin fund diskriminimit racor që ushtrohet nga individet ose organizatat. Ata poashtu duhet ti inkurajojnë organizatat që të jenë shumë racore. Prandaj, për sa i përket nenin 2.1, Konventa e bën të qartë se ndalimi i diskriminimit racor nuk vlen vetëm për sektorin publik por edhe për individet dhe grupet ose organizatat që meren psh me arsimim dhe aftësim, punësim, shërbimi shëndetësor, ndërtimi banësor dhe pjesëmarrja në aktivitete kulturore. Shpesh është vërejtur se shumë shtete ende nuk kanë mare veprime të mjaftueshme ta ndalojnë diskriminimin në këta fusha. Në nenin 2.2, Konventa përsëri i përmend masat speciale që duhet të ndërmeren në sferën sociale, ekonomike, kulturore dhe sferat tjera, në rrethana të tilla, që të siguroj zhvillimin dhe mbrojtjen adekuate të grupeve racore të marginalizuara ose individeve. Sipas nenit 2, është e rëndësishme që shtetet anëtare të raportojnë hollësisht për politikatat dhe praktikatat ekzistuese,

funkcionet e institucioneve publike, pushtetit dhe ligjet relevante dhe horizonti i legjislacioni në fuqi. Po aq e rëndësishme është edhe përshkrimi i ndonjë programi të miratuar të veçantë dhe projektet e filluara në shtetin që raporton dhe si ato ndikojnë në qëllimin për arritjen e barazisë racore midis të gjithë segmenteve të popullatës.

Duke pranuar se:

Plotësimi i këtyre obligimeve varet shumë nga mbajtësit e rendit të një kombi të cilët i ushtrojnë kompetencat policore, veçanarisht kompetencat për mbajtje në arrest ose arrestim dhe poashtu varet nga ajo se a janë të njohuar në mënyrë të duhur për obligimet e Konventës

se Komisioni e potencon në njërin prej Rekomandimeve të tija të Përgjithshme rëndësinë për një stërvitje intenzive të policëve që të sigurojnë se ata e respektojnë por edhe mbrojnë dinjitetin njerëzor.¹¹

NENI 3 —Segregacioni racor dhe *apartheidi*

Neni 3, i cili i referohet *apartheidit*, fillimisht mund të ketë qenë drejtuar veçanarisht në Afrikën Jugore. Mirëpo, Komisioni e bën të qartë se ky nen i ndalon të gjitha format e segregacionit/ndarjes në të gjitha shtetet, me ose pa iniciativë ose involvim direkt nga pushteti.¹²

Komisioni konstaton se:

derisa gjendja për segregacion racor të plotë ose të pjesërishtë mundet të ketë qenë e krijuara në disa shtete nga politikata e qeverisë, një gjendje e segregacionit të pjesërishtë mund të paraqitet edhe si pasojë e paqëllimtë nga veprimi i personave privat. Në shumë qytete modelet e banimit ndikohen nga dallimet grupore, të cilat disa here kombinohen me dallimet racore, ngjyrën, prejardhjen, përkatësinë etnike ose kombëtare, kështu që banorët mund të njollohen dhe individët vuajnë nga një formë të diskriminimit në të cilën bazat racore janë të përziera me baza tjera.¹³

NENI 4 —Propaganda Raciste, organizatat dhe aktivitetet

Shpesh herë Komisioni ka theksuar në Rekomandimet Rekomandimet e Përgjithshme rëndësinë kulmore të Nenit 4, i cili përmban klauzula që janë të karakterit obligues.¹⁴ Në bazë të këtij Neni dhe Rekomandimet e Përgjithshme relevante, shtetet anëtare kanë obligim ta miratojnë legjislacionin për dënimin e veprimeve vijuese: (i) propagimin ideve të bazuara në dominim racor dhe urrejtje; (ii) nxitje të diskriminimit racor; (iii) vepra të dhunës kundër çdo race ose grupi të njerëzve të ngjyrës ose përkatësisë tjetër etnike; (iv) nxitje për akte të tilla dhe (v) dhënie ndihmë, duke përfshirë edhe atë financiare për aktivitete racore. Më tutje, organizatat, si edhe aktivitetet e tyre dhe propaganda të cilën e promovojnë ose nxisin diskriminim racor duhet

të shpallen jo të ligjshme dhe të ndalohen. Ti takosh një organizate të tillë dhe të marrish pjesë në aktivitete të tilla është poashtu shkelje e ligjit. Neni (c) i nënvizon obligimet që e detyron pushtetin në të gjitha nivelet administrative, duke përfshirë edhe nivelin komunal. Zbatimi i plotë i Nenit 4 është i ndërlikuar në shumë shtete, të cilën shtetet e konsiderojnë këtë si klauzulë që paartëtim e kufizon lirinë e shprehjes dhe lirinë e shoqërimit. Mirëpo, Komisioni pohon se të drejtat e lirisë së mendimit, shprehjes dhe shoqërimit, nuk janë absolute, por u nënshtrohen disa kufizimeve. Në Rekomandimin e Përgjithshëm të XV (42), Komisioni e shpreh mendimin se ndalimi i propagimit të të gjithë ideve që bazohen në dominim racor ose urrejtje është në pajtim me të drejtën për lirinë e mendimit dhe shprehjes, duke e marrë si shembull klauzulën se obligimet e Nenit 4 duhet të plotësohen me përfillje të duhur të parimeve të paraqitura në Deklaratën Univerzale mbi të Drejtat Njerëzore (Neni 19) dhe të drejtat qartë të parapara në Nenin 5 të kësaj Konvente (fjalë e parë e Nenit 4), e cila duhet të kuptohet si një referim për lirinë e shprehjes dhe lirinë e asociimit. Më tutje, Komisioni e drejton vëmendjen e shteteve anëtare kah Neni 20 i Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejta Politike dhe Qytetare e cila kërkon që shtetet të ndalojnë me ligj çfarëdo lloji të mbrojtjes së urrejtjes nacionale, racore ose fetare e cila krijon nxitje të diskriminimit, armiqësi ose dhunë. Sidoqoftë, një numër shtetesh, kryesisht nga Perendimi, dhanë disa deklarata interpretative për ratifikimin e Konventës duke theksuar përfilljen e duhur të klauzulës. Një deklaratë e tillë përdoret nga ndonjë shtet që ta përcjell mendimin dhe interpretimin e vet për këtë klauzulë. Këtu duhet të bëhet dallim nga të treguarit reserve për një ligj ndërkombëtar me të cilin shteti kur firmos ose ratifikon ndonjë Konventë ose marrëveshje ndërkombëtare, nuk jep pëlqim për një ose më shumë klauzula të marrëveshjes

Rast i rëndësishëm – dënimi i Jersildit, gazetar Danez¹⁵

Ky rast i ilustron tendosjet që ekzistojnë midis klauzulave të Nenit 4 dhe e drejta për liri të shprehjes.

Jersildi, gazetar danez, u gjykua nga Gjyqi Danez sipas Nenit 266 (b) të Kodit Penal¹⁶ i cili ishte jetësuar në Danimarkë për zbatimin e Nenit 4 të ICERD-it, së bashku me Nenin 23 të Kodit Penal.¹⁷ Në një emitim televiziv, gazetari kishte intervistuar tre anëtarë të një grupe raciste, 'the Greenjackets (ose shqip Xhaketat e Gjelbërta)', dhe ishte akuzuar për shkak se u kishte ndihmuar dhe mbeshtetur duke u lejuar madje edhe inkurajuar deklarata shumë ofenduese dhe raciste kundër të huajve dhe zezakëve. Gjyqet daneze konstatuan se veprimet e gazetarit rezultuan në një publikim të deklaratave raciste të dhëna nga një numër i vogël njerëzish. Liria e shprehjes, sipas mendimit të gjyqeve, nuk ishte një bazë e arsyetueshme që ta shfajësojnë gazetarin. Në

shqyrtimin e raportit të Danimarkës në vitin 1990, disa anëtarë të CERD-it pohuan se janë shumë të kënaqur me rezultatet e rastit, duke theksuar se ishte 'deklarata më e qartë deri tani, në një shtet, se e drejta për mbrojtje kundër diskriminimit racor ishte në rend të parë se sa liria e shprehjes'.¹⁸ Jersildi e sollti rastin para Gjyqit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i cili vendosi se e drejta e gazetarit për liri të shprehjes është shkelur e cila garantohet sipas Nenit 10 Konventës Evropiane Për Mbrojtje të të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Fundamentale. Gjyqi poashtu theksoi se obligimet e Danimarkës sipas kësaj Konvente Evropiane duhet të përputhen me obligimet e saja sipas ICERD-it.¹⁹

Zhvillimet teknologjike lidhur me mediumet e shkruara dhe ato elektronike, veçanarisht interneti, paraqesin një sfidë të re për sa i përket zbatimit të Nenit 4 nga ana e shteteve anëtare. Shtetet anëtare duhet të sigurohen se agjensionet e lajmeve, edhe ato publike edhe private, që mbajnë përgjegjësi, duhet të respektojnë dhe jetësojnë standardet relevante. Përveç mjeteve për ballafaqimin me këtë çështje, ekziston edhe një Kod i Sjelljes për shfrytëzuesit e internetit dhe siguruesit e shërbimeve.²⁰

Neni 5 — Të drejta të barabarta

Sipas Nenit 5 të Konventës, shtetet anëtare duhet të garantojnë:

- se të gjithë grupet dhe individët — pavarësisht nga raca, ngjyra ose përkatësia nacionale ose etnike mund të kenë të drejta të barabarta trajtimi para tribunaleve dhe të gjithë organeve tjera që marrin pjesë në administrimin e drejtësisë;
- të drejtën për sigurinë e personit dhe mbrojtjen nga dhuna ose lëndim trupor, pa marrë parasysh se a është shkaktuar nga qeveria ose nga ndonjë individ ose grup;
- një seri të plotë të të drejtave politike dhe qytetare;
- një list të rëndësishme të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore;

dhe shumë me rëndësi të drejtën të hyjë në çdo vend ose shërbim që është për destinim të opinionit të përgjithshëm, duke i përfshirë edhe ato të pronës private, sikurse transporti, hotelet, restaurantet, kafenetë, teatret dhe parqet.

Nga Shtetet anëtare pritet që të raportojnë në lidhje me implementimin jodiskriminues për secilën nga këta të drejta dhe liri.

Sipas Rekomandimit të Përgjithshëm XX

(48) të CERD-it, Konventa i obligon shtetet anëtare ta ndalojnë dhe zhdukin diskriminimin racor në lidhje me kënaqjen e të drejtave njerëzore të paraqitura në Nenin 5, duke supozuar se këta të drejta ekzistojnë dhe njihen

nga shtetet në fjalë. Me fjalë të tjera, ky Nen në vete nuk i shpall dhe mbron të drejtat qytetare, politike, ekonomike, sociale ose kulturore.

Komisioni poashtu pranon se shtetet mundet të imponojnë edhe ndalesa për të drejtat e lartëparaqitura si që është e drejta të marrish pjesë në zgjedhje, të votosh ose të kandidohesh për zgjedhje, të cilat mund tu jipen vetëm qytetarëve. Mirëpo, në raste të tilla shtetet patjetër të sigurojnë se kufizimi është në përputhje me Nenin 1 të Konventës, duke e marrë parasysh edhe shkakun edhe pasojën.

Neni 6 —ndihma dhe kompensimi Gjyqësor

Shumë shpesh viktimat që iu janë shkelur të drejtat njerëzore injorohen dhe kërkesat e tyre për dëmshpërblim nuk merren me seriozitet. Gjatë ratifikimit ose hyrjes në ICERD, shtetet anëtare sigurojnë mbrojtje efikase dhe dëmshpërblime kundër veprave të diskriminimit racor nëpërmjet tribunaleve kompetente kombëtarë dhe institucioneve tjera shtetërore. Të gjithë personat që janë nën juridikcionin e shtetit anëtarë, nacional po edhe jonacional, kanë të drejtë të kërkojnë dhe pranojnë nga ato tribunale dëmshpërblim të *drejtë* dhe *adekuat* për shkak të dëmeve materiale dhe morale të vuajtura si rrjedhojë e diskriminimit të tillë.

Poashtu duhet të nënvizohet se tribunale të nacionale dhe institucionet tjera shtetërore u lejojnë shteteve anëtare një shkallë të caktuar të fleksibilitetit për sa u përket masave që duhet të ndërmerren për zbatimin e këtij Neni. Në diapazonin e këtyre masave përfshihen mekanizma të pajtimit ose ndërmjetësimit, themelimin e organeve administrative për hetime, veprime nga ministria kompetente ose nga Prokurori i Përgjithshëm, ose nga ombudspersoni, sipas sistemit administrative dhe ligjor të shtetit. Sankcionet poashtu mund të ndryshojnë sipas shkallës; duke përfshirë takime pajtuese të palëve të involvuara, vërejtje gojore ose në formë të shkruar ose imponimin e dënimeve ose ndëshkim me burg. Në pajtim me udhëzimet e përgjithshme për raportim të parapara në ICERD, sipas nenit 6 Komisioni kërkon nga shtetet anëtare, në mes tjerash, informata në lidhje me ndonjë rast gjyqi që mund të ekzistojë në lidhje me këtë Nen; dhe për praktikën e organeve tjera të shtetit lidhur me implementimin e kësaj klauzule.

Neni 7 – Arsimimi dhe Informatat

Duke e pasur parasysh luftën kundër paragjykimëve racore dhe promovimin e miqësisë, durimin dhe mirëkuptimin në mes kombeve dhe grupeve etnike, shtetet anëtare vërtetojnë sipas Nenit 7 të Konventës se do të marrin veprim të menjëhershëm dhe efikas në sferën e kulturës, arsimit, informatave dhe mësimdhënies.

Kur përmendet fjala arsim në këtë Nen, nuk do të thotë se arsimi është i kufizuar në shkollë por poashtu aty

përfshihet trajnimi, më me rëndësi trajnim për mësimdhënësit dhe profesionistët tjerë sikurse janë policët (zbatuesit e ligjit). Rekomandimi i Përgjithshëm XIII (42) i Komisionit u bën thirrje shteteve anëtare:

Ta rishqyrtojnë dhe përmirësojnë trajnimin për zbatuesit e ligjit që të implementohen plotësisht standardet e Konventës si edhe Kodi i Sjelljes i Zbatuesve të ligjit (1979).

Në Rekomandimin e Përgjithshëm XVII (42), Komisioni poashtu rekomandon që shtetet anëtare të formojnë institucione kombëtare që të shërbejnë për qëllimet vijuese, ndër të tjerat: a) të promovoj që të nderohen të drejtat e njeriut nga ku edhe zbatimi i tyre, të lira nga çfarodo diskriminimi, si që është theksuar qartë në Nenin 5 të ICERD-it; b) të rishqyrtojnë politikën zyrtare për mbrojtje nga diskriminimi racor; c) të bëjnë mbikqyrjen e ligjeve se a iu përmbahen klauzulave të ICERD; d) të arsimoj publikun për obligimet që i ka shteti anëtarë me hyrjen te ICERD-i. Më tutje, CERD-i u koston vëmendje të veçantë çështjeve si ato se a e njohtëjnë shtetet anëtare opinionin për të drejtat e njeriut në përgjithësi, për ICERD-in dhe veçanarisht CERD-i, dhe se a është përkthyer dhe shtypur ICERD-i në gjuhët vendore.²¹

Në përgjithësi, Komisioni zbulon se shtetet nuk i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme implementimit të Nenit 7 dhe informatat e dorëzuara për Nenin 7 i konsideron si të përgjithshme dhe sipërfaqësore.

3. Organi mbikqyrës i ICERD-it: Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD ose shqip KEDR)

Qysh prej fillimit ishte e qartë se Konventa do të jetë efektive nëse formohet një organ i pavarur për mbikqyrjen e implementimit të obligimeve të shteteve si që kërkohet nga ICERD-i. Për këtë qëllim, u formua CERD-i ; kjo e paraqiti modelin: pes organe kryesore të KB-ve mbi të drejtat e njeriut u formuan më vonë, me strukturë dhe funksione të krahasueshme, gjegjësisht, Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut (HRC ose shqip KDN)), Komisioni Mbi Eliminimin e Diskriminimit të Grave (CEDAW ose shqip KMEDG), Komisioni kundër Torturës (CAT ose shqip KKT), Komisioni mbi të drejtat, Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR ose shqip KDESCK)²² dhe Komisioni mbi të Drejtat e Fëmijëve (CRC ose shqip KDF).

A. Natyra e CERD-it

CERD-i përbëhet prej 18 ekspertësh me pozicion të lartë morali dhe paanësi të njohur, të cilët shërbejnë me

kapacitetin e tyre personal (Neni 8.1 i ICERD-it). Anëtarët janë me mandat prej katër vitesh në mbledhjen e shteteve anëtare (Neni 8.4 dhe 5a), dhe zgjedhjet mbahen me gjysmën a anëtarëve në intervale prej dy viteve (Neni 8.5a). Gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit, duhet të merret parasysh përfshirja e barabartë gjeografike dhe përfaqësimi i formave të ndryshme të civilizimit si edhe sistemi ligjor (Neni 8.1). Momentalisht, te CERD-i marrin pjesë një numër i madh i diplomatëve nga anëtarët e vet në krahasim me organet tjera. Meritat për këtë u takojnë perceptioneve të shumë shteteve në vitet e hershme duke menduar se ICERD-i është një instrument për politikë të jashtme sesa një dokument me nënkuptim të mbrendshëm. Edhe pse ky perceptcion është ndryshuar, praktika e emërimit dhe caktimit të ekspertëve për politikë të jashtme te CERD-i ka vazhduar. Sipas Konventës, Komisioni do ti formojë rregullat e veta të procedurës dhe nuk pranon urdhëra nga jashtë (Neni 10). Me të vërtetë, CERD-i është një trup autonom e cila është një karakteristikë e përbashkët për të gjithë organet e këtilla në përjashtim të CESC-it. Sidoqoftë, ekzistojnë lidhje organizative të forta me KB-të:

- CERD-i u formua me një Konventë të përpiluar nga Nën Komisioni i KB-ve mbi Parandalimin e Diskriminacionit dhe Mbrojtjen e Pakicave (në vitin 1999 Nën Komisioni e ndërroi emrin në Nën Komision për Avancimin dhe Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut) dhe u miratua — me anë të Komisionit Mbi Të Drejta Njerëzore dhe Këshilli Ekonomik dhe Social — nga ana e Asamblesë së Përgjithshme.
 - Momentalisht, mbledhjet e Komisionit mbahen dy herë në vit (Mars dhe gusht) që zgjat dy deri katër jave²³ te zyra e KB-ve në Gjenevë. Më tutje, Komisioni është në shërbim të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara (Zyra e Komsariatit të Lartë mbi të Drejtat e Njeriut).
 - Poashtu e rëndësishme, CERD-i raporton çdo vit për aktivitetet e veta para Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm (Neni 9.2).

B. Ecuritë e punës

CERD-i i shqyrton periodikisht hapat ligjore, gjyqësore, administrative dhe hapat tjera që i ndërmarrin shtetet anëtare që marrin pjesë te ICERD-i që ti plotësojnë obligimet e tyre në luftën kundër diskriminimit racor. Konventa siguron një numër instrumentesh për vlerësimin e përpjekjeve të shtetit dhe situatën e përgjithshme. Mirëpo mandati i tij momental nuk përfshinë që anëtarët e CERD-it të bëjnë hetimin e situates me anë të vizitës, edhe pse Komisioni mund të dërgoj një ose më tepër anëtarë të vet me thirrje nga shteti për të cilën bëhet fjalë me qëllim të dialogut më të afërt në vet vendin.²⁴

a) Sistemi i Raportimit (Neni 9)²⁵

Sipas Nenit 9 të ICERD-it dhe pas një vendimi të marrur nga Komisioni në mbledhjen e 38-të në 1990²⁶ çdo shtet anëtarë është i obliguar të dorëzojë: (a) **një raport fillestar** brenda një viti pas hyrjes në fuqi të Konventës për shtetin në fjalë, të jap informata gjithëpërfshirëse për legjislacionin ekzistues, masa gjyqësore, administrative ose masa tjera që i fuqizojnë klauzulat e ICERD-it; (b) Pastaj, **raporte të më tutjeshme gjithëpërfshirëse** çdo katër vite të cilat pritet të përmbajnë zhvillime të reja që kanë ndodhur pas dorëzimit të raportit paraprak, informata të kërkuara konkretisht nga CERD-i dhe përgjigje për pyetjet që nuk kanë qenë të përgjigjura plotësisht në raportin paraprak; dhe **raporte të shkurta me informata të reja** në dy vitet pasuese, që bukvalisht ta bëjnë azhurimin e informatave që gjinden në raportin gjithëpërfshirës; dhe (c) **raporte speciale** kur të do që të kërkojë Komisioni, të cilat për shembull kanë qenë dorëzuar nga shtetet anëtare gjendja e të cilëve shqyrtohet nga ana e CERD-it në pajtim me masat e hershme paralajmëruese dhe procedurat urgjente.

Sipas *Doracakut për Raportimin e të Drejtave të Njeriut*,²⁷

Komisioni shpreson se raporti fillestar dhe ai gjithëpërfshirës do të përmbajnë informata për: i) përmbajtjen e obligimeve nga shtetet anëtare në bazë të Nenit 1 të Konventës, ii) karakteristikat etnike të shtetit dhe iii) tekstin për ligjet e rëndësishme, vendime gjyqësore dhe dispozita që kanë të bëjnë me Nenin 1 deri 7 të Konventës.

Obligimi i Komisionit sipas Nenit 9.2 për dorëzim të raportit çdo vitë para Asamblesë së Përgjithshme për ryshqyrtimin e raporteve që i pranon nga shtetet anëtare është puna më e rëndësishme e Komisionit. Mirëpo, Neni 9, është shumë shkruar shumë gjërësisht dhe prandaj i jep Komisionit hapësirë që të paraqes risi në zbatimin e tij. Kështu, në një fazë shumë të hershme të ekzistimit të CERD-it u mor vendim që shqyrtimi i raporteve të shteteve anëtare të bëhet në praninë e shteteve anëtare që ta lehtësoj dialogun konstruktiv. Si rrjedhojë, shtetet anëtare dërgonin delegacione, zyrtarë qeveritarë, në mbledhjet e CERD-it kur raporti i tyre ishte caktuar për shqyrtim. Dokumenti themelor që është lëndë e shqyrtimit nga Komisioni është raporti i shtetit. Pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, u paraqitën risi procedurale për shqyrtimin e raporteve të shteteve anëtare:

- Emërimin e **Raportuesit të Shtetit** — si pasojë e konsultimeve joformale, anëtarët e Komisionit vetë e përgatisin shqyrtimin e raportit të shtetit anëtarë nëpërmjet një studjimi të hollësishëm në bazë të informatave relevante dhe të besueshme. Raportuesi i shtetit luan një rol udhëheqës edhe në shqyrtimin e raportit edhe në përgatitjen e konkludimeve. Në ndërkohë,

anëtarët tjerë të Komisionit janë të lirë që të japin kontributin e tyre. Nuk ekziston ndonjë grup që punon në ndonjë session paraprak te CERD-i, si ajo e formuar nga disa organe tjera për përpilimin e listës së çështjeve për shtetet anëtare raportet e të cilëve duhet të shqyrtohen në sesionin e ardhshëm të Komisioneve individuale. Sidoqoftë, Raportuesi i Shtetit mund— edhe pse rrallë — të përgatisë parakohe një list çështjesh dhe tia dërgoj shtetit që raporton si edhe anëtarëve tjerë të Komisionit.

- Përdorimi i **burimeve tjera të informimit**. Nuk merret shumë me seriozitet fakti se raporti që zyrtarisht dërgohet te Komisioni nga shteti anëtarë është burimi kryesor dhe thelbësor i informatave, por për një kohë të gjatë mbeti i diskutueshëm fakti se a mund të mbështeten anëtarët e Komisionit edhe në burime tjera të informatave. Dalëngadalë u pranua mund të mirren parasysh edhe materialet tjera që i kanë KB-të, si psh raportet nga Raportuesit Special të Komisionit të KB-ve mbi të Drejtat e Njeriut dhe raportet dhe komentet e agjensioneve të specializuara. Në vitet e paradokohshme, janë marrë parasysh informata nga institucione rajonale si psh Komisioni Evropian Kundër Racizmit dhe Jotolerancës (ECRI ose shqip KERJ) dhe poashtu nga OJQ-të dhe shpesh janë përmendur gjatë diskutimeve, edhe pse disa anëtarë të Komisionit vazhdojnë të tregojnë reserve lidhur me këtë praktikë.

Përpilimi i **Konkludimeve**. Edhe pse në të kaluarën, anëtarët individual shprehnin mendimin dhe vlerësimin *personal* në fazën e konkludimeve të shqyrtimit për raportin e ndonjë shteti anëtarë, Komisioni si organ kolektiv përmbahet nga kjo gjë. Kjo ka ndryshuar; Raportuesi i Shtetit me ndihmën e Sekretariatit e përgatit draftin e pare të konkludimeve, e cila përbëhet prej një rishqyrtimi të zhvillimeve pozitive, çështjet shqetësimeve, sugjerime dhe rekomandime konkrete. Drafti i parë u shpërndahet jozyrtarisht anëtarëve të Komisionit që të japin komentet e tyre. Raportuesi i Shtetit më vonë dorëzon draftin e dytë, i cila ka qenë i diskutuar dhe ndryshuar në mbledhje formale (publike) dhe më në fund miratohet nga Komisioni për transmetim për shtetin anëtarë në fjalë, që të bëhet një dokument publik dhe të kyçet në raportin vjetor të Komisionit. Shteti anëtar mund të dorëzojë komentet e veta gjatë konkludimit që të kyçen në raportin vjetor të Komisionit i cili do të raportohet para Asamblesë së Përgjithshme (Neni 9.2 i ICERD-it). Konkludimet janë një mjet i rëndësishëm për mbikqyrje dhe mjet efektiv për planet e ardhshme. Për sa i përket përmbajtjes së raportit të

Shtetit, Komisioni ka bërë disa vërejtje në lidhje me disa keqkuptime nga ana e shteteve anëtare:

- Disa shtete anëtare mendojnë se, pasi që qeveritë e tyre besojnë se diskriminimi racor nuk ekziston brenda territorit të tyre, nuk janë të obliguar të dorëzojnë raporte periodike. Komisioni është i mendimit se diskriminimi është një dukuri që aktualisht gjendet në të gjitha shtetet dhe prandaj të gjithë shtetet anëtare kanë obligim që të jenë vigjilent dhe të raportojnë për masat e ndërmarra që ta parandalojnë ose luftojnë diskriminimin racor.
- Disa raporte të shteteve lënë përshtypje se nëse Konventa bëhet pjesë e rendit ligjor në shtetin e tyre, atëherë nuk duhet të bëhen veprime tjera legislative. Mirëpo, Konventa jo që kërkon që legjislacioni të ndaloj disa vepra të caktuara, por poashtu bën thirrje që të ndërmerren hapa edhe në pjesën gjyqësore edhe në administratë si edhe në fushën e kulturës, arsimit dhe informatave. Ngjashëm me këtë, shteti anëtarë nuk i plotëson obligimet e veta sipas Konventës thjeshtë as nuk e dënon diskriminimin racor në Kushtetutën e shtetit.²⁸
- Në raste të caktuara në raporte nuk përfshihet teksti I ligjeve kundër diskriminimit dhe praktikave relevante. Që tu ndihmoj shteteve anëtare në përgatitjen e raporteve, CERD-i iu ka dhënë udhëzime të përgjithshme.²⁹

b) Ankesat Ndërshtetërore (Neni 11—13)

Të gjithë shtetet anëtare të Konventës e pranojnë kompetencën e CERD-it që të pranoj dhe veproj sipas ndonjë ankese nga ndonjëri prej tyre që tregon se ndonjë tjetër nuk iu përmbahet klauzulave të Konventës (Neni 11.1). Mirëpo, asnjë shtet anëtarë nuk e ka përdorur këtë procedurë, e cila siguron — vetëm nëse çështja nuk është zgjidhur në mënyrë tjetër — që të caktohet një *ad hoc* komision për pajtim (Neni 12). Shtetet nuk kanë vullnet ta përdorin këtë procedure për shkak se është e ndërlikuar dhe merr shumë kohë. Nëse shtetet dëshirojnë të paraqesin ndonjë ankesë lidhur me ndonjë shkelje ata e bojnë këtë në mënyrë politike, si psh, Komisioni Mbi të Drejtat e Njeriut ose para Asamblesë së Përgjithshme. Deri më tani, asnjë shtet nuk i ka përdorur procedurat ndërshtetërore te asnjë organ për të Drejtat e Njeriut të KB-ve.

c) Komunikimet individuale (Neni 14)

Ky proces për komunikime u lejon individëve ose grupeve ti dorëzojnë ankesat e tyre si viktimat të ndonjë shkelje të Konventës te CERD-i, me kusht nëse shteti përjatisë ka bërë një deklaratë që ta njeh kompetencën e CERD-it sipas Nenit 14. Kjo u bë funksionale në vitin

1982 kur e 10-ta e deklaratave të tilla u bë nga një shtet anëtarë. Individit ose grupi sigurisht i kishte harxhuar të gjitha remeditë lokale. (më shumë hollësi për procesin dhe këshilla se si të dorëzohet një ankesë mund të gjinden në Pjesën II, seksioni 2 të këtij doracakut.). Konventa më tutje në Nenin e vet 14.2 siguron se çdo shtet anëtarë që bën një deklaratë si që është paraqitur në paragrafin 1 të të njëjtit Neni mund të formoj ose kërkoj një organ kombëtar e cila është kompetente që ti pranoj peticionet nga individët ose grupe të individëve të cilët pohojnë se janë viktimat të shkeljeve të të drejtave të parapara në CERD, dhe të cilëve iu janë shterur organet tjera lokale në disponim. Vetëm nëse lutësit dështojnë të fitojnë kënaqësi nga organi i tyre, atëherë ata mund ta paraqesin çështjen para Komisionit. Luksemburgu dhe Afrika Jugore (nga 1 janar 2001) jenë të vetmit shtete anëtare që kanë emëruar Komisione sipas Nenit 14.2. Në lidhje me procedurat individuale të komunikimit brenda mekanizmave të KB-ve për të Drejtat e Njeriut, Neni 14 i ICERD-it dhe praktika e Komisionit paraqesin disa karakteristika të veçanta, të cilat mund të bëjnë dallim midis kësaj procedure dhe procedurave të ngjashme sipas instrumenteve tjera për të drejtat e njeriut. Për shembull, Neni 14 nuk u lejoj vetëm individëve të paraqesin ankesa por edhe grupeve të individëve që të dorëzojnë komunikime. Më tutje, komunikimi mund të merret parasysh edhe pse është në ndonjë procedure tjetër të hetimeve ndërkombëtare; dhe Komisioni jep sugjerime dhe rekomandime sesa vetëm të shpreh mendime. Mirëpo, kjo procedure nuk duhet ngatëruar me jurisdikcionin e ndonjë gjyqi. Një vendim i gjyqit është ligjësisht obligues kurse sugjerimet dhe rekomandimet e Komisionit nuk e kanë të njëjtën rëndësi ligjore. Sidoqoftë,

Këta sugjerime dhe rekomandime në përgjithësi konsiderohen si shpale autoritative të një organi kompetent gjyqësor dhe e shprehin shpresën se ata respektohen dhe shtetet anëtare iu përmbahen. Në këtë drejtim, është me rëndësi që mediumet dhe opinionin i përgjithshëm të njohtohen për raste të tilla para Komisionit dhe mendimet e shprehura nga i njëjti.

C. Procedurat novative të mëtutjeshme

Thënë teknikisht, Komisioni është ballafaquar me një problem konstant që e pengon punën e tij dhe e bën vështirë që ta kryej mandatin e tij: kjo pengesë është dështimi i disa shteteve anëtarë që të dorëzojnë raporte periodike — ose me vonesë. Janë përmendur arsye të ndryshme si psh, mungesë personeli që është i aftë për raportimin e të drejtave të njeriut dhe ngarkesa e madhe e punës për plotësimin e obligimeve ndërkombëtare për raportim nën një numri të madh rritës të instrumenteve mbi të drejtat e njeriut.

Me qëllim që ta përballoj këtë problem, Komisioni vendosi në mbledhjen e 39 në vitin 1991 se da ta rishqyrtoj implementimin e Konventës në ato raste kur raporti ndonjë shteti shumë është vonuar, madje edhe në mungesën e raportit për azhurmim, duke e përdorur

raportin paraprak të shtetit si bazë dhe duke i marrë parasysh edhe informatat tjera relevante (që njihet si **procedura e rishqyrtimit**). Kjo masë i mundëson Komisionit me një kontrol më të madhe efektive për procesin raportues, pasi që nuk duhet të mbështetet te shteti për ta rishqyrtuar implementimin e Konventës. Një letër i dërgohet shtetit anëtarë raporti i të cilit është vonuar më shumë se pes vjet, për ta informuar se rishqyrtimi do të ndodh, dhe më vonë data e saktë i dërgohet shtetit; përfaqësuesit e shteteve ftohen të marrin pjesë në mbledhje. Kjo ka për qëllim të inkurajoj dialog midis shtetit anëtarë dhe Komisionit edhe përkundër mungesës së raportit, që të siguroj një nivel minimal të rishqyrtimit të të gjithë shteteve anëtare. Në shumë raste kjo procedure i ka nxitur shtetet anëtare që të shpejtojnë ta dërgojnë raportin e vonuar dhe i mundëson Komisionit ta vazhdoj dialogun me këta shtete.

Një procedure tjetër novative u paraqit në mbledhjen e 45 të Komisionit në vitin 1994, kur vendosi se masat preventive duhet të jenë pjesë e agjendës së tij të rregullt. Në ata masa përfshihen **masa të hershme paralajmëruese dhe procedurat urgjente**. Raportet vjetore të Komisionit i sigurojnë sqarimet vijuese në lidhje me masat preventive:

Masat e hershme paralajmëruese duhet të drejtohen kah parandalimi i problemeve ekzistuese që të eskalojnë në konflikte dhe poashtu mund të përfshijnë edhe masa për ndërtimin e besimit që të konstatoj dhe përkrah çfarodë gjë që e forcon dhe përforcon tolerimin racor, veçanarisht të parandaloj rifillimin e konflikteve të mëparshme. Në kriteret për masat e hershme paralajmëruese mund të përfshihen, psh, gjendjet vijuese: mungesë të një baze adekuate të legjislacionit për përcaktimin dhe ndalimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, si që është paraparë në Konventë; mekanizma joadekuate për implementim, duke i përfshirë edhe procedurat e dëmshpërblimit; prania e modeleve të eskalimit të dhunës ose urrejtjes racore, ose propagandë racore ose apele për jotolerim racor nga zyrtarë të zgjedhur ose të tjerë; një model të konsiderueshëm të diskriminimit racor të evidentuar në treguesit ekonomik dhe social; dhe influksa të konsiderueshme të refugjatëve ose personave të zhvendosur si rrjedhojë e modelit racorose cenim të pakicave. Procedurat urgjente u përgjigjen problemeve që kërkojnë kujdes të menjëhershëm për ta parandaluar ose kufizuar shkallën ose numrin e shkeljeve serioze të Konventës. Në kriteret për fillimin e një procedure urgjente mund të hynë, psh, prania modeleve serioze, masive ose konstante të diskriminimit racor; ose ndonjë situatë që është serioze në të cilën ekziston reziku nga diskriminimi i mëtutjeshëm racor.

Rast relevant – L.K. kundër Hollandës

Më poshtë është dhënë një përmbledhje e komunikimit nr. 4/1991 (L.K. kundër Hollandës) —njëra ndër rastet e dorëzuar në përputhje me Nenin 14, mendimi i miratuar nga Komisioni dhe hapat e ardhshme të mara nga shteti anëtarë: L.K., qytetar i Marokos që jeton në Utrecht, Hollandë, dëshironte ta vizitonte një shtëpi për ta marrë me qira për vete dhe familjen e tij, por një grup njerëzish ishin mbledhur para shtëpisë, duke bërë titur 'mjaft më të huaj' dhe disa prej tyre u kërcënuan se do ta ndezin shtëpimë nëse L.K. e merrte atë shtëpi. Pastaj u nënshkrua një peticion nga 28 banor që thonin se shtëpia nuk mund ti jipej L.K.-së. L.K. dorëzoi një ankesë duke pohuar se ka qenë viktimë e diskriminimit racor. Shumica e nënshkruesve të peticionit u morrën në pyetje, por disa muaj më vonë, prokurori i gjyqit komunal Utrecht e njoftoi L.K.-në se çështja nuk ka qenë regjistruar në zyrën e tij si rast krimi për shkak se nuk ka qenë i sigurt se ka ndodhur ndonjë shkelje. Avokati i L.K.-s pastaj iu drejtua Gjyqit Apelues të Amsterdimit duke kërkuar urdhër që të ngrihet padi kundër nënshkruesve të peticionit. Kjo kërkesë u refuzua në baza të interesit publik, duke pohuar se peticioni nuk ishte as dokument i natyrës ofenduese me qëllim, as për nxitje të diskriminimit racor. L.K. pastaj dorëzoi një ankesë të CERD-it, përveç tjerash në baza të saj se vërejtjet dhe deklaratat e banorëve ishin diskriminuese në natyrë në bazë të racës, se policia nuk veproi shpejt dhe me efikasitet për hetimin e rastit dhe se Gjyqi Apelues e kishte prolonguar procesin gjyqësor dhe ishte mbështetur në dëshmi jo të plota. CERD-i në mbledhjen e 42-të në mars 1993 vendosi se veprat e banorëve kanë qenë diskriminuese, se hetimi nga policia dhe prokuroria nuk ishin të plota dhe se kur bëhen kërcënime që nxisin shkelje racore, veçanarisht në opinion dhe nga një grup njerëzish, është detyrë e shtetit ta hetoj atë shpejt dhe me kujdes. Më tutje, policia dhe prokuroria nuk ofruan mbrojtje efektive dhe dëmshpërblim sipas kuptimit të Nenit 6 të Konventës.

Kështu, CERD-i rekomandoi që shteti anëtarë ta rishqyrtoj politikën e vet dhe procedurën në lidhje me veprat e dhunës racore, dhe ti jap lutësit ndihmë proporcionale për dëmin e vuajtur moral. Në raportin e 13 periodik që e dorëzoi te Komisioni, Qeveria e Hollandës siguroi informata gjërë e gjatë për udhëzimet e reja më të rrepta kundër diskriminimit që poashtu ia kishte dhënë policisë dhe prokurorisë publike, duke shtuar se në përpilimin e këtyre udhëzimeve iu është mbështetur edhe rekomandimeve relevante të Komisionit në rastin public L.K.-së. Më tutje, Qeveria theksoi se, në këshillime me avokatin e Lutësit dhe vet Lutësin, qeveria ka dhënë kompensim të arsyeshëm.³¹

Sipas këtyre procedurave Komisioni e shqyrton një situatë pa raport periodik nga shteti anëtarë përkatës.

Në të kaluarën CERD-i I ka shqyrtuar edhe rastet e konflikteve në Ish Jugosllavi dhe në Rajonin e Liqenit të Madh (Great Lakes Region) në Afrikë. Një numer gjendjesh urgjente janë shqyrtuar sipas procedurave urgjente, duke përfshirë edhe amandmanin e Australisë për Titullin e Aktit Vendas që konsiderohej të jetë diskriminues për nga raca kundër popujve vendas të Australisë.

NB: masat e hershme paralajmëruese dhe procedurat urgjente mund të zbatohen vetëm nga anëtarët e CERD-it. OJQ-të që kërkojnë të zbatohen masa të tilla mund ta bëjnë atë duke kontaktuar me ndonjë anëtarë të CERD-it dhe të kërkoj nga ai ose ajo ta bëjë atë. Hapat e ardhshme nga ndonjë OJQ poashtu duhet të bëhen nëpërmjet ndonjë anëtari ose anëtarëve të CERD-it. Zhvillimi më i rëndësishëm për punën e CERD-it ndodhi në gusht 2000, kur CERD-i organizoi një diskutim dy ditor me temë — diskriminimi kundor Romëve — e cila ishte e para e këtij lloji në historinë e gjatë 30 vjeçare të Komisionit. Ky diskutim fillestar i CERD-it ishte një shënim në shumë mënyra.

Së pari, kjo çoi deri te prodhimi I Rekomandimit të Përgjithshëm³²

Duke paraqitur një numër masash që qeveritë e shteteve anëtare relevante të CERD-it duhet ti marrin për përmirësimin e gjendjes së Romëve. Në këtë drejtim, duhet ti kushtohet vëmendje faktit se prodhimi i Rekomandimeve të Përgjithshme zakonisht fillon me dorëzimin e një drafti nga ndonjë anëtar dhe i cili nuk është si rrjedhojë e diskutimit. E dyta, për ta rritur qasjen deri te hulumtimet, informatat dhe përvoja ekzistuese, CERD-i në këtë temë diskutimi i ka ftuar edhe institucionet rajonale si edhe agjensionet dhe organet tjera të KB-ve, në veçanti ekspertë nga Nën Komisioni mbi Avancimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Komisionin mbi Raportuesit Special mbi të Drejtat e Njeriut për Format Bashkohore të Racizmit. Komisioni poashtu i ka pranuar dhe marrë parasysh informatat e hollësishme, si edhe informata të dorës së pare nga OJQ-të, në veçanti për grupet që bëhet fjalë, p.sh. Organizatat e Romëve, duke mbajtur një takim joformal duke e përdorur kohën e saj për mbledhje zyrtare dhe duke i thirrur që ti dorëzojnë dokumentet e tyre të shkruara.

Edhe pse ky diskutim ishte një risi në punën e CERD-it, nuk ishte risi në mekanizmat për mbikqyrje të marrëveshjes së KB-ve në përgjithësi. Një numër organesh mbikëqyrëse me marrëveshje veç kishin mbajtur sesione tematike me vite më parë dhe me sukses kanë zhvilluar metoda për involvimin e OJQ-ve në ato diskutime tematike. Pas suksesit me sesionin fillestar tematik për Diskriminimin kundër Romëve, shpresohet që praktika e CERD-it për mbajtjen e sesioneve tematike të institucionalizohet në të ardhmen dhe se kjo do të bëhet një pjesë efektive e punës së Komisionit.

D. Ndikimi i ICERD-it mbi shtetet

Qysh prej hyrjes në fuqi të ICERD-it, ndryshimet në shumë shtete kanë qenë meritë e ndikimit pozitiv të Konventës. Këtu përfshihen:

- amandamente të kushtetutave shtetërore që ti përfshijnë edhe klauzulat që e ndalojnë diskriminimin racor;

rishqyrtim sistematik të ligjeve dhe dispozitave ekzistuese që çojnë kah ndryshimi i atyre që mund të sjellin diskriminim racor, ose miratimi i ligjeve të reja që ti kanaq nevojat e Konventës;

shpallja e veprave të diskriminimit racor dhe dhunës racore si shkelje që dënohet me ligj;

garanca ligjore dhe procedura implementimi kundër diskriminimit lidhur me sigurinë e peronave, të drejtat politike, punësimi, banimi, arsimimi ose hyrje te hapësira dhe objekte që janë për destinim për opinionin e përgjithshëm;

programe arsimore që synojnë për promovimine mire të marrëdhënieve dhe tolerimit midis grupeve etnike dhe racore;

krijimin e institucioneve dhe agjensioneve për ballafaqim me problemet e diskriminimit racor dhe ti mbrojnë interesat e grupeve vendase; dhe

qeveritë kërkojnë asistencë teknike nga KB-të për çështje të legjislacionit kundërdiskriminues dhe dëmshpërblime për viktimat.

Pjesa 2 – Kontributi i OJQ-ve në punën e CERD-it

Në kuadër të Këshillit Ekonomik dhe Social (ECOSOC) dhe organeve të tij ndihmëse sikurse Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut, OJQ-të mund të marrin status konsultativ që do të thotë se mund të bëhen pjesë përbërëse e procedurave punuese të këtyre organeve.³³ Mirëpo, shumica e traktateve të KB-ve, poashtu edhe CERD-i, nuk janë organe të KB-ve në kuptimin formal. Edhe përkundër lidhjeve të forta me KB-të, që iu ofron shërbimet e Sekretariatit, ata janë krijuar nga vet traktatet dhe rregullat për status konsultativ nuk vlejn për ta. Si rrjedhojë, nuk ekzistojnë marrëdhënie zyrtare midis CERD-it dhe OJQ-ve. Edhe pse kjo marrëdhënie është joformale, rëndësia e kontributeve të OJQ-ve është pranuar nga CERD-i. Në masë të madhe, anëtarët e CERD-it në raportin e tyre i bëjnë publike informatat që i kanë marrë ose mbledhur nga burime joqeveritare. Edhe pse rrjedha e informatave nuk është mbledhur ose analizuar sistematikisht, Shërbimi i Informatave Kundër Racizmit (ARIS ose shqip SHIKR)³⁴— OJQ e vendosur në Gjenevë — e ka marrë përsipër që ti bashkoj grupet për të drejtat e njeriut me anëtarët e CERD-it dhe i ndihnon këtij të fundit gjatë hulumtimit të informatave relevante. Ajo çka u duhet anëtarëve të CERD-it është një pasqyrë më e plotë e situatës që është paraqitur në raportin zyrtar të shtetit anëtarë. Me fjalë të tjera, OJQ-të duhet tu japin vëmendje këtyre pyetjeve: a ekzistojnë zbrazëtira në raportin zyrtar; a ekzistojnë keqreprezentime; a janë të sakat supozimet, analizat dhe thekset? Përveç që OJQ-të i sigurojnë informata Komisionit, ata, kurse veçanarisht OJQ-të që janë aktive në nivel kombëtarë, mundet poashtu të propagandojnë informata për ICERD-in ose procesin e raportimit në mesin e anëtarëve të vet dhe opinionin e përgjithshëm në një shtet. OJQ-të mund ti pranojnë çështjet që janë të një rëndësie të posaçme për ta dhe ti vlerësojnë komentet konkrete që janë dhënë nga anëtarët e Komisionit lidhur me përfilljen (mospërfilljen) e ndonjë shteti me ICERD-in. Në vende ku qeveria është e ngadalshme në implementimin e ndryshimeve të rekomanduara në ligjet e saj, politikën dhe praktikën, OJQ-të mund të jenë në shërbim të opinionit për influencimin e ndryshimeve të tilla.

1. Procedura e raportimit

Kur një OJQ i jep informata CERD-it, është me rëndësi, në interes të Komisionit dhe OJQ-së, që informata të dorëzohet në mënyrën më efektive. Si që ka treguar praktika, një dorëzim i thjeshtë i rasteve të

rastësishme ose neneve të Komisionit zakonisht nuk ka ndikim të madh. Poashtu edhe informatat e tepërta mund të jenë problem. Nevoitet një strategji mirë e zhvilluar. Zgjidhja më e mirë është që të prodhoni një raport plotësues — Poashtu quhet raport alternativ. Ekzistojnë dy mënyra se si duhet ti qasemi atij raporti; mënyra e parë është që të përpiloni një raport gjithpërfshirës që e merr parasysh çdo pikë të raportit të shtetit dhe jep informata plotësuese ose kontradiktore. Për këtë nevojitet mjaft kohë dhe burime, por duket të jetë mënyra më efektive për sigurimin e informatave dhe probabiliteti për tërheqjen e vëmendjes së Komisionit është shumë i madh. Mënyra e dytë, për ata OJQ që nuk janë të aftë ti bashkojnë resurset e nevojshme dhe aktivitetet e të cilëve janë të kufizuara në hapësira ose fusha të caktuara, do të ishte më mirë që të përqendrohen në çështje specifike — sikurse që janë ato që ndikojnë te grupet e posaçme ose fushat konkrete si psh, arsimimin, punësimin ose kushtet e punës.

Në lidhje me përpilimin e raportit, kemi grumbulluar disa këshilla të dobishme duke i konsultuar anëtarët e CERD-it dhe duke kërkuar përvojën e OJQ-ve tjera.

A. Hapat që duhet të ndërmerren para se të shqyrtohet raporti i shteti nga CERD-i

Kur duhet ta dorëzohet raporti i shtetit? — si që sqaruar më herët në këtë doracak, raporti fillestar duhet të dorëzohet një vit pasi që Konventa hyn në fuqi për shtetin përkatës dhe raporte periodike duhet të dorëzohen çdo dy vite pastaj. Informata për atë se kur një raport shteti duhet të dorëzohet mund të merni nga shteti përkatës. Në anën tjetër, OJQ-të mund ti drejtohen Sekretariatit të CERD-it ose të këshillohet me Bazën e të dhënave të Traktatit në vebfaqen e Zyrës së Komesariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (www.unhchr.ch).

A është dërguar raporti? — Kontaktoni sektorin e qeverisë që është përgjegjës për përgatitjen e raportit zyrtar që duhet dërguar te CERD-i (shumë shpesh Ministrinë e Punëve të Jashtme) që të zbuloni se a është dërguar raporti i shtetit ose kur e ka ndër mend qeveria ta dorëzojë te Komisioni. Nëse raporti ende përgatitet OJQ-të mund të bëjnë negociata me organin kompetent që të kyçen në procesin e hartimit. Disa qeveri mund të kenë dëshirë bile edhe të interesuar që të këshillohen me OJQ-të kombëtare me qëllim që të shmangen nga kritikata se se kanë mbaruar raportin. Në shtetet tjera, çfarëdo kontakti me qeverinë mund të jetë i pamundur. Pa marrë parasysh se çfarë rezultati do të kenë këshillimet me qeverinë, OJQ-të janë mirë të këshilluara që ta ruajnë pavarësinë e tyre. Nëse raporti veç është përpiluar, zakonisht është në dispozicion një kopje nga qeveria. Nëse OJQ-të hasin në vështirësi që ta marrin atë kopje, Sekretariati i CERD-it mund ta tregojë numrin e dokumentit që të porositet një kopje nga arkivi i Zyrës së KB-ve në Gjenevë (shih Adresat e dobishme në fund të këtij doracaku). Dokumentet e këtilla poashtu janë në disponim në vebfaqen e Zyrës së KB-ve të

Komesariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (www.unhchr.ch).

Kur raporti mbërin te Komisioni, pas botimit dhe përkthimit në gjuhët zyrtare nga ana e Sekretariatit të KB-ve, shteti përkatës do të vendoset në listën e raporteve në pritje. Në mbledhjen menjëherë pas pranimit të raportit, Komisioni zakonisht do të vendos se cilat shtete në list do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme dhe kush do të caktohet si Raportues i Shtetit. (Nëse Komisioni pranon ndonjë raport gjatë mbledhjes, një vendim i tillë mund të mirret në mbledhjen e njejtë.)

Për shkak të punës së madhe të Komisionit, zakonisht raporti do të shqyrtohet dy ose tre mbledhje pasi që raporti është kyçur në listen në pritje. Mirëpo, zakonisht komisioni u jep përparësi raporteve fillestare, raporteve që dorëzohen pas një vonese të gjatë dhe raporteve nga shtetet në të cilat ndodhin zhvillime të rëndësishme.³⁶ OJQ-të këshillohen që të caktojnë një orar për prodhimin e raporteve plotësuese ose informata tjera relevante, pasi që caktohen datat e shqyrtimit të raportit.

OJQ-të mund të kontaktojnë me

... Raportuesin e Shtetit — Rekomandohet që OJQ-të të cilat planifikojnë ti japin informata CERD-it ta kontaktojnë Raportuesin e Shtetit për shtetin përkatës. Emri i Raportuesit të Shtetit mund të mirret nga Sekretariati i CERD-it, përveç informatave për kontakt, nëse ai ekspert është pajtuar që të jenë ato informata në disponim për opinionin. Përndryshe, komunikoni me Raportuesin e Shtetit nëpërmjet Sekretariatit. OJQ-të mund t'i tregojnë Raportuesit të Shtetit qëllimin e tyre për dorëzim të një raporti plotësues ose ta pyes për këshilla për përmbajtjen dhe formatin e raportit dhe se ku dhe kur duhet të dërgohet. Në disa raste, Thirrja e Raportuesit të Shtetit përkatës që të marr pjesë në një mbledhje të OJQ-ve kombëtare mund të bëhet, por vetëm nëse ky i fundit nuk është në Gjenevë gjatë shqyrtimit të raportit të shtetit të tij. Disa ish Raportues Shtetesh na treguan se sa të dobishme mund të jenë mbledhjet e tilla.

... OJQ-të tjera — shpesh mund të ndosh që të jetë më efikase të prodhoni një raport plotësues në bashkëpunim me OJQ-të tjera. Duke e bërë këtë, OJQ-të mund ti shmangen dyfishimit të punës së tyre dhe ti përdorin dituritë, materialet dhe burimet e tyre në mënyrë efikase. Më tutje, ka shumë më pak gjasa që anëtarët e CERD-it ti lexojnë të gjithë raportet e OJQ-ve nëse pranojnë shumë raporte. Raportet individuale që kanë të bëjnë me çështje të njejta bile mund edhe të krijojnë huti në mesin e ekspertëve dhe nuk do të mund ta kuptojnë situatën aktuale. Një qasje e tillë mund të bëhet në dy forma: OJQ-të ose të prodhojnë një raport të përbashkët me emër të një koalicioni, ose mund ta bashkërendisin punën e tyre për përgatitjen e raporteve individuale. Disa herë mund të jetë vështirë që të formohet koalicion, veçanarisht për shkak se OJQ-të mund të kenë qëndrime të ndryshme dhe disa herë edhe qëndrime konfliktuoze,

ose mund të parapëlqejnë që ti paraqesin qëndrimet e veta qartë se sa të marrin parasysh disa lëshime të caktuara. Por, edhe përkundër këtyre telasheve, besojmë se ka shumë për tu përfituar nga një qasje e këtillë për shkak të ndikimit më të madh që raporti do ta ketë mbi anëtarët e CERD-it.

Ilustrim — Lidhja e Finlandës për të Drejtat e Njeriut

Lidhja e Finlandës për të Drejtat e Njeriut (FLHR ose shqip LFDNJ) është involvuar në procesin përgatitor të raportit të Finlandës për të gjithë traktatet e të drejtave të njeriut të KB-ve, duke përfshirë edhe CERD-in. Edhe pse nuk sugjerohet që praktika e Finlandës të bëhet model, është një shembur i mirë i bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet qeverisë dhe OJQ-së. Sipas Z. Martin Scheinin, kryesues i mëparshëm i FLHR-së dhe momentalish anëtarë i Komisionit mbi të Drejtat e Njeriut të KB-ve:³⁵

'Edhe pse OJQ-të gjejnë shkaqe që ta kritikojnë ekzistimin e problemeve lidhur me të drejtat e njeriut në Finlandë, ekziston një dialog relativisht i mirë që funksionon ndërmjet qeverisë dhe faktorët në shoqërinë qytetare, duke i përfshirë edhe OJQ-të. Një drejtim i këtij dialogu është Bordi Këshillimor për Çështjet ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut i formuar nga qeveria i cili i diskuton në fazën e hartimit raportet e Finlandës që duhet të dërgohen te traktatet e ndryshme. Më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit Këshillimor janë propozuar nga OJQ-të ose janë ekspertë akademik të pavarur. Në këta diskutime, OJQ-të mund të kenë ndikim të verzionit përfundimtar i raportit.

Në vitet e kohës së fundit, ky kjo metodë e involvimit të OJQ-ve është plotësuar ose zvendësuar me praktikën e caktimit të një dëgjimi publik në një fazë të hershme të hartimit të raportit të qeverisë. Në këto dëgjime publike, një numër më i madh i OJQ-ve përveç atyre që marrin pjesë në Bordin Këshillimor mund ti paraqesin mendimet e veta për atë se çfarë problemesh duhet të përmenden në raportin e qeverisë. [...]

Është përgjegjësi e qeverisë që ta shkruaj dhe dorëzoj raportin. Edhe pse shumë OJQ nuk dëshirojnë të marrin pjesë në vet shkruarjen e raportit, ata dëshirojnë ti paraqesin kritikën e tyre te ata zyrtarë qeveritarë që i përgatisin raportet.'

Poashtu, pasi që OJQ-të me autoritet të formuar ndërkombëtar shpesh iu është dhënë njohje për kredibilitetin e informatave që i japin për organe të ndryshme të KB-ve, një formë e lidhjes me OJQ-të tilla mund ta zmadhojë statusin dhe kredibilitetin e OJQ-ve të vendit.

OJQ-të ndërkombëtare që kanë përvojë në punën e CERD-it, si psh ARIS, poashtu mund të paraqesin ndihmesë të madhe për OJQ-të kombëtare me qëllim që të hynë në KB; të bëjnë lobimin dhe identifikojnë anëtarët e Komisionit të cilët do të interesohenin për çështjet e tyre; grumbullimin e dokumenteve; dhe në mungesën e përfaqësuesëve të OJQ-ve në Gjenevë, tu shpërndajnë raporte plotësuese anëtarëve të Komisionit. Mundo Afro, OJQ nga Uruguaji, e cila dorëzoi një raport plotësues të CERD-i për here të parë në gusht të vitit 1999, na informoi për përvojën pozitive të tyre me OJQ-të ndërkombëtare: ata kishin pranuar ndihmë nga IMADR-i dhe ARIS-i për përgatitjen e raportit sipas formatit të tij, gjuhës dhe argumentimit; për kontaktimin e Raportuesit të Shtetit Uruguaj; për dërgimin e dy përfaqësuesëve të tyre në Gjenevë të cilët iu shpërndanë kopje të raportit plotësues anëtarëve të CERD-it; dhe për organizimin e një sesiioni joformal për njohtim.

... **qeveria** — do të ishte e dobishme nëse OJQ-të vendore bisedojnë jo vetëm për përgatitjen e raportit me shtetit përkatës por poashtu t'ia bëj me dijeni delegacionit qeveritar se çfarë pyetjesh tu parashirojnë anëtarëve të Komisionit gjatë shqyrtimit të raportit. Shpesh mund të ndodh që një delegacion mos të ketë të dhënat ose personelin kompetent në disponim dhe përgjigjet mund të shtyhen për herën tjetër kur raporti i shtetit të shqyrtohet (psh. së paku dy vite më vonë); vonesat e tilla mund të parandalohen duke i dhënë qeverisë informata parakohe.

... **deputetët** — kjo në veçanti mund të jetë e dobishme në shtetet në të cilat qeveria është shumë e ndijshme për çështjet e ngritura nga legjislacioni, dhe mund të merret parasysh lobim tërthoraz nëpërmjet deputetëve.

... **mediumet** — Mediumet mund të jenë një partner i vlefshëm për informimin e opinionit lidhur me marrjen në shqyrtim të raportit. Në raste kur ka ndonjë korespondent ose degë locale të mediave kombëtare të shtetit përkatës në Gjenevë ose aty afër, mund të vendosen kontakte edhe me shatabin në shtëpi edhe me korespondentin — nëse është e mundur personalisht. Në raste kur nuk ekziston një degë e tillë, prap se prap vlen të inkurajohen mediumet kombëtare që të dërgojnë një raport në Gjenevë. T'ju afroheni medimeve ndërkombëtare që i ndjekin ngjarjet në KB është edhe një mënyrë tjetër për zmadhimin e punës së avokimit në lidhje me shqyrtimin e raportit të një shteti nga CERD-i. Me qëllim të përfshirjes së duhur të ndonjë çështje të veçantë, OJQ-të mund ti njohtojnë edhe njerëzit përgjegjës për mediumet në lidhje me ato çështje, horizontin dhe përmbajtjen e Konventës dhe ecuritë e Komisionit.

Si të shkruani një raport “plotësues”³⁷

Struktura:

- **Faqja e parë:** Një ndër qëllimet kryesore të raportit është të tërhiqet vëmendja e

anëtarëve të Komisionit. Faqja e parë duhet të japë informata thelbësore për shtetin dhe emrin e organizatës që e ka përgatitur raportin.

- **Tabela e përmbajtjes:** Përsëri, me qëllim të tërheqjes së vëmendjes të anëtarëve të Komisionit, një tabelë e hollësishme e përmbajtjes duhet të përfshihet, jo vetëm që anëtarëve të Komisionit tu jap një ide të qartë për përmbajtjen e raportit, por edhe tu mundësoj atyre që të kalojnë menjëherë te ato pika që u intereson.

Hyrja: Duhet të supuzojmë se anëtarët e Komisionit do të hasin në emra të OJQ-ve për të cilët nuk kanë dijeni dhe prandaj hyrja duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të organizatës dhe natyrës së OJQ-së. Hyrja poashtu duhet të përmbajë një përmbledhje të pikave kryesore.

Ilustrim — Parathënia e raportit të OJQ-së Zvicrane Forumi Kundër Racizmit fillon me:

‘Forumu Kundër Racizmit është një koalicion dhe një rrjetë për më shumë se tetëdhjetë organizata kundër racizmit dhe shumë anëtarë individual në tërë Zvicrën. U themeluan në vjeshtën e vitit 1991 pas disa sulmeve kundër akomodimit të azil kërkuesëve. Forumu dëshiron ta promovojë këmbimin e informatave ndërmjet anëtarëve të vet dhe opinionit dhe mundohet ta ushtroj ndikimin e vet në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë.’³⁸

- **Pjesa kryesore e raportit:** Si që u tregua më lartë dhe sikurse rekomandojnë anëtarët e Komisionit, është e preferueshme që çështjet e ndryshme të trajtohen në pajtim me rradhitjen e Neneve të ICERD-it ose raportet e OJQ-ve në hyrjen dhe në tërë tekstin e raportit duhet së paku qartë të shprehin se çështjet e ngritura i takojnë ndonjë Neni konkret të ICERD-it. Kjo ndodh kështu për shkak se Komisioni është një organ mbikqyrës dhe prandaj merret me implementimin e klauzulave të ICERD-it nga ana e shteteve anëtare. Me këtë qasje, përmbajtjet e raportit të shtetit mund ose të përmirësohen ose të jipen komente për paragraphed individuale. Mirëpo kjo qasje, nuk e përjashton mundësinë e një deklarate të përgjithshme hyrëse për çështjet dhe zhvillimet që janë të një rëndësie të madhe. Në çdo pikë, duhet të ketë një përshkrim të shkurtër për çështjen dhe zbrazëtitrat dhe mangësitë në raportin e shtetit duhet të potencohen. Raporti plotësues poashtu mund të përfshijë edhe çështje të cilat Komisioni mund ti parashiroj. Mos haroni se vendimi për ti marrë parasysh këshillat e OJQ-ve

plotësisht varet nga anëtarët e Komisionit, kështu duhet ti shmangeni tonit urdhërues.

Burimet:

Shumë informata mund të shqyrtohen që ta ilustrojnë analizën e OJQ-ve për veprat ose praktikat e diskriminimit, si psh:

- statistikë (informata për si, kur, ku dhe nga cili janë grumbulluar ata);
- rezultate nga hulumtime akademike (poashtu);
- dokumente zyrtare të botuara nga organet e qeverisë;
- raste konkrete të shkruara nga gazeta të sigurta; dhe
- raste gjyqësore.

Në përgjithësi rastet konkrete çmohen nga anëtarët e Komisionit si ilustrime të mira për çështjet e ngritura në raportet plotësuese. Për shembull, raporti plotësues për Nepal nga Qendra e Azisë Jugore për Dokumentacion mbi të Drejtat e Njeriut (SAHRDC ose shqip QAJDDNJ) që u dorëzua te CERD-i në gusht 1998 paraqet një rast me qëllim të ndriçimit të pandëshkueshmërisë së policisë së Nepalit në rajonin e Nepalit. Çdo herë është e dobishme që të keni ndër mend se të gjitha informatat e siguruar duhet të kontrollohen (me data), kështu që siguria e informatave mund ti nënshtrohet një analize të pavarur.

Asnjëherë nuk duhet të bëhen deklarata pa dëshmi të forta. Burime të sigurta thanë ... kjo mund të jetë mirë në gazetari për jo në rastin tonë; çdo burim që do të përmendet në raport duhet të jetë i përpikt, sinqertë dhe autentik.

Ilustrim – Qendra Evropiane mbi të Drejtat e Romëve

Raporti plotësues i dorëzuar nga Qendra Evropiane mbi të Drejtat e Romëve (ERRC ose shqip QEDR) lidhur me implementimin e ICERD-it në Itali në mars 1999, u referohet shumë dokumenteve zyrtare edhe qeverisë Italiane edhe institucioneve ndërkombëtare ose rajonale të cilat e vërtetojnë përmbajtjen e ERRC-s. Teksti i mëposhtëm është një fragment nga raporti i tyre që i referohet Nenit 2 të Konventës:

'Neni 2 për Diskutim

Deri më tani, Qeveria nuk iu është përmajtur obligimeve të veta që "ta ndaloj dhe ti jap fund, me të gjitha mjetet e duhura, duke përfshirë edhe legjislacionin [...] diskriminimit racor[...]" (Neni 2(1)(d). Në njërin anë, legjislacioni për ndalimin e diskriminimit racor duket se nuk siguron

dëmshërblim adekuat dhe nuk ka qenë publikuar gjërisht. Në anën tjetër, Qeveria nuk ka vepruar që të siguroj se a zbatohet në mënyrë efikase në praktikë edhe ai legjislacion që ekziston. Komisioni European Kundër Racizmit dhe Jotolerimit konkludoi se, "Në Itali nuk ekziston një legjislacion i përgjithshëm që ta kundërsulmon diskriminimin etnik ose racor." Përveç ndryshimeve të kodit penal në vitin 1993 (e cila i adresohet propagandimit të fjalimit racor dhe dhunës racore), ligji Italian jep "shumë pak municion kundër diskriminimit racor ose formave tjera të jotolerimit". Legjislacioni për Migrim i miratuar në korik 1998 duket se siguron mbrojtje të kufizuar kundër diskriminimit racor. Mirëpo, fusha e mbrojtjes që parashihet aty është e paqartë dhe dëmshpërblimet që jipen nuk janë adekuate.

Edhe pse Qeveria e ratifikoi Konventën Kornizë për Mbrojtje e pakicave kombëtare në nëntor 1997, Italia ende nuk ka ligj për pakicat. Më tutje, tani duket se, nëse dhe kur një ligj për sigurimin e të drejtave të pakicave më në fund miratohet, ai nuk do të vlej për Romët. Prandaj, një projekt legjislacion për të drejtat gjuhësore dhe kulturore të pakicave momentalish pritët që të zgjidhet në Senat, u miratua nga Dhoma e Deputeteve në qershor 1998 pasi që Romët ishin përjashtuar nga zbatimi i ligjit të propozuar.

Njëllor si kjo, pasi që Qeveria dhe të tjerët e kishin lavdëruar projekt legjislacionin për migrim për dhënien joqytetarëve legal të drejtën të votojnë në zgjedhjet vendore, kjo klauzulë u fshi nga ligji para se të miratohet. Dykuptimsia dhe mospërshtatja që rezultoi e legjislacionit të Italisë për diskriminimin racor është e përzier me dështimin që ta siguro zbatimin e tyre efikas. Kështu, duke mos e kundërshtuar klauzulën e përgjithshme kushtetuese mbi barazinë (Neni 3), "nuk ekziston një rast ligji për temën e racizmit". Më tutje, poashtu nuk ka rast ligji lidhur me atë pak ndalesa legjislative kundër akteve jo të dhunshme të diskriminimit i cili ekziston.

[...]

...vazhdon

Për sa u përket ndryshimeve të ligjit kriminal në vitin 1993, të cilat vlejné për dhunën racore dhe fjalimin e urrejtjes, në mbledhjen e Komisionit (CERD) në mars, kur raporti i tetë dhe nëntë i qeverisë shqyrtoheshte, delegacioni Italian pohonte se, "[a]s një efekt direct i legjislacionit të ri [për luftimin e racizmit dhe diskriminimit], numri i veprave jotoleruese, diskriminimi dhe dhuna racore është zvogluar drastikisht". Mirëpo, qeveria nuk ishte në gjendje që të jap informata në lidhje me shpeshësinë ose efikasitetin

e dëshmipërblimeve gjyqësore për dhunën racore, thjeshtë theksoi se "proceset gjyqësore sipas legjislacionit të ri ende nuk kanë mbaruar; për shkak se vendimet përfundimtare ende nuk ishin marrë, edhe pse shumë vendime ishin marrë nga sistemi gjyqësor sipas legjislacionit të vitit 1975". Për fat të keq, raporti i Qeverisë i dorëzuar në vitin 1998 nuk elaboron shumë për këtë çështje.

Shkurtimisht, një hulumtim i ERRC-së që zgjati disa muaj ka dështuar që të zbulojë dëshmi të cilat do ti kundërshtonin zbulimet e KB-ve të 17 korikut 1998 (Znj Chanet) se, në Itali, "shumë pak është bërë në luftën kundër racizmit".'

NB: Raporti i ERRC-s ka shënime të bollshme dhe të dobishme që tregojnë për atë se ku i ka marë deklaratat.

Raportet e OJQ-ve poashtu mund tu referohen komenteve dhe konkludimeve të miratuara paraprakisht nga CERD-i dhe raporteve dhe komenteve të:

- institucioneve kombëtare mbi të drejtat e njeriut;
- organeve mbi të drejtat e njeriut të KB-ve dhe traktateve tjera;
- institucioneve rajonale (Këshillit të Evropës, Komisionit Ndër Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë [OSBE-ja, etj.]);
- agjensioneve të specializuara (Organizata Ndërkombëtare e Punës [ILO ose shqip ONP],).

Gjuha:

Këshillohet që raporti të shkruhet në gjuhën angleze. Gjuha frenge dhe spanjole poashtu do të çmohen madje edhe rekomandohet kur Raportuesi i Shtetit gjuhë amtare e ka një të një prej këtyre gjuhëve.

Gjatësia:

Dorëzimi i dokumenteve voluminoz duhet të shmanget. Një sekretar i mëparshëm i CERD-it sugjeron që një raport i OJQ-së nuk duhet të jetë më i gjatë se 20 faqe.

Në raste kur raporti plotësues nuk mund të përgatitet

Lloje tjera të dorëzimit të raporteve nga OJQ-të

Edhe pse dorëzimi i raportit plotësues është shumë inkurajues, kjo poashtu mer shumë kohë dhe për shimë OJQ duket e pamundur. Në raste të tilla, ata mund të përgatisin raporte që kanë të bëjnë vetëm me ndonjë Nen të Konventës duke e theksuar mosrespektimin e tyre nga shteti. Këta dorëzime mund poashtu të përdorin artikuj nga gazetatat (nga burime të sigurta) me një shënim sqarues që i drejtohet çështjes por duke iu referuar Nenit ose Neneve relevante të ICERD-it. Mirëpo, preferohet

që këta dorëzime ti respektojnë këshillat e lartpërmendura për raportet plotësuese.

Si dhe kur ta dorëzoni raportin:

Pas vendosjes së kontaktit direkt me Raportuesin e Shtetit, ai ose ajo mund t'ju tregoj se kur, ku dhe si duhet të dërgohet raporti. Për sa i përket kohës, disa dëshirojnë ta pranojnë sa më herët, kurse të tjerët disa javë para kohe. Për sa u përket anëtarëve tjerë të Komisionit, ndonjëherë është problematike që t'ua dorëzoni raportin për shkak të rezervës që tregojnë për mbështetjen e raportit të OJQ-ve. Mund të merren parasysh tre opsione:

1. tetëmbëdhjetë kopje, plus një më tepër për Sekretariatit, mund të dërgohen te Sekretariati i CERD-it i cili drejtpërsëdrejti do t'ua dërgojë anëtarëve të CERD-it. Vendoni raportin në zarfa veç e veç të adresuar për çdo anëtarë të CERD-it.

2. Një kopje mund ti dërgohet ARIS-it para se të fillojë mbledhja që të mund raporti ti bashkangjitet listës së tyre të dokumenteve. Në fillim të mbledhjes së Komisionit, lista do tu shpërndahet anëtarëve të cilët mund të porosisin kopje të dokumenteve të cilët i dëshirojnë.

3. Nëse OJQ-të marrin pjesë në mbledhje, një kopje mund ti jipet çdo anëtarë personalisht në mbledhje sa më herët që mundet. Pyeteni çdo anëtarë nëse dëshirojnë ta shikojnë por mos këmbëngulni. Disa ekspertë nuk pëlqejnë që të pranojnë raporte plotësuese në vet ditën e mbledhjes që mbahet për shqyrtimin e raportit të shtetit përkatës.

B. Gjatë shqyrtimit të raportit

OJQ-të sipas dëshirës duhet të marrin pjesë në mbledhjet në të cilën shqyrtohet raporti i shtetit anëtarë përkatës. Nëç këtë mënyrë, OJQ-të do të kenë informata të dorës së pare lidhur me komentet ose pyetjet e anëtarëve të Komisionit dhe përgjigjet e shteteve.

Nëse OJQ-të mund të dërgojnë ndonjë te mbledhja e CERD-it në Gjenevë, përveç tjerash, aktivitetet vijuese mund të merren parasysh. (Me qëllim të zbulimit të dates së saktë të shqyrtimit të raportit të ndonjë shteti, OJQ-të mund të kontaktojnë më herët ose me Sekretariatit e CERD-it, me qeverinë përkatëse ose misionin e përhershëm të shtetit në KB.) NB: letër njohtim nevojitet që të hyni në ndërtesën e KB-ve: dërgoni një letër Sekretariatit të CERD-it para kohe dhe tregoni qartë emrat e përfaqësuesëve të OJQ-ve që shprehin dëshirë të marrin pjesë.

Organizoni një takim të shkurtër për njohtim:

OJQ-të mund të orvaten të caktojnë një takim të shkurtër joformal për anëtarët e Komisionit që do të zgjaste më

së shumti një orë (zakonisht gjatë kohës së drakes), para se Komisioni ta shqyrtojë raportin e ndonjë shteti anëtarë. Takimet e tilla mund të shfrytëzohen për të sqaruar çështjet dhe problemet dhe t'u përgjigjen pyetjeve të cilët anëtarët do ti parashtronë. Këta takime mund të organizohen në këshillime dhe me ndihmën e sekretarit të CERD-it, ARIS-it dhe Raportuesit të Shtetit. Shumë anëtarë të Komisionit na treguan për dobinë e takimeve të tilla.

Lobimi:

Faqësisht, OJQ-të nuk kanë të drejtë të japin deklarata gjatë mbledhjes, por mund të mundohen të vendosin kontakte joformale me anëtarët e Komisionit jashta orëve të mbledhjes, përveç organizimit të një takimi të shkurtër që e sqaruar më lartë. Mirëpo, nderoni orarin e çdo anëtari sepse ai duhet të merret me më shumë se 10 shtete për tre (ose katër) javë.

Vëzhgimi i mbledhjes — një sqarim i shkurtër për vizitorët e ri

Mbledhjet e CERD-it zakonisht mbahen te Dhoma për Konferenca XI (11) në “the Palais des Nations” — Zyra e KB-ve në Gjenevë, Zvicër.³⁹ Tavolinat janë të rregulluara në formë të pakuaj dhe kariket në të dy anët janë të rezervuara për 18 anëtarët e CERD-it. Kryetari (ose kryesuesi), detyra e të cilit është ta udhëheq mbledhjen gjendet në krye të patkuajt, e cila është në anën e majtë kur hyni në dhomë. Delegacioni i shtetit përkatës ulet në anën e djathtë të kryetarit dhe në anën e majtë është sekretari i cili është përgjegjës për punë teknike. Shtypi dhe përfaqësuesit e organeve të KB-ve ulen tavëlinën në qendër. Që ta vëzhgojn mbledhjen, OJQ-të mund të ulen te këndi i publikut e cila ndodhet në anën e djathtë të hyrjes. Raportet e shteteve të mbledhjes ndodhen në tryezën e shkrimit afër hyrjes. Informatat për shtypin për çdo mbledhje gjenden në tavolinën në qendër. Tërë biseda do të përkthehet në mënyrë simultane në gjuhën angleze, frenge dhe spanjole dhe përveç tyre në arabisht, kinezisht ose rusisht, kur anëtarët e Komisionit ose delegacioni i shtetit fol në ato gjuhë.

Orari që zakonisht ndiqet për shqyrtimin e raportit të shtetit është si vijon:

Mbledhje pasdite prej 15:00 deri 18:00 h :

- fjalim hyrës nga kryesuesi dhe i dëshiron mirëseardhje delegacionit të shtetit;
- kryesuesi i delegacionit të shtetit e paraqet raportin e shtetit dhe mund të shtoj komente dhe informata plotësuese për raportin;
- komente analitike dhe pyetje nga Raportuesi i shtetit;
- komente dhe pyetje nga anëtarët tjerë të Komisionit; and
- delegacioni menjëherë mund tu përgjigjet këtyre pyetjeve nëse ka informata në

dispozicion, përndryshe do tu përgjigjet të nesërmen e ardhshme.

The following morning, meeting from 10 a.m. to 1 p.m.:

- përgjigje nga delegacioni;
- komente/pyetje plotësuese nga anëtarët e Komisionit, nëse dëshirojnë ta bëjnë atë;
- konkludimi nga Raportuesi i Shtetit;
- vërejtjet e fundit nga delegacioni; dhe
- mbyllja e mbledhjes.

Raportuesi i Shtetit i harton Konkludimet; këta merren parasysh në tërësi kah fundi i mbledhjes për miratim nga Komisioni. Këta Konkludime i paraqesin pikëpamjet e përbashkëta të Komisionit dhe si që do të sqarohet më poshtë, janë një mjet i rëndësishëm për veprimet e ardhshme.

Si ta ndiqni mbledhjen nga jashta

OJQ-të që nuk kanë mundësi të vijnë në Gjenevë, prap se prap mund ta ndjekin mbledhjen duke u këshilluar me lajmërimin për shtyp, të cilin mund ta gjeni në vebfaqen e Zyrës së Komesariatit të Lartë mbi të Drejtat e Njeriut (www.unhcr.ch). Një lajmërim për shtypin publikohet për çdo mbledhje (mbledhje tre orësh që mbahet ose paradite ose pas dite, llogaritet si një) në ditën e ardhshme. Lajmërimet për shtypin, pasi që nuk janë dokumente zyrtare të KB-ve, nuk shpërndahen te tavolina e dokumentacionit në Zyrën e KB-ve në Gjenevë. **Procesverbalet** janë përshkrime zyrtare të punës së Komisionit, këta mund të merren nga e njehta vebfaqe ose mund të porositen nga tavolina e dokumentacionit të KB-ve. Numri i dokumentit i çdo procesverbali fillon me CERD/C/SR. , dhe ndiqet nga numri i mbledhjes. Këta numra mund të gjinden duke i kërkuar konkludimet dhe të cilat do të përmenden në paragrafin e parë. Ju lutemi, veni re se procesverbalet do të publikohen disa javë pas mbledhjes dhe disa herë edhe muaj më vonë.

Ata publikohen në gjuhën angleze dhe frenge, edhe pse në fillim vetëm në njërin prej këtyre gjuhëve.

C. Pas mbledhjes —hapat e ardhshme

Është mire që të grumbulloni informata për procedurat e CERD-it dhe ti shihni çështjet e ngritura nga OJQ-të të përfshira në Konkludimet, por sukcesi i vërtetë involvimit të OJQ-së në masë të madhe varet nga një proces efektiv që do të mirret pas mbledhjes.

Shembuj për hapat e ardhshme:

- OJQ-të mund ta informojnë publikun nëpërmjet medimeve ose buletinëve të vet për aspektet e rëndësishme të procedurave të CERD-it. Konkludimet mund të jenë të rëndësishme jo vetëm për shtetet por edhe për OJQ-të. Të organizoni punëtori ose

mbledhje të ngjashme mund të jetë një veprim i mirë pasi që mund të bisedoni për hapat që duhet të ndërmerren për implementimin e rekomandimeve që janë të përshtirshme në Konkludimet. Analiza dhe komentimet për Konkludimet mund tu ndihmojnë njerëzve të kuptojnë implikacionet e rekomandimeve të Komisionit për situatat në vend. Poashtu i rëndësishëm është edhe përkthimi i konkludimeve në gjuhën kombëtare ose gjuhëve tjera të pakicave.

- Involvimi i parlamentarëve është i një rëndësie të veçantë në procesin e hapave të ardhshme, sepse disa nga rekomandimet mund të zbatohen vetëm nëse sillen ose ndryshohet ndonjë ligj ose nëse mirren masa tjera administrative ose legjislative.
- OJQ-të poashtu mund tu afrohen ministrive/ departamenteve relevante, pushtetit lokal, shoqatave ose sindikatave që ti njoftojnë me obligimet e shtetit sipas Konventës dhe rekomandimet e CERD-it për shtetin.
- Duke bërë presion mbi ndonjë qeveri që ti implementojë rekomandimet e Komisionit, OJQ-të poashtu mund ta tërheqin vëmendjen e traktateve ose organeve tjera të KB-ve, Komisionin mbi të Drejtat e Njeriut ose organet ndihmëse të tij — për ato rekomandime të cilat kanë rëndësi të veçantë për organizatat e tyre individuale.
- Konkludimet poashtu mund të përdoren edhe në korniza tjera — rajonale dhe ndërkombëtare — për shembull, ERRC-ja na informoi se ajo iu referohet atyre kur e sheh të udhës në informimet e saja ligjore para, psh, Gjyqit European mbi të Drejtat e Njeriut në Strazburg.

Aktivitetet e ardhshme, në veçanti në lidhje me rekomandimet e përfshira në Konkludimet duhet të konsiderohen në mënyrë simultane sikur faza e parë e përgatitjes së raportit tjetër plotësues.

Ilustrim – Aktivitetet tjera që i ndërmorri Mundo Afro

Pas shqyrtimit të raportit të Uruguajt nga CERD-i në gusht 1999, Mundo Afro morri një kopje të Konkludimeve. Organizata dërgoi kopje të raportit të tyre deri te shtypi që të botohen, mbajti një konferencë shtypi dhe i dërgoi një letër Ministrisë së Punëve të Jashtme të Uruguaj në të cilën i pyette për masat që do të ndërmerreshin në bazë të Konkludimeve të CERD-it. Mundo Afro poashtu organizoi seminare në bashkëpunim me organizata tjera që ti organizojnë Konkludimet dhe veprimet e mundshme që do të ndërmerren për

implementimin e tyre. Në kuadër të zgjedhjeve presidenciale në Uruguaj (që u mbajtën në nëntor 1999) anëtarët e Mundo Afro organizatës i intervistuan të gjithë kandidatët duke i pyetur për qëndrimin e tyre në lidhje me implementimin e Konkludimeve të CERD-it. Më tutje, Mundo Afro ka marrë pjesë në komisione të organizuara nga organet e studentëve të univerziteteve në të cilat u dërguan kopje të Konkludimeve të CERD-it. Tani punon në një projekt arsimor më të madh që përqëndrohet te CERD-i.

Ilustrim – Orari vijues i aktiviteteve të kryera nga OJQ-të në lidhje me shqyrtimin nga Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut (orari traktat nën ICCPR-në) për raportin e katërt periodik të Japonisë mund t'ju mundësojë OJQ-ve tjera që ta vlerësojnë kohën e nevojshme për çdo hap:

1998: korik: IMADR-i iu shpërndau pyetësorë 23 organizatave në Japoni të cilat kishin dorëzuar raporte plotësuese te Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut (HRC) në vitin 1992 në kohën kur Komisioni e shqyrtonte raportin e tretë periodik të Japonisë.

8 Shtator.: në bazë të përgjigjeve të pyetësorëve, u mbajt një mbledhje për këmbimin e informata ndërmjet organizatave të cilat planifikonin të dorëzojnë raporte plotësuese te HRC-ja në lidhje me raportin e katërt periodik të Japonisë. Në këtë mbledhje morrën pjesë tetëmbëdhjetë organizata.

22 Shtator.: Mbledhje e anëtarëve të parlamentit, OJQ-ve dhe përfaqësuesëve të ministrive të ndryshme dhe agjensioneve – duke përfshirë Ndërtimtarinë, Arsimin, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Mbrendshme, Drejtësisë, Punës, Politika Nacionale (policia) dhe mirëqenie. vazhd...

2. Ecuritë individuale të komunikimit sipas Nenit 14 të ICERD-it

Kush mund të dorëzojë një komunikatë

Përgatitja e një komunikate:

- Ato individë ose grupe që janë nën jurisdikcionin e një shteti anëtar i cili shtet i ka njohur kompetencat Komisionit sipas Nenit 14 mund të dorëzojnë një komunikatë (rregulla 91.a). Sipas kësaj rregulle, edhe ata që nuk janë banorë të shtetit përkatës mund të dorëzojnë një peticion por me kusht nëse ato kanë qenë viktimë të diskriminimit në atë shtet.
- Komunikata nuk duhet të jetë anonime (rregulla 91.a)

- Zakonisht, vetëm individi përkatës ose farefisi ose përfaqësues të emëruar mund të dorëzojnë një komunikatë. Mirëpo, në disa raste, Komisioni mund të pranojë komunikatë edhe nga të tjerët në emër të viktimës së caktuar në raste kur viktima nuk është në gjendje ta dorëzojë komunikatën vetë dhe autori i komunikatës e arsyeton veprimin e shtetit në emër të viktimës.
- Komisioni mund të pranojë peticione vetëm nga ata që pohojnë se janë viktima të shkeljes së ndonjë të drejte të paraparë në Konventë (rregulla 81), që do të thotë se ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut jashtë fushëveprimit të ICERD-it nuk mund të shqyrtohet nga Komisioni.

Harxhimi i të gjitha remediëve në vend

- Individi patjetër ti harxhojë të gjithë remediët e mundshme të vendit, ur paraqet komunikatë, përdorimin e organit ligjor kombëtarë të formuar nga paragrafi 2 i Nenit 14. Mirëpo, kjo rregull nuk do të vlen në ato raste kur zbatimi i remediëve/dëmshpërblimeve prolongohet paarsyetim (rregulla 91.e). Më tutje, Komisioni ka konstatuar se kjo rregull vlen atëherë kur: i) kur dëmshpërblimet janë adekuate dhe ii) kanë ndonjë perspektivë suksesi. Me fjalë të tjera, kur dëmshpërblimet e vendit ja joefikase a priori të padobishme, rregulla e shterjes së këtyre remediëve nuk vlen.
- Komunikata zakonisht duhet të dorëzohet brenda 6 muajsh pas shterjes së të gjitha remediëve në vend (rregulla 91.f)

Si të shkruani një komunikatë

Komunikata duhet të jetë në përputhje me klauzulat e Konventës (rregulla 91.c) dhe nuk duhet të përmbanë gjuhë fyese.

Letra duhet të përmbanë informata për:

- Emrin, adresën, moshën dhe profesionin e autorit dhe verifikimin e identitetit të tyre;
- Emrat e shtetit anëtarë ose shteteve anëtare kundër kujt drejtohet komunikata;
- Qëllimi i komunikatës;
- Klauzula ose klauzulat e Konventës që janë shkelur;
- Faktet e lutjes;
- Hapat e ndërmarra nga autori që ti shter të gjithë remediët e vendit, duke përfshirë edhe dokumentet përkatëse;
- Masa deri ku çështja shqyrtohet nga ndonjë procedure e hetimeve ndërkombëtare (rregulla 84.1.a-g)

Një mustër e komunikatës mund të gjendet në Shtojcën III

Komunikata u dërgua – çka do të ndodh me të?

Shqyrtimi i komunikatës do të bëhet në mbledhje të mbyllura (rregulla 88)

Faza para se të pranohet komunikata:

- Mund të ndodh informatat e dërguara te Komisioni mos të jenë të plota dhe të mos kuptohet pasqyra e tërë e situatës dhe mund të kërkojnë më shumë informata dhe sqarime në një kohë të kufizuar dhe të caktuar (rregulla 84.2)
- Një komunikatë mund të mos shpallet si e pranueshme derisa shteti anëtarë ta ketë pranuar tekstin e komunikatës dhe është dhënë mundësi për furnizim me informata të mëtutjeshme (rregulla 92.3). Nëse nuk respektohet afati i fundit të cilin e cakton Komisioni për dorëzimin e informatave plotësuese nga shteti anëtarë, Komisioni mund të vendos se komunikata është e pranueshme në bazë të informatave që janë në dispozicion (rregulla 92.6)

Shqyrtimi i komunikatave sipas meritave të tyre:

- Nëse të gjithë kushtet formale plotësohen dhe komunikata pranohet, do të shqyrtohet sipas meritave të saj. Komisioni, në mënyrë sekrete, do t'ia transmetojë tekstin e komunikatës, nëpërmjet Sekretarit Gjeneral dhe informata tjera relevante shtetit anëtarë dhe do ta informojë lutësin për komunikatën dhe vendimin (rregulla 94.1). Në parim, identiteti i individit nuk zbulohet vetëm nëse ai/ajo nuk kanë dhënë përlqim për këtë. Komisioni mund të kërkojë nga shteti anëtarë që brenda tre muajsh të dorëzojë sqarime ose deklarata në formë të shkruar që e sqaron rastin për dëmshpërblimet ose shqyrtimet që shteti i ka ndërmarrë për këtë rast (rregulla 94.2).
- Gjatë shqyrtimit, Komisioni mund të kërkojë nga shteti anëtarë që të marrë masa të përkohshme që tu shmanget dëmeve të personit i cili pohon se ka qenë viktimë e shkeljes (rregulla 94.3). Kjo nuk e gjykon parakohe as mendimin e vet përfundimtar për meritat e komunikatës as sugjerimet dhe rekomandimet eventuale.
- Më tutje, Komisioni mund ta ftojë lutësin ose përfaqësuesin e tij/saj dhe përfaqësuesit e shtetit anëtarë përkatës që të jenë të pranishëm në shqyrtimin e Komunikatës me qëllim të sigurimit të informatave plotësuese (rregulla 94.5). Mirëpo, deri më tani

Komisioni ende nuka ka përdorur ndëgjime gojore.

- Pas shqyrtimit të komunikatës, Komisioni do ta jap mendimin e vet. Mendimi i Komisionit së bashku me sugjerimet dhe rekomandimet që do të dëshiroj ti jap do ti dërgohet lutësit dhe shtetit anëtarë përkatës, nëpërmjet Sekretarit Gjeneral (rregulla 95.3).

Komisioni në raportin e vet vjetor kyç edhe një përmbledhje të komunikatave të shqyrtuara dhe nëse duhet, një përmbledhje të sqarimeve dhe deklaratave të shtetit anëtarë në lidhje me veprimet që i ka marr në përputhje me rekomandimet dhe sugjerimet e Komisionit (rregullat 95 dhe 96). Poashtu edhe teksti i plotë i vendimeve të Komisionit riprodhohen dhe paraqiten në një shtojcë në raportin e tij vjetor.

Pas mbledhjes – hapat e ardhshme:

Ashtu sikurse në rastin e procedurave të raportimit, është e rëndësishme që OJQ-të të bëjnë mbikqyrjen e rekomandimeve dhe sugjerimeve të Komisionit nga ana e shtetit anëtarë.

3. Aktivitetet tjera që OJQ-të mund të dëshirojnë ti marrin parasysh

Në kuadër të ICERD-it, OJQ-të poashtu mund të ndërmarrin ndonjë prej aktiviteteve vijuese:

Propagandimin e informatave:

OJQ-të mund:

- ti publikojnë dokumentet e ndërlidhura me ICERD-in;
 - ti përkthejnë në gjuhët kombëtare ose gjuhët pakicave tjera;
 - ti afrohen pushtetit lokal; urbaniznit, organet e arsimit dhe shëndetësisë; policisë; organeve trajnuese dhe agjensioneve tjera dhe ti këshillojnë për atë se si mund ti shmangen diskriminimit;
 - të fillojnë me fushata publike për arsimim që ta ngrejë vetëdijen për çështjet racore dhe ti nxisin tjerër që ta luajnë pjesën e tyre për krijimin e një shoqërie të drejtë;
 - të organizojnë seminare dhe punëtori për opinionin e përgjithshëm si edhe për grupet qëllimore për ndonjë çështje konkrete që është relevante për diskriminimin racor në shtet;
- Anëtarët e CERD-it mund të ftohen që të japin dijeninë e tyre në këtë fushë; dhe
- të japin këshilla dhe të bëjnë prezantime qeverive për çështjen e races dhe ti informojnë anëtarët e parlamentit, partite politike, organet shtetërore dhe mediumet

Ndihmë gjatë jetësimit të ligjit:

OJQ-të mund:

- bëjnë hetime mbi firmat dhe organizatat në të cilat ekzistojnë praktikë diskriminuese; dhe
- të ndërmarrin hapa ligjore në atë raste kur shpallen konkurse për punë por me motiv diskriminues racor.

Ilustrim – Rekomandimet e Komisionit lidhur me Komunikatën nr. 10/1997

(Ziad Ben Ahmed Habassi kundër Danimarkës)

Komunikata nr. 10/1997 bën fjalë për një qytetarë nga Tunizi me leje të përhershme banimi në Danimarkë, i martuar me një qytetarë Danez, të cilit nuk i ishte aprovuar një kredi nga një bankë Daneze për shkak se nuk ishte me përkatësi

Daneze. Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni e miratoi qëndrimin⁴³ më 17 mars 1999 në të cilin rekomandoi që:

- shteti anëtarë (Danimarka) të marr masa ta kundërloftoj diskriminimin racor në tregun e kredive; dhe
- shteti anëtarë ti siguroj lutësit dëmshpërblim për dëmin e pësuar.

Shtojcat

SHTOJCA I: Statusi i Konventës

A. Shtetet anëtare që marrin pjesë te ICERD-i, që nga 16 nëntori 2000

Statusi: nënshkrues* 80; anëtarë 156

(Burimi: Traktatet Multilaterale të Vendosura me Sekretarin-Gjeneral, KB, Nju Jork.)

Afghanistan	Albania	Algeria	Antigua and Barbuda
Argentina	Armenia	Australia	Austria
Azerbaijan	Bahamas	Bahrain	Bangladesh
Barbados	Belarus	Belgium	Belize (s)
Benin (s)	Bhutan (s)	Bolivia	Bosnia Herzegovina
Botswana	Brazil	Bulgaria	Burkina Faso
Burundi	Cambodia	Cameroon	Canada
Cape Verde	Central African Republic	Chad	Chile
China	Colombia	Congo	Costa Rica
Côte d'Ivoire	Croatia	Cuba	Cyprus
Czech Republic	Democratic Republic of the Congo	Congo	Denmark
Dominican Republic	Ecuador	Egypt	El Salvador
Estonia	Ethiopia	Fiji	Finland
France	Gabon	Gambia	Georgia
Germany	Ghana	Greece	Grenada (s)
Guatemala	Guinea	Guinea-Bissau (s)	Guyana
Haiti	Holy See	Hungary	Iceland
India	Indonesia	Iran (Islamic Republic of)	Iraq
Ireland (s)	Israel	Italy	Jamaica
Japan	Jordan	Kazakhstan	Kuwait
Kyrgyzstan	Lao People's Democratic Republic	Kazakhstan	Latvia
Lebanon	Lesotho	Liberia	Libyan Arab Jamahiriya
Liechtenstein	Lithuania	Luxembourg	Madagascar
Malawi	Maldives	Mali	Malta
Mauritania	Mauritius	Mexico	Monaco
Mongolia	Morocco	Mozambique	Namibia
Nepal	Netherlands	New Zealand	Nicaragua
Niger	Nigeria	Norway	Pakistan
Panama	Papua New Guinea	Peru	Philippines
Poland	Portugal	Qatar	Republic of Korea Republic of
Moldova Romania	Russian Federation	Rwanda	Saint Lucia
Saint Vincent and the Grenadines	Senegal	Sao Tome and	Principe (s)
Saudi Arabia	Slovenia	Seychelles	Sierra Leone
Slovakia	Sri Lanka	Solomon Islands	South Africa
Spain	Sweden	Sudan	Suriname
Swaziland	the former Yugoslav Republic of Macedonia	Switzerland	Syrian Arab Republic
Tajikistan	Trinidad and Tobago	Tunisia	Togo
Tonga	Uganda	Ukraine	Turkey (s)
Turkmenistan	United Republic of Tanzania	Venezuela	United Arab Emirates
United Kingdom	Uzbekistan	Zambia	United States of America
Uruguay	Yugoslavia		Viet Nam
Yemen			Zimbabwe

*Shtetet që kanë nënshkruar por ende nuk kanë hyrë në Konventë janë shënuar me (s).

Shtojca II:

B. Deklaratat e shteteve anëtarë te ICERD-i

(Burimi: Dokumentet punuese të dorëzuara nga Znj Fran oise Hampson në mbledhjen e 51 të Nën Komisionit për Avancim dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut për deklaratat mbi traktatet e të drejtave të njeriut, 28 qershor 1999, dok. KB. E/CN.4/Sub.2/1999/28. Ky grafik ekziston vetëm në gjuhën angleze; përmirësuar nga IMADR-i më 31 dhjetor 1999.)

Neni 2.1 (d) I Konventës së Vienës për ligjin e Traktateve (1969) e definojnë termin rezervim si deklaratë unilaterale, sido që të emërohet, nga ndonjë shtet, kur, ratifikon, pranon ose hynë te ndonjë traktat, me të cilën pohon se nuk pranon ndonjë efekt ose klauzulë ligjore të traktatit në zbatimin e atij shteti . Teksti I plotë I rezervimeve ose deklaratave të dhëna nga shtetet anëtare të ICERD-i mund të gjinden në dok. ST/LEG/SER/E./18.

Neni 1	Neni 2	Neni 3	Neni 4	Neni 5	Neni 6
UK (1)	Fiji Monaco 2(1) Switzerland 2(1)(a) Australia USA 2(1),2(1)c,2(1)d	Fiji USA	Antigua & Barbuda 4(a),(b),(c) Austria 4(a),(b),(c) Bahamas 4(a),(b),(c) Barbados 4(a),(b),(c) Belgium 4(a),(b),(c) Fiji 4(a),(b),(c) France Italy 4(a),(b),(c) Japan 4(a),(b),(c) Malta Monaco Nepal Papua New Guinea 4(a),(b),(c) 4(a),(b),(c)	Fiji (c),5(d)(v),5(e)(v) Tonga 5(d)(v) UK 5(c) USA	Fiji France Italy Malta Tonga UK

Neni 7	Neni 15	Neni 17	Neni 18	Neni 20	Neni 22
USA	Fiji France Tonga UK	Afghanistan Belarus 17 (1) Bulgaria 17 (1) Hungary 17 (1) Mongolia 17 (1) Poland 17 (1) Romania Russian Federation Ukraine 17 (1) Viet Nam 17 (1) Yemen 17 (1)	Afghanistan Bulgaria 18(1) Hungary 18(1) Poland 18(1) Romania Russian Federation Viet Nam 18 (1) Yemen 18 (1)	Fiji Tonga UK	Afghanistan Bahrain China Cuba Egypt India Indonesia Iraq Israel Kuwait Lebanon Libyan Arab Jamahirija Madagascar Morocco Mozambique Nepal Rwanda Saudi Arabia Spain Syria USA Viet Nam Yemen

C. Ankesat individuale të shqyrtuara sipas procedurës së udhëhequr të Nenit 14 të ICERD-it që nga 11 tetori 2000

Shtet*	Data**	Në procedurë		Raste të Mbaruara		Gjithsejt
		Para dorëzimit	të Pranuar			
ALGERIA	12/09/89	-	-	-	-	-
AUSTRALIA	28/01/93	1	-	1 (nr 7/1995) (nr12/1998)	0/2(nr 8 /1996) (nr6/1995)	4
BELGIUM	10/10/00	-	-	-	-	-
BULGARIA	12/05/93	-	-	-	-	-
CHILE	18/05/94	-	-	-	-	-
COSTA RICA	08/01/74	-	-	-	-	-
CYPRUS	30/12/93	-	-	-	-	-
CZECH REPUBLIC	11/10/00	-	-	-	-	-
DENMARK	11/10/85	-	-	1 (nr 5/1994)	2(nr10/1997) (nr 16/1999) 1(nr17 1999)	4
ECUADOR	18/03/77	-	-	-	-	-
FINLAND	16/11/94	-	-	-	-	-
FRANCE	16/08/82	-	-	-	0/1(nr2/1989)	1
HUNGARY	13/09/90	-	-	-	-	-
ICELAND	10/08/81	-	-	-	-	-
ITALY	05/05/78	-	-	-	-	-
LUXEMBOURG	22/07/96	-	-	-	-	-
MALTA	16/12/98	-	-	-	-	-
MACEDONIA	29/12/99	-	-	-	-	-
NETHERLANDS	10/12/71	1 (nr 15/1998)	-	-	2(nr 1/1994) (nr 4/1991)0 1(nr 3/1990)0	3
NORWAY	23/01/76	-	-	-	-	1
PERU	27/11/84	-	-	-	-	-
POLAND	01/12/98	-	-	-	-	-
PORTUGAL	24/03/00	-	-	-	-	-
REPUBLIC OF KOREA	05/03/97	-	-	-	-	-
RUSSIAN FEDERATION	01/10/91	-	-	-	-	-
SENEGAL	03/12/82	-	-	-	-	-
SLOVAKIA	17/03/95	-	2(nr11/1998)	-	1(nr13/1998)0	2
SOUTH AFRICA	09/01/99	-	-	-	-	-
SPAIN	13/01/98	-	-	-	-	-
SWEDEN	06/12/71	1(nr 14/1998)	-	1(nr1/1197)	-	2
UKRAINE	28/07/92	-	-	-	-	-
URUGUAY	11/09/72	-	-	-	-	-
32	-	2	1	4	6/4	17

(1) raste që tregojnë shkelje (2) raste që nuk tregojnë shkelje

* Shtetet anëtare që e kanë pranuar autoritetin e Komisionit sipas Nenit 14 të Konventës ** hyrja në fyqi

Shtojca II: Një format mustër për komunikata/ankesa

(Burimi: Faqa e fakteve mbi të Drejtat e Njeriut Nr. 7: Ecuritë e komunikatave, KB, Gjenevë.)

Disa organe që merren me komunikata kanë zhvilluar një format mustër që ta lehtësojnë shqyrtimin e tyre për shkeljet që paraqiten të të drejtave të njeriut dhe këta janë në dispozicion të atyre që dëshirojnë të paraqesin raste të shkeljes së të drejtave të njeriut. Mirëpo, duhet të veni re se komunikatat shqyrtohen edhe kur nuk janë të shkruara në këtë form të formatit.

Pa marrë parasysh formatin që shfrytëzohet, adresa e saktë për organin kujt i dërgohet rasti për shqyrtim duhet të jetë në fillim të komunikatës që të mund menjëherë të shkojë te personi kujt i adresohet.

Ankesë Model

Data

Deri te:

Sekretariatit

Komisionit për Eliminimin e Diskriminimit Racor c/o Zyra e Komesariatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut Palais des Nations, 1211 Gjenevë 10, Zvicër

I. Informata për autorin e komunikatës/ankesës

Emri Emri(at)

Kombësia..... Profesionit

Data dhe vendi i lindjes

Adresa momentale

Adresa për këmbimin e korespondencës sekrete (nëse keni tjetër përveç adresës momentale)

Ankesën e dorëzoni si:

- (a) Viktimë e shkeljes ose shkeljeve të paraqitura më poshtë
- (b) Përfaqësuesi i caktuar/juristi i viktimave të përmendur
- (c) të tjera

Nëse e shënoni kutinë (c), autori duhet të sqaroj:

(i) në çfarë kapaciteti ai/ajo vepron në emër të viktimës/ave (psh.farefisni ose lidhje tjera personale me viktimën/at

(ii) Pse nuk mundën vetë viktimat ta dorëzojnë komunikatën

Pala e tretë që ska lidhje me viktimën/at nuk mund ta dorëzojë komunikatën në emrin e tij/saj

II. Informata për viktimën/at (nëse ka përveç autorit)

Emri Emri(at)

Kombësia..... Profesionit

Data dhe vendi i lindjes.....

Adresa momentale ose ku

III. Shteti pëkatës/Nenet e shkelura/dëmshpërblimet e vendit

Emri i shtetit anëtarë në Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor kundër kujt drejtohet

Nenet e Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të cilat janë shkelur

Hapat e marrura nga viktimat/at që ti shterin të gjitha dëmshpërblimet e vendit — me anë të gjyqit ose ndonjë organi tjetër,

Kur dhe çfarë rezultati (nëse mundet, ngjitni kopje të të gjithë vendimeve administrative ose gjyqësore)

Nëse nuk i keni shterur dëmshpërblimet e vendit, sqaroni pse

IV. Ecuri tjera ndërkombëtare

A ka qenë dorëzuar çështja e njejtë për shqyrtim me ndonjë ecuri tjetër të hetimeve ndërkombëtare (psh Komisioni Ndër Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut, Komisioni European mbi të Drejtat e Njeriut)? Nëse po, kur dhe çka ishte rezultati?

V. Argumentet e ankesës

Përshkrim detal të fakteve për shkeljen e klauzulave (duke përfshirë edhe data relevantes)*

Nënshkrimi i autorit

* Shtoni sa më shumë faqe që mundeni për këtë përshkrim.

Shtojca III: Rekomandimet e Përgjithshme të miratuara nga CERD-i

A. Lista e Rekomandimeve të Përgjithshme

Broj	Sodri na	Sesija
I	Obligimet e Shteteve anëtare (Neni 4)	Sesioni 5 (1972)
II	Obligimet e shteteve anëtare(Neni 9)	Sesioni 5 (1972)
III	<i>Apartheidi</i>	Sesioni 6 (1972)
IV	Struktura demografike e popullsisë	Sesioni 8 (1973)
V	Neni 7 I Konventës	Sesioni 15 (1977)
VI	Raportet e Vonuara	Sesioni 25 (1982)
VII	Neni 4 i Konventës	Sesioni 32 (1985)
VIII	Neni 1.1 dhe 1.4, i Konventës	Sesioni 38 (1990)
IX	Neni 8.1 i Konventës	Sesioni 38 (1990)
X	Asistenca teknike	Sesioni 39 (1991)
XI	Jo Qytetarët	Sesioni 42 (1993)
XII	Shtetet trashëguese	Sesioni 42 (1993)
XIII	Trajnimi i Policëve	Sesioni 42 (1993)
XIV	Neni 1.1 i Konventës	Sesioni 42 (1993)
XV	Dhuna e organizaur mbi baza etnike (Neni. 4)	Sesioni 42 (1993)
XVI	Përmendja e situatave në shtetet tjera	Sesioni 42 (1993)
XVII	Formimi i institucioneve shtetërore për lehtësimin e zbatimit të Konventës	Sesioni 42 (1993)
XVIII	Formimi i një tribunali ndërkombëtarë për ndjekjen e krimeve kundër njerëzisë	Sesioni 44 (1994)
XIX	Neni 3 i Konventës	Sesioni 47 (1995)
XX	Zbatim jodiskriminues i të drejtave dhe lirive (Neni 5)	Sesioni 48 (1996)
XXI	E drejta për vetëvendosje	Sesioni 48 (1996)
XXII	Neni 5 dhe refugjatët dhe të zhvendosurit	Sesioni 49 (1996)
XXIII	Popujt vendas	Sesioni 51 (1997)
XXIV	Neni 1 i Konventës	Sesioni 55 (1999)
XXV	Diskriminim racor në bazë të gjinisë	Sesioni 56 (2000)
XXVI	Neni 6 i Konventës	Sesioni 56 (2000)
XXVII	Diskriminimi i Romëve	Sesioni 57 (2000)

B. Teksti i plotë i Rekomandimeve të Përgjithshme

Sipas Nenit 9, alinea 2 i ICERD-it, Komisioni mund të jap sugjerime dhe Rekomandime të Përgjithshme duke u bazuar në shqyrtimin e raporteve dhe informatave të pranuar nga shtetet anëtare. Sugjerimet e tilla dhe Rekomandimet e Përgjithshme duhet ti raportohen Asamblesë Gjenerale së bashku me komentet, Nëse ka ndonjë koment, nga shtetet anëtare. Deri tani, Komisioni ka miratuar 27 Rekomandime të Përgjithshme.

Rekomandimi i Përgjithshëm I (sesioni i 5-të, 1972)

Në bazë të shqyrtimit të raporteve të shteteve anëtare në sesionin e 5-të sipas nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Komisioni konstatoi se legjislacioni i disa shteteve anëtare nuk i përmbanin klauzulat e parapara në Nenin 4 (a) dhe (b) të Konventës, implementimi i të cilëve është i domosdoshëm për të gjithë Shtetet Anëtare (sipas parimeve të paraqitura në Deklaratën Univerzale mbi Të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat qartë të parapara me Nenin 5 të Konventës).

Sipas kësaj, Komisioni rekomandoi se shtetet anëtare legjislacioni i të cilëve ishte i mangët lidhur me këtë duhet ta marrin parasysh çështjen e plotësimit të legjislacionit - në përputhje me procedurat legjislative kombëtare - me klauzula që janë në përputhje me Nenin 4 (a) dhe (b) të Konventës.

Rekomandimi i Përgjithshëm II (sesioni i 5-të, 1972)

Komisioni i ka shqyrtuar disa raporte të shteteve anëtare të cilët shprehnin bindjen se informatat e përmendura në komunikatën e Komisionit të 28 janarit 1970 (CERD/C/R.12), nuk duhet të jipen nga shtetet anëtare në teritoret e të cilëve diskriminimi racor nuk ekziston. Mirëpo, në përputhje me Nenin 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, të gjithë shtetet anëtare duhet të dorëzojnë raporte për masat që i kanë marrë për miratimin dhe hyrjen në fuqi të klauzulave të Konventës dhe pasi që të gjithë kategoritë e përmendura në komunikatën e Komisionit të 28 janarit 1970 iu referohen obligimeve që shtetet anëtare i kanë sipas Konventës, ajo komunikatë iu drejtohet të gjithë shteteve anëtare pa dallim, pa marrë parasysh se a ekziston diskriminim racor në teritorin e tyre ose jo.

Komisioni e përshëndet të gjithë ato shtete anëtare që deri më tani i kanë përfshirë të gjithë informatat e nevojtura në përputhje me të gjithë atë që u përmend në komunikimin paraprak të Komisionit.

Rekomandimi i Përgjithshëm III (sesioni i 6-të, 1972)

Komisioni ka shqyrtuar disa raporte të shteteve anëtare që përmbanin informata për masat që janë marrë për zbatimin e rezolutave të organeve të KB-ve lidhur me marrëdhëniet me regjimet raciste në Afrikën Jugore. Komisioni vëren se në paragrafin 10 të preambulës së Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, shtetet anëtare kanë vendosur, midis tjerash, të ndërtojnë një bashkësi ndërkombëtare që do të jetë e lira prej të gjithë formave të ndarjes racore dhe diskriminimit racor.

Ai poahtu vëren se në Nenin 3 të Konventës, Shtetet anëtare e dënojnë bdarjen racore dhe apartheidin.

Më tutje, Komisioni vëren se në rezolutën 2784 (XXVI), sekcioni III, Asambleja Gjenerale pas shqyrtimit të raportit të dytë vjetor të Komisionit dhe me miratimin e disa prej mendimeve dhe rekomandimeve, vazhdoi tu bëj thirrje të gjithë partnerëve tregtarë të Afrikës Jugore të përmbahen nga veprimet që mund të shkaktojnë shkelje të vazhdueshme të parimeve dhe qëllimeve të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor nga ana e Afrikës Jugore dhe regjimi ilegal në Rhodezinë Jugore . Komisioni e shpreh mendimin se masat e zbatuara për vënien në fuqi të klauzulave të Konventës janë të ndërlidhura me masat që meren në nivelin ndërkombëtar dhe shërbejnë për nxitjen kudo të respektit për parimet e Konventës. Komisioni poashtu i përshëndet ata shtete anëtare që me dëshirën e vet në raportet e dorëzuara, sipas Nenit 9, paragrafi 1 i Konventës, përfshijnë informata lidhur me statusin e marrëdhënies të veta diplomatike, ekonomike dhe marrëdhëniet tjera me regjimin racist të Afrikës Jugore.

Rekomandimi i Përgjithshëm IV (sesioni i 8-të, 1973)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor, Pas shqyrtimit të raporteve të dorëzuara nga Shtetet Anëtare sipas Nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor në sesionin e shtatë dhe tetë, duke e pasur parasysh nevojën se raportet që i dërgohen Komisionit nga shtetet anëtare duhet të janë sa më informative që mundin i fton shtetet anëtare që të përpiqen të përfshinë, sipas nenit 9, informata relevante në raport për strukturën demografike të popullsisë që përmendet në klauzulën e Nenit 1 të Konventës.

Rekomandimi i Përgjithshëm V (sesioni i 15-të, 1977)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor, duke i pasur parasysh klauzulat e nenit 7 dhe 9 të Konventës Ndërkombëtare Mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, bindi se luftimi kundër paragjykimeve që çon kah diskriminimi racor,

promovimin e mirëkuptimit, tolerimit dhe propagimit të parimeve dhe qëllimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të deklaratave për të drejtate njeriut dhe instrumenteve tjera relevante të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e KB-ve janë mjete të rëndësishme dhe efikase për eliminimin e diskriminimit racor,

mirëpo duke pasur parasysh se obligimet sipas Nenit 7 të Konventës, të cilat janë obliguese për të gjithë Shtetet Anëtare, duhet patjetër të respektohen nga ata, duke i përfshirë edhe Shtetet që deklarojnë se diskriminimi racor nuk praktikohet në teritorët që janë nën jurisdikcionin e tyre,

dhe prandaj prej të gjithë shteteve anëtare kërkohet që të përfshinë në raport edhe informata lidhur me zbatimin e klauzulave të atij Neni që e dorëzojnë në përputhje me nenin 9, paragrafi 1, të Konventës,

duke vërejtur me keqardhje se vetëm pak Shtete Anëtare, në përputhje me nenin 9 të Konventës, kanë përfshirë në raportin e tyre pak informata për masat që i marri dhe të cilat i vënë në fuqi klauzulat e nenit 7 të Konventës dhe se ata informata shumë shpesh kanë qenë të përgjithshme dhe sipërfaqësore,

duke i përkujtuar se sipas nenit 9, paragrafit 1 të Konventës, Komisioni nga shtetet anëtare mund të kërkojë edhe më shumë informata plotësuese,

1. Të kërkojë që çdo shtet anëtarë që nuk ka përfshirë informata relevante— në raportin e ardhshëm ose në një raport të veçantë, sipas nenit 9 të Konventës të dorëzoj informata adekuate në lidhje me masat të cilat i ka ndërmarrë dhe me ndihmën e të cilave kanë hyrë në fuqi klauzulat e nenit 7 të Konventës;

2. T'ja tërheq vëmendjen shtetit anëtare se, sipas nenit 7 të Konventës, informatat për të cillat bën fjalë paragrafi paraprak duhet të përfshijnë edhe informata për masat e menjëhershme dhe efikase të cilat shteti i ka ndërmarrë në fushën e mësimdhënies, arsimit, kulturës dhe informatikës me qëllim të:

(a) Luftës kundër paragjykimeve që çojnë kah diskriminimi racor;

(b) Promovimin e mirëkuptimit, tolerimit dhe miqësisë ndërmjet grupeve nacionale, etnike ose racore;

(c) Propagojnë qëllimet dhe parimet e Kartës së KB-ve, Deklaratës Universale për të Drejtate Njeriut, Deklarata e KB-ve mbi eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor si edhe Konventën Ndërkombëtare mbi eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

Rekomandimi i Përgjithshëm VI (sesioni i 25-të, 1982)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor, Duke e njohur faktin se një numër mahnitës i shteteve e kanë ratifikuar ose ka hyrë në Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor,

Duke pasur parasysh se vetëm ratifikimi nuk mundëson që sistemi kontrolues i krijuar nga Konventa të funksionoj në mënyrë efikase,

Duke i përkujtuar se neni 9 i Konventës i obligon Shtetet Anëtare të dorëzojnë raporte fillestare dhe periodike sipas masave të cilat mundësojnë që klauzurat e Konventës të hynë në fuqi,

Duke thenë se momentalisht së paku 89 raporte janë të vonuara nga 62 shtete, se 42 nga ato raporte janë të vonuara nga 15 Shtete, secili shtet me nga një ose dy raporte të vonuara dhe 4 raporte fillestare që duheshin të dorëzohen në mes viteve 1973 dhe 1978 edhe nuk janë pranuar,

Duke vërejtur me keqardhje se as vërejtjet që u janë dërguar atyre shteteve nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm nuk kanë pas efekt e as edhe përfshirja e informatave relevante në raport që i është dërguar Asamblesë Gjenerale, në të gjithë rastet Komisioni,

E fton Asamblenë e Përgjithshme:

- (a) të marr shënime për situatën;
- (b) ti përdor kompetencat e veta me qëllim që të sigurojë se Komisioni ti plotësojë obligimet e veta sipas Konventës më me efikasitet.

Rekomandimi i Përgjithshëm VII në lidhje me implementimin e Nenit 4 të Konventës (sesioni 32, 1985)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

Pas shqyrtimit të raporteve periodike të Shteteve Anëtare gjatë një periudhe kohore 16 vjeçare dhe mbi 100 raste, 6, 7 ose 8 raporte periodike të shteteve anëtare,

E përkujtojnë dhe vërtetojnë Rekomandimin e tij të Përgjithshëm i të 24 shkurtit 1972 dhe vendimin e tij 3 (VII) të 4 majit 1973,

Duke vërejtur me kënaqësi se në një numër raportesh Shtetet Anëtare kanë dhënë informata për raste konkrete që kanë të bëjnë me implementimin e Nenit 4 të Konventës në lidhje me veprat e diskriminimit racor,

Mirëpo, duke vërejtur se në një numër të Shteteve Anëtare legjislativi i nevojshëm për implementimin e nenit 4 të konventës ende nuk është miratuar dhe se shumë shtete anëtare ende nuk i kanë plotësuar të gjithë kushtet e nenit 4(a) dhe (b) të Konventës,

Më tutje i përkujton se, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 4, Shtetet Anëtare marrin hapa që të miratojnë masa pozitive dhe të menjëhershme të destinuar për zhdukjen e të gjithë nxitjeve ose veprave të diskriminimit të tillë duke i pasur parasysh parimet e parapara në

Deklaratën Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat qartë të paraqitura në nenin 5 të Konventës,

Duke i pasur parasysh aspektet parandaluese të nenit 4 për zbrapsjen e racizmit dhe diskriminimit racor si edhe aktivitetet që synojnë për promovimin ose nxitjen e racizmit,

1. *U rekomandon* atyre Shteteve Anëtare legjislativi i të cilëve nuk i kënaq klauzurat e nenit 4 (a) dhe (b) të Konventës që ti marrin hapat e duhura me qëllim të kënaqjes së kushteve obliguese të atij neni;

2. *Kërkon* që ata Shtete Anëtare që nuk i kanë plotësuar këto kushte ta njoftojnë Komisionin me më shumë informata në raportet e tyre periodike për mënyrën dhe shkallën se sa me efikasitet implementohen klauzurat e nenit 4 (a) dhe (b) dhe ti citojnë pjesët relevante të tekstit në raportin e tyre;

3. *Më tej kërkon* prej atyre Shteteve Anëtare që nuk e kanë bërë këtë, të përpiqen të sigurojnë më shumë informata në raportet e tyre periodike për vendimet e marra nga gjyqet kombëtare kompetente ose institucionet tjera shtetërore lidhur me veprimet e diskriminimit racor dhe në veçanti me ato shkelje që janë paraqitur në nenin 4 (a) dhe (b).

Rekomandimi i Përgjithshëm VIII lidhur me interpretimin dhe zbatimin e nenit 1, paragrafi 1 dhe 4 të Konventës (Sesioni i 38-të, 1990)

Komisioni Mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

Pas shqyrtimit të raporteve të Shteteve anëtare lidhur me informatat për mënyrat me të cilat individët identifikohen se janë anëtarë të ndonjë grupi të caktuar etnik ose racor,

Komisioni është i mendimit se identifikimi i tillë duhet të bazohet në vetë identifikimin e atij individit, nëse nuk ekziston ndonjë justifikim i kudërt.

Rekomandimi i Përgjithshëm IX lidhur me zbatimin e Nenit 8, paragrafi 1 I Konventës (sesioni i 38-të, 1990)

Komisioni Mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

Duke pasur parasysh se respekti për pavarësinë e ekspertëve është shumë i rëndësishëm për sigurimin e vëzhgimit të plotë të të drejtave të njeriut dhe liritë fundamenatet,

Duke e përkujtuar nenin 8, paragrafin 1, të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor,

E brengosur nga tendenca se përfaqësuesit e Shteteve, organizatave dhe grupeve mund të bëjnë presion mbi

ekspertët, veçanarisht atyre që shërbejnë si Raportues të Shtetit,

Fuqimisht rekomandon se duhet ta respektojnë statusin e anëtarëve të tyre, pa rezervë, si ekspertë të pamvarur për paanësi të njohur të cilët e kryejnë funksionin e tyre me kapacitetin e vet personal.

Rekomandimi i Përgjithshëm X lidhur me asistencën teknike (sesioni i 39-të, 1991)

Komisioni Mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

Duke marrë shënime për rekomandimin e mbledhjes së tretë të personave që i kryesojnë organet e traktateve mbi të drejtat e njeriut, si që janë të parapara në Shtojcat, Asambleja e Përgjithshme në sesionin e 45 të saj, në lidhje me atë se një numër seminaresh duhet të organizohen në nivel kombëtar me qëllim të trajnimit të atyre njerëzve që janë të involvuar në përgatitjen e raportit të shteteve anëtare,

E brengosur për dështimin e vazhdueshëm të disa shteteve anëtare që marrin pjesë në Kënaventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të cilat nuk kanë plotësuar obligimet raportuese të parapara në Konventë,

Duke besuar se trajnimet dhe punëtaritë e organizuara në nivel kombëtarë mund të jenë shumë të dobishme për zyrtarët që janë përgjegjës për përgatitjen e raporteve të Shteteve Anëtare,

1. *Kërkon* që Sekretari i Përgjithshëm të organizoj, në këshillimeme Shtetet Anëtare përkatëse, trajnime dhe punëtoritë të duhura kombëtare më praktike për zyrtarët e tyre që raportojnë;

2. *Rekomandon* që të shfrytëzohen shërbimet e personelit të Qendrës për të Drejtat e Njeriut si edhe Komisionit mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor, siç duhet, për realizimin e trajnimeve dhe punëtorive të tilla.

Rekomandimi i Përgjithshëm XI për ata që nuk janë shtetas të ndonjë shteti tjetër (sesioni 42, 1993)

1. Neni 1, paragrafi 1 i Konventës Ndërkombëtare Mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e definon diskriminimin racor. Neni 1, paragrafi 2, i veçon nga ky definicion veprimet e ndonjë Shteti anëtarë të cilët bëjnë dallim ndërmjet qytetarëve dhe atyre që nuk janë qytetarë. Neni 1, paragrafi 3, e vërteton Nenin 1, paragrafin 2 duke theksuar se përveç atyre që nuk janë qytetarë, Shtetet Anëtare nuk guxojnë të diskriminojnë ndonjë kombësi të caktuar.

2. Komisioni ka vërejtur se neni 1, paragrafi 2, në disa raste është interpretuar se i shfajëson Shtetet Anëtare nga obligimet që të raportojnë për çështje lidhur me legjislacionin e shtetasve të huaj. Prandaj Komisioni

edhe një here vërteton se Shtetet Anëtare kanë obligim që plotësisht të raportojnë për legjislacionin e të huajve dhe implementimin e tij.

3. Më tutje, Komisioni vërteton se Neni 1, paragrafi 2, nuk duhet në asnjë mënyrë të interpretohet se ka të drejtë ti tërheq të drejtat dhe liritë e pranuar dhe të shprehura në instrumentet tjera e veçanarisht ato të shprehura në Deklaratën Univerzale për të Drejtat e Njeriut, Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Politike dhe Qytetare.

Rekomandimi i Përgjithshëm XII për Shtetet pasardhëse (sesioni 42, 1993)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

Duke e theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes kolektive të Shteteve Anëtare në Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor,

Duke marrë parasysh paraqitjen e Shteteve pasardhëse si rrjedhojë e shpërbërjes së Shteteve,

1. *I inkurajon* Shtetet pasardhëse që ti konfirmojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor se vazhdojnë të jenë të obliguar sipas Konventës, por nëse shtetet paraardhëse kanë qenë anëtarë të Konventës;

2. *I fton Shtetet* pasardhëse të cilët ende s'kanë hyrë në Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor që të hynë në te, nëse Shtetet paraardhëse nuk kanë qenë anëtarë të Konventës;

3. *I fton Shtetet* pasardhëse ta kenë parasysh rëndësinë e dhënies së deklaratës sipas nenit 14, paragrafi 1, të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, duke i njohur kompetencat e Komisionit mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor për pranimin dhe shqyrtimin e komunikatave individuale.

Rekomandimi i Përgjithshëm XIII për trajnimin e zbatuesve të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (sesioni 42, 1993)

1. Në bazë të nenit 2, paragrafi 1 i Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Shtetet Anëtare kanë marrë përobbligim se i gjithë pushteti lokal dhe institucionet publike, kombëtarë dhe lokal, nuk do të ushtrojnë diskriminim racor në anjë mënyrë; më tutje, Shtetet anëtare kanë marrë për obligim që ti garantojnë të drejtat e paraqitura në nenin 5 të Konventës për çdo njërin pa dallim race, ngjyre ose përkatëse etnike ose kombëtare.

2. Përfillja e këtyre obligimeve shumë varet nga zbatuesit e ligjit të cilët ushtrojnë fuqi policore, në veçanti fuqitë

për arrestim dhe paraburgim dhe poashtu varet nga ajo se a kanë qenë mirë të informuar për obligimet që shteti i tyre i ka marrë përsipër sipas Konventës. Zbatuesit e ligjit duhet të marrin një trajnim intenziv për të siguruar se në kryerjen e detyrës së tyre e respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin njerëzor dhe i mbrojnë të drejtat njerëzore të të gjithë personave pa dallim race, ngjyre, kombësie ose përkatësie etnike.

3. Gjatë implementimit të nenit 7 të Konventës, Komisioni u bën thirrje Shteteve Anëtare ta rishqyrtojnë dhe përmirësojnë stërvitjen për zbatuesit e ligjit me qëllim që plotësisht të zbatohen Standardet e Konventës dhe Kodi i Sjelljes së policëve (1979). Ata poshtu duhet të përfshinë informata për këtë gjë në raportet e tyre periodike.

Rekomandimi i Përgjithshëm XIV lidhur me Nenin 1, paragrafin 1, të Konventës (sesioni 42, 1993)

1. Mos diskriminimi së bashku me barazinë para ligjit dhe mbrotja e barabartë e ligjit pa asnjë diskriminim, formon një parim kryesor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Komisioni dëshiro t'i përkujtoj Shtetet Anëtare për disa karakteristika të definicionit të diskriminimit racor në nenin 1, paragrafin 1, të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Komisioni është i mendimit se fjalët "sipas" dhe "në bazë të" në paragrafin 7 të preambulës nuk kanë dallim. Dallimi është kundër Konventës nëse ka për qëllim dëmtimin e të drejtave dhe lirive të caktuara. Kjo është konfirmuar nga Shtetet Anëtare në nenin 2, paragrafi 1 (c), që kanë theksuar se e bëjnë anulimin e çdo ligji ose praktike që ka për qëllim krijimin e diskriminimit racor.

2. Komisioni konstaton se një dallim në trajtimin e disa të drejtave nuk do të shkaktojë diskriminim nëse kriteret për atë dallim janë legjitime ose pjesë e nenin 1, paragrafit 4, të Konventës. Gjatë shqyrtimit të kriterëve që mund të kenë qenë të caktuara, Komisioni do të pranojë se veprime të caktuara mund të kenë qëllime të ndryshme. Gjatë hulumtimit që të konstatojë se a ka veprim të kundërt me Konventën ndonjë vepër, Komisioni do të hulumtoj se a ka ndikim të parsyetueshëm dhe të ndryshueshëm ajo vepër mbi ndonjë grup që dallohet ër nga raca, ngjyra, prejardhja ose përkatësia etnike ose kombëtare.

3. Neni 1, paragrafi 1, i Konventës poashtu i referohet fushës politike, ekonomike, sociale dhe kulturore; të drejtat dhe liritë janë paraqitur në nenin 5.

Rekomandimi i Përgjithshëm XV lidhur me Nenin 4 të Konventës (sesioni 42, 1993)

1. Kur miratohej Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, neni 4 konsiderohej si një ndër më të rëndësishmit në luftën kundër diskriminimit racor. Në atë kohë, ekzistonte një frikë e madhe nga ringjallja e ideologjive

autoritare. Ndalimi i përhapjes së ideve të dominimit racor dhe ndalimi i aktiviteteve të organizuara që kishin për qëllim nxitje të dhunës racore, konsiderohej në mënyrë të duhur si kruciale. Qush atëherë, Komisioni ka pranuar dëshmi për dhunë të organizuar që bazohet në në prejardhjen etnike dhe shfrytëzimin politik të dallimit etnik. Si rrjedhojë, implementimi i nenit 4 tani është i një rëndësie thelbësore të zmadhuar.

2. Komisioni e përmend Rekomandimin e Përgjithshëm VII në të cilin ka sqaruar se klauzulat e nenit 4 janë të karakterit obligues. Për ti plotësuar këta obligime, Shtetet Anëtare nuk duhet që vetëm ta miratojnë legjislacionin e duhur por edhe të sigurojnë se ai legjislacion zbatohet me efikasitet. Për shkak se kërcënimet dhe veprat e dhunës racore lehtë çojnë kah vepra të tilla dhe krijojnë një atmosferë armiqësie, vetëm intervenimet e menjëhershme mund ti potësojnë obligimet e përgjigjes efektive.

3. Neni 4 (a) kërkon prej Shteteve anëtare që ti bëjnë të ndëshkueshme katër kategori të sjelljes së keqe: (i) përhapjen e ideve të bazuara në dominim racor ose urrejtje; (ii) shkaktim të urrejtjes racore (iii) vepra të dhunshme kundër racave ose grupeve të personave që u takojnë grupeve tjera etnike ose ngjyre; dhe (iv) nxitje vepra të tilla.

4. Sipas mendimit të Komisionit, Ndalimi I përhapjes së ideve të bazuara në dominim racor ose urrejtje është në përputhje me të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Kjo është paraqitur në nenin 19 të Deklaratës Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut neni 5 (d) (viii) të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Rëndësia e Neni 4 është shkruar në po të njejtin nen. Ushtrimi I kësaj të drejte nga ana e qytetarit mban detyra dhe përgjegjësi të veçanta, të parapara në nenin 29, paragrafi 2 të Deklaratës Univerzale, në mes të cilave obligimi për mospërhapjen e ideve raciste është i një rëndësie të veçantë. Komisioni dëshiron t'jua tërheq vëmendjen Shteteve Anëtare, neni 20 i Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike, sipas së cilës, çdo përkrahje të urrejtjes kombëtare, racore ose urrejtjes fetare që krijon nxitje drejt diskriminimit, armiqësi ose dhunë, do të ndalohet me ligj.

5. Neni 4 (a) poashtu e bën të ndëshkueshme financimin e aktiviteteve raciste të cilët Komisioni i përfshinë në paragrafin 3 më lartë, gjegjësisht, aktivitete që lindin nga dallimet etnike ose racore. Komisioni u bën thirrje Shteteve Anëtare të bëjnë hulumtime se a e plotësojnë këtë kusht ligjet shtetërore dhe implemetimi i të njejtëve.

6. Disa Shtete mendojnë se në rendin e tyre ligjor është e papërshtatshme që një organizatë ta shpallin jo të ligjshme para se anëtarët e asaj organizate të promovojnë ose nxisin diskriminim racor. Komisioni është i mendimit se neni 4 (b) vendon një barrë më të rëndë mbi ato Shtete

që të jenë më vigjilent në hetimin e atyre organizatave sa më herët. Këta organizata si edhe aktivitetet e organizuara dhe propagandat racore duhet të shpallen jo të ligjshme dhe të ndalohen. Pjesëmarrja në këta organizata duhet të ndëshkohet.

7. Neni 4 (c) i Konventës i parasheh obligimet e organeve publike. Organet publike në të nivelet administrative, duke i përfshirë edhe Komunitat janë të obliguar sipas këtij paragrafi. Komisioni beson se Shtetet Anëtare patjetër të sigurojnë se i respektojnë këta obligime dhe raportojnë për të njejtat.

Rekomandimi I Përgjithshëm XVI lidhur me zbatimin e Nenit 9 të Konventës (sesioni 42, 1993)

1. Sipas nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Shtetet Anëtare kanë për obligim që nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve të dorëzojnë raporte për shqyrtim nga Komisioni lidhur me masat e ndërmarra nga Shtetet për jetësimin e klauzulave të Konventës.

2. Në lidhje me këtë obligim të Shteteve Anëtare, Komisioni ka vërejtur se në disa raste raportet iu janë referuar situatave që ekzistojnë në Shtetet tjera.

3. Për këtë qëllim, Komisioni dëshiron ti përkujtoj Shtetet Anëtare për klauzulat e nenit 9 të Konventës në lidhje me përmbajtjen e raportit por poashtu duke e pasur parasysh edhe nenin 11, i cili është mjeti i vetëm procedural në disponim për Shtetet, se në disa situata që Komisioni i shqyrton disa shtete nuk i zbatojnë klauzulat e Konventës.

Rekomandimi i Përgjithshëm XVII lidhur me themelimin e institucioneve kombëtare për lehtësimin e implementimit të Konventës (sesioni 42, 1993)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

Duke e pasur parasysh praktikën Shteteve Anëtare për sa i përket implementimit të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor,

E bindur se është e domosdoshme që edhe më tepër ta inkurajoj themelimin e institucioneve shtetërore që do të mundësojnë implementim më të mire të Konventës the necessity to encourage further the establish,

Duke e theksuar nevojën se duhet të përfordhet edhe më tej implementimi i Konventës,

1. *Rekomandon* që Shtetet Antare të themelojnë komisione shtetërore ose organe tjera të duhura, duke i marrë parasysh parimet në lidhje me statusin e institucioneve shtetërore të cilat janë shtojcë në rezolutën Komisionin mbi të Drejtat e Njeriut 1992/54 të 3 marsit 1992 të cilat u shërbejnë, përveç tjerash, qëllimeve vijuese:

(a) Të promovojnë respekt për kënaqjen e të drejtave të njeriut pa asnjë diskriminim, sikur është paraparë qartë në nenin 5 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

(b) Ta rishqyrtojnë politikën shtetërore për mbrojtje kundër diskriminimit racor;

(c) Ta bëjnë mbikqyrjen e legjislacionet dhe të vërtetojnë se është në pajtim me klauzulat e Konventës;

(d) Ta arsimojnë opinionin për obligimet që Shtetet Anëtare i kanë marrë përsipër sipas Konventës;

(e) Ti ndihmojnë qeverisë në përgatitjen e raporteve që dorëzohen te Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor;

2. *Poashtu rekomandon* se në ato vende ku janë themeluar komisione të tilla, ata duhet të marrin pjesë në përgatitjen e raporteve dhe nëse është e mundur të përfshihen në delegacionet e shteteve që ta intenzifikoj dialogun ndërmjet Komisionit dhe Shtetit përkatës.

Rekomandimi I Përgjithshëm XVIII lidhur me themelimin e një tribunali ndërkombëtarë për ndjekjen penale të krimeve kundër njerëzimit (sesioni i 44, 1994)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

I brengosur për numrin rritës të masakreve dhe mizorive në baza etnike dhe racore që ndodhin në rajone të ndryshme të botës,

I bindur se pandëshkueshmëria e kriminelëve është një faktor i madh që kontribuon për paraqitjen dhe përsëritjen e këtyre krimeve,

I bindur për nevojën e themelimit sa më të shpejtë të një tribunali ndërkombëtarë me jurisdikcion të përgjithshëm qëllimi i të cilit do të ishte ndjekja penale e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljen e Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokoleve Plotësuese të vitit 1997 dhe përveç kësaj,

Ta kenë parasysh punën tanimë të kryer për këtë çështje nga Komisioni i Ligjit Ndërkombëtarë dhe inkurajimi i dhënë në këtë drejtim nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën e vet 48/31 të 9 dhjetorit 1993,

Poashtu duhet ta marrin parasysh rezolutën e Këshillit të Sigurimit 872 (1993) të 25 majit 1993 me të cilën u formua tribunali ndërkombëtarë me qëllim të ndjekjes së personave përgjegjës për shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar në teritorin e Jugosllavisë së mëparshme,

1. *Të mendojnë* se një tribunal ndërkombëtarë me jurisdikcion të përgjithshëm duhet të formohet sa më shpejtë për ndjekjen penale të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit duke përfshirë edhe vrasjet,

shfarosjen, skllavërimin, deportimin, burgosjen, torturimin, përdhunimin, përndjekjet në baza politike, racore dhe fetare dhe vepra tjera jonjerëzore të drejtuara kundër çfarëdo lloji të qytetërimit dhe shkeljet e rënda të Konventës së Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokolet Plotësuese të 1977 dhe përveç të tjerash;

2. I *apelon* Sekretarit të Përgjithshëm që rekomandimin momental t'ua dërgoj organeve dhe trupave kompetente të KB-ve, duke përfshirë edhe Këshillin e Sigurimit;

3. *Kërkon* që Komesariati i Lartë për të Drejtat e Njeriut të siguroj se të gjithë informatat relevante që kanë të bëjnë me krimet që u përmendën në paragrafin 1të mblidhen në mënyrë sistematike nga Qendra për të Drejtat e Njeriut që të mund të jenë të gatshme dhe në dispozicion të tribunalit ndërkombëtarë menjëherë kur të themelohe.

Rekomandimi i Përgjithshëm XIX lidhur me Nenin 3 të Konventës (sesioni 47, 1995)

1. Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor i thërret Shtetet Anëtare që tu kushtojnë vëmendje fjalëve të nenit 3, me të cilin Shtetet Anëtare obligohen ti parandalojnë, ndalojnë dhe zhdukin të gjitha praktikat e ndarjes racore dhe apartheidit në teritoret nën jurisdikcionin e shteteve individuale. Këtu apartheidit i drejtohet ekskluzivisht Afrikës Jugore, por neni ashtu i miratuar i ndalon të gjitha format e ndarjes racore në të gjithë shtetet.

2. Komisioni beson se obligimi për zhdukjen e të gjitha praktikave të kësaj natyre e përfshinë edhe obligimin për zhdukjen e pasojave nga praktikat e tilla që ndërmerren ose tolerohen nga Qeveritë paraprake në Shtet ose imponohen nga fuqi jashta Shtetit.

3. Komisioni konstaton se edhe pse gjendjet e ndarjes racore të pjesërishme ose të tërësishme në disa shtete mund të jenë krijuar nga politika e qeverisë, një gjendje e ndarjes së pjesërishme racore mund poshtu të lind nga ndonjë pasojë e padëshiruar e ndonjë veprë të personit privat. Në shumë qytete modelet qytetare ndikohen nga dalliment grupe lidhur me të ardhurat financiare, të cilat ndonjë herë kombinohen me dallimet racore, të ngjyrës, prejardhjes dhe përkatësisë kombëtare ose etnike, kështu që banorët mund të njolloosen dhe individët mund të vuajnë nga një formë të diskriminimit në të cilën bazat racore janë të përziera me baza tjera.

4. Prandaj Komisioni vërteton se gjendja e segregacionit racor mundet poashtu të lind pa iniciativën ose përzjerjen e drejtëpërdrejtë të organeve publike. Komisioni I fton të gjithë Shtetet Anëtare ta bëjnë mbikqyrjen e të gjithë trendeve të cilët mund të shkaktojnë segregacion racor, të angazhohen për zhdukjen e çfarëdo pasojë negative që mund të pasojë dhe nëse ka ndonjë veprim të tillë ta përshkruajnë në raportin e tyre periodik.

Rekomandimi i Përgjithshëm XX lidhur me implementimin jodiskriminues të të drejtave dhe lirive (Neni 5) (sesioni 48, 1996)

1. Neni 5 i Konventës i përmban obligimet e shteteve anëtare për garantimin e të drejtave dhe lirive qytetare, politike, ekonomike dhe socio-kulturore pa diskriminim racor. Duhet të vërehet se të drejtat dhe liritë të përmendura në nenin 5 nuk janë një listë e shterur. Në krye të këtyre të drejtave dhe lirive janë ato liri dhe të drejta që lindin nga Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Deklarata Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut, të quajtura kështu në preambulën e Konventës. Shumica e këtyre të drejtave janë të paraqitura në Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut. Prandaj, të gjithë Shtetet Anëtare janë të obliguar ti njohin dhe mbrojnë të drejtat e njeriut, por mënyrat se si këta obligime janë të përkthyer në rendet ligjore të shteteve anëtare mund të ndryshojnë. Neni 5 i Konventës, pavarësisht se kërkon garancë që të drejtat e njeriut do të jenë të lira nga diskriminimi racor, nuk krijon në vetë të drejta qytetare, politike, ekonomike, sociale ose kulturore, por e supozon ekzistimin e këtyre të drejtave. Konventa i obligon Shtetet që ta ndalojnë dhe zhdukin diskriminimin racor në kënaqjen e të drejtave të tilla të njeriut.

2. Kurdo që ndonjë Shtet imponon restriksion mbi ndonjë të drejtë të paraparë në nenin 5 të Konventës që zbatohet dukshëm nën jurisdikcionin e atij shteti, duhet që të siguroj që restriksioni të mos jetë në mospërputhje me nenin 1të Konventës „as në qëllim as në efekt, si pjesë përbërëse e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Që të konstatohet se kështu qëndrojnë punët, Komisioni obligohet të bëj hetime edhe më tutje që të sigurohet se ndonjë restriksion i tillë nuk shkakton diskriminim racor.

3. Shumë të drejta dhe liri të përmendura në nenin 5 sikurse e drejta për trajtim të barabartë para tribunaleve, duhet të kënaqen nga të gjithë personat që jetojnë në shtetin përkatës; të drejtat tjera sikurse e drejta për marrje pjesë në zgjedhje, për votim dhe kandidim janë të drejta të qytetarëve.

4. Shteteve Anëtare u rekomandohet që të raportojnë një nga një për implementimin jodiskriminues të të gjithë të drejtave dhe lirive të përmendura në nenin 5 të konventës.

5. Të drejtat dhe liritë e përmendura në nenin 5 të Konventës dhe të drejtat e ngjashme duhet të mrohen nga Shteti Anëtarë. Mbrojtja e tillë mund të arrihet në mënyra të ndryshme, nëpërmjet përdorimit të institucioneve publike ose nëpërmjet aktiviteteve të institucioneve private. Në të dyja rastet, është obligim i Shtetit Anëtarë përkatës që të siguroj zbatim efikas të Konventës dhe të raportoj për ta sipas nenit 9 të Konventës. Shteti Anëtarë patjetër duhet të siguroj se

as qëllimi as efekti i zbatimit të tillë nuk krijon diskriminim racor.

Rekomandimi i Përgjithshëm XXI lidhur me të drejtën për vetëvendosje (sesioni 48, 1996)

6. Komisioni vëren se grupet etnike ose pakicat shpesh I referohen të drejtës për vetvendësjo si një bazë për gjoja të drejtën për shkëputje. Në këtë drejtim, Komisioni dëshiron ti shpreh pikpamjet vijuese.

7. E drejta për vetëvendosje të popujve është një parim themelor i ligjit Ndërkombëtarë. Kjo mbrohet në nenin 1 të Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe nenin 1 të Marrëveshjes Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike, si edhe në instrumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Marrëveshja Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike ua siguron popujve të drejtën për vetëvendosje përveç të drejtave që pakicat etnike, fetare dhe gjuhësore që ta kenë kulturën e tyre, ta ligjërojnë dhe praktikojnë fenë e vet ose ta përdorin gjuhën e vet.

8. Komisioni potencon se në pajtim me Deklaratën mbi Parimet e Ligjit Ndërkombëtarë për sa u përket Marrëdhënieve dhe Bashkëpunimit Miqësor midis Shteteve në pajtim me kartën e KB-ve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në rezolutën e vet 2625 (XXV) të 24 tetorit 1970, është detyrë e Shteteve që ta promovojnë të drejtën për vetëvendosje të popujve. Por parimi për vetëvendosje kërkon që çdo Shtet ta promovoj, me veprime të përbashkëta dhe individuale, respektin e përgjithshëm dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale në pajtim me Kartën e KB-ve. Lidhur me këtë, Komisioni ua përkujton Shteteve Anëtare Deklaratën mbi të Drejtat e Personave që u Takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Linguistike, që u miratua nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën e saj 47/135 të 18 dhjetorit 1992.

9. Lidhur me vetëvendosjen e popujve, dy aspekte duhet të dallohen. E drejta për vetëvendosje të popujve ka një aspekt të brendshëm, gjegjësisht, të drejtat e të gjithë popujve që lirisht ta realizojnë zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor pa përzierje nga jashtë. Në këtë kontekst, ekziston një lidhje me të drejtën e çdo qytetari që të marrë pjesë në realizimin e punëve publike në çdo nivel, siç përmendet në nenin 5 (c) të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Rrjedhimisht, Qeveritë ekzistojnë për përfaqësimin e të gjithë popullsisë pa dallim race, ngjyre, prejardhje dhe përkatësie kombëtare ose etnike. Aspekti i jashtëm i vetëvendosjes nënkupton se të gjithë popujt kanë të drejtë që lirisht të vendosin për statusin e tyre politik dhe vendin e tyre në bashkësinë ndërkombëtare duke u bazuar në parimin e të drejtave të barabarta që tregohet nga çlirimi i popujve prej

kolonizmit dhe nga ndalimi që popujt ti nënshtrohen pushtimit, dominimit dhe eksploatimit të huaj.

10. Me qëllim të përfaqësimit të plotë të të drejtave të të gjithë popujve Brenda një Shteti, qeveritë obligohen se do tu përmbahen dhe zbatojnë tërësisht instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në veçanti Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Shqetësimi për mbrojtjen e të drejtave individuale pa diskriminim racor, etnik, fisnor, fetar ose në baza tjera duhet ti udhëheq politikata e Qeverive. Në pajtim me nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe në pajtim me dokumentet tjera ndërkombëtare, Qeveritë duhet të tregohen të ndijeshme për të drejtat e personave që u takojnë grupeve etnike, veçanarisht të drejtën e tyre për të jetuar me dinjitet, ta ruajnë kulturën e tyre, që në mënyrë të barabartë ti ndajnë frutat e zhvillimit shtetëror dhe ta luajnë rolin e tyre në Qeverinë e shtetit ku jetojnë.

Poashtu, Qeveritë duhet të marrin parasysh, Brenda kornizave të tyre kushtetuese, që personave që u takojnë grupeve etnike ose linguistike tua jap të drejtën për angazhim në ndonjë aktivitet i cili mund të jetë i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit të personave ose grupeve të tilla.

11. Komisioni potencon se në pajtim me Deklaratën për Marrëdhënie Miqësore, asnjë aktivitet i Komisionit nuk do të interpretohet se autorizon ose inkurajon ndonjë vepër e cila mund ta ç'antarësoj ose dëmtoj plotësisht ose pjesërisht integritetin territorial ose unitetin politik të Shteteve sovraane dhe të pavarura që udhëhiqen në pajtim me parimet e të drejtave të barabarta dhe vetëvendosje për popujt dhe ato qeveri që e përfaqësojnë tërë popullin që jeton në teritorin e shtetit, pa dallim race, bindjeje ose ngjyre.

Sipas mendimit të Komisionit, ligji ndërkombëtarë nuk ka pranuar një të drejtë të përgjithshme të popujve që njëanshëm të shpallin shkëputje nga ndonjë Shtet. Në këtë drejtim, Komisioni i përmban pikpamjet e shprehura në Agjendën për Paqe (parag. 17 dhe ajo që vijon), gjegjësisht se ndarja e shteteve mund të jetë e dëmshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si edhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Mirëpo, kjo nuk e përjashton mundësinë për arritje të marrëveshjeve midis të gjithë palëve të involvuara, por me marrëveshje të lirë.

Rekomandimi i Përgjithshëm XXII lidhur me Nenin 5 dhe refugjatët dhe personat e shpërngulur (sesioni 49, 1996)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

I vetëdijshëm për faktin se konfliktet etnike, luftërat e jashtme ushtarake dhe joushtarake sjellin flukse masive të refugjatëve dhe shpërngulje të personave në baza etnike në shumë vende të botës,

Duke marrë parasysh se Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor vërtetojnë se të gjithë qeniet njerëzore kanë lindur të lirë dhe të barabartë dhe se secilit i takojnë të drejta dhe liri të barabarta, pa asnjë diskriminim racor, të ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare ose etnike,

Duke pasur parasysh Konventën e vitit 1951 dhe Protokolin e viti 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve si burim kryesor i sistemit ndërkombëtarë për mbrojtjen e refugjatëve në përgjithësi,

1. *Ua përkujton* Shteteve Anëtare nenin 5 të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, si edhe Rekomandimin e Përgjithshëm të Komisionit nr XX (48) lidhur për nenin 5 dhe përsërit se Konventa i obligon Shtetet Anëtare që ta ndalojnë dhe eliminojnë diskriminimin racor kundër të drejtave dhe lirive qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore,

2. *Potencon* në këtë drejtim set:

(a) Të gjithë refugjatët dhe personat e shpërngulur kanë të drejtë që lirisht të kthehen në shtëpitë e tyre në kushte sigurie;

(b) Shtetet Anëtare janë të obliguar që të sigurojnë se kthimi i refugjatëve dhe personave të tillë të shpërngulur kryhet vullnetarisht dhe ta respektoj parimin për mosdëbimin e refugjatëve;

(c) Të gjithë refugjatët dhe të shpërngulurit e tillë kanë të drejtë që pas kthimit në vendlindje tu kthehet prona e tyre të cilën ua kishin marrë gjatë konfliktit dhe të kompenzohen në mënyrë të duhur për pronën që nuk mund t'u kthehet. Çdo deklaratë lidhur me prona të tilla që bëhet me detyrim është i pavlefshëm;

(d) Të gjithë refugjatët dhe të shpërngulurit e tillë kanë të drejtë që pas kthimit në shtëpitë e tyre të marrin pjesë në punët publike në çdo nivel, të kenë qasje të barabartë në shërbimet publike dhe të pranojnë ndihmë rehabilitimi.

Rekomandimi i Përgjithshëm XXIII lidhur me të drejtat dhe popujt vendas (sesioni 51, 1997)

1. Gjatë praktikës së Komisionit mbi Eliminimin e Diskriminimit racor, e në veçanti në shqyrtimin e raporteve të Shteteve Anëtare sipas nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, gjendja e popujve vendas çdoherë ka qenë shqyrtuar për së afërmi dhe me një theks të veçantë. Në këtë drejtim, Komisioni vazhdimisht ka vërtetuar se diskriminimi kundër popujve vendas i takon sferës së Konventës dhe se duhet të ndërmerren të gjitha mjetet e duhura për luftimin dhe eliminimin e diskriminimit të tillë.

2. Duke vërejtur se Asambleja e Përgjithshme e shpalli Dekadën Ndërkombëtare të Popujve Vendas në Botë më 10 dhjetor 1994, Komisioni vërteton se klauzurat e Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor vlejné për popujt vendas.

3. Komisioni është i vetëdijshëm për faktin se në shumë rajone të botës, popujt vendas kanë qene dhe ende janë të diskriminuar dhe privuar nga të drejtat e tyre njerëzore dhe lirive fundamentale dhe në veçanti atyre ua kanë marrë tokën dhe burimet kolonistët, firmat komercijale dhe ndërmarrjet shtetërore. Si pasojë, ruajtja e kulturës dhe identitetit historik ka qenë dhe ende është i rrezikuar.

4. Komisioni u bën thirrje Shteteve Anëtare në veçanti që:

a. ta pranojnë dhe nderojné kulturën vendase të ndyshme si edhe historinë, gjuhën dhe mënyrën e jetës si një begati e identitetit kulturor të Shtetit dhe ta avancoj ruajtjen e të njejtave;

b. të sigurojnë se pjesëtarët e popujve vendas të jenë të lire dhe të barabartë dhe të lire nga çfarëdo diskriminimi, veçanarisht atij diskriminimi në baza të prejardhjes vendase;

c. t'u sigurojnë popujve vendas kushte për një zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshëm në pëputhje me karakteristikat e tyre kulturore;

d. të sigurojnë se pjesëtarët e popujve vendas kanë të drejta të barabarta lidhur me pjesëmarrjen e tyre efikase në jetën publike dhe asnjë vendim që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe intereset e tyre të mos merret pa pëlqimin e tyre;

e. të sigurojnë se popujt vendas të mund ti ushtrojnë të drejtat e tyre për ringjalljen e traditave dhe zakoneve kulturore dhe ta përdorin dhe ruajnë gjuhën e tyre.

5. Komisioni në veçanti u bën thirrje Shteteve Anëtare që ti njohin dhe mbrojnë të drejtat e popujve vendas që ta zhvillojnë, kontrollojnë dhe shfrytëzojnë tokën, territorin dhe burimet e tyre dhe aty ka kanë qenë të privuar nga tokat dhe territoret e veta pa pëlqimin e tyre, të marrin masa që tu kthehen ato toka dhe territori. Vetëm atëherë kur kjo nuk është e mundur për shkaqe faktike, e drejta për një rikthim të tillë duhet të zavendësohet me të drejtën për kompenzim korrekt, të drejtë dhe të menjëhershëm.

6. Komisioni edhe më tutje u bën thirrje Shteteve Anëtare që kanë popuj vendas në territorin e vet që të përfshinë në raportin e tyre periodik informata të plota lidhur me gjendjen e popujve të tillë, duke i pasur parasysh të gjithë klauzurat e Konventës.

Rekomandimi i Përgjithshëm XXIV lidhur me Nenin 1 (sesioni 55, 1999)

1. Komisioni thekson se sipas definicionit të dhënë në nenin 1, paragrafi 1, të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa iu referohet të gjithë personave që u takojnë racave ose grupeve etnike të ndryshme ose popujve vendas. Nëse Komisioni duhet ta shqyrtoj raportin periodik të ndonjë Shteti anëtarë ashtu si duhet, është thelbësore që Shtetet Anëtare ti japin informata Komisionit lidhur me praninë e grupeve të tilla në territorin e tyre.

2. Nga raportet e dorëzuara periodike te Komisioni në bazë të nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe nga informatat që Komisioni i pranon, është e dukshme se një numër Shtetesh Anëtare e pranojnë ekzistimin e grupeve etnike ose vendase Brenda territorit të tyre, por i lënë tjerët pas dore. Disa kritere duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë grupet, veçanarisht numrin e personave të involvuar dhe qenien e tyre të races, gjuhës ose kulturës irenda popullsisë.

3. Disa Shtete Anëtare dështojnë në grumbullimin e disa të dhënave për përkatësinë etnike të qytetarëve të vet ose për persona tjerë që jetojnë në territorin e tyre, por vetë vendosin se cilët grupe formojnë një grup etnik ose popull vendas të cilët duhet të trajtohen dhe njihen si të tillë. Komisioni është i mendimit se ekziston një standard ndërkombëtarë për të drejtat konkrete të njerëzve që u takojnë grupeve të tilla, së bashku me normat e pranuar të përgjithshme lidhur me të drejtat e barabarta për të gjithë dhe të mos ketë diskriminim, duke I përfshirë edhe atë që gjenden në Konventën Ndërkombëtare mbi Eliminimin të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

Njëkohësisht, Komisioni ua tërheq vëmendjen Shteteve Anëtare se zbatimi i kritereve të ndryshme dhe joobjektive me qëllim të caktimit të identitetit të grupeve etnike ose vendase, që i pranon disa dhe të tjerët i refuzon, mund të çojë kah ajo gjë që grupet e ndryshme Brenda një territory të trajtohe ndryshe.

4. Komisioni e përmend rekomandimin IV të Konventës (CERD/C/70/Rev.3), të cilën e miratoi në mbledhjen e tetë në vitin 1973 dhe paragrafin 8 të udhëzimeve të përgjithshme lidhur me formën dhe përmbajtjen e raporteve që duhet të dorëzohen nga Shtetet Anëtare sipas nenit 9, I fton Shtetet Anëtare të përpiqen që në raportet e tyre periodike të përfshijnë edhe informata relevante për strukturën demografike të popullsisë së tyre, në bazë të klauzulave të nenit 1 të Konventës, gjegjësisht, informata për racën, ngjyrën, prejardhjen dhe përkatësinë kombëtare ose etnike.

Rekomandimi i Përgjithshëm XXV lidhur me diskriminimin racor të bazuar në gjini (sesioni 56, 2000)

1. Komisioni bën vërejtje se diskriminimi racor nuk ndikon njësoj te gratë dhe burrat çdoherë.

Ekzistojnë rrethana që në të cilat vetëm gratë ndikohen nga diskriminimi racor ose ndikon te gratë në mënyrë të ndryshme ose shkallë të ndryshme se sa burrat. Një diskriminim i tillë racor shpesh nuk mund të zbulohet poqese nuk ka njohje të qartë për jetërat e ndryshme të grave dhe burrave edhe në sferën publike të jetës edhe në ate private.

2. Disa forma të diskriminimit racor mund t'ju drejtohen grave për shkak të gjinisë, si psh, dhuna seksuale që kryhet kundër grave që janë anëtarë të ndonjë grupi të caktuar etnik ose racor gjatë mbajtjes në arrest ose gjatë konflikteve të armatosura; spastrimi me force i grave vendase; abuzimi i grave punëtore në sektorin joformal ose të vendit të punësuar jashta nga punëdhënësit e tyre. Pasojat e diskriminimit racor mund të kenë ndikim vetëm te gratë, si psh, shtatëzania dhe në disa shoqëri të izoluara si pasojë e përdhunimit në baza racore. Gratë poshtu mund të pengohen që të mos marrin dëmshpërblime dhe tu drejtohen mekanizmave shtetërore, si psh, anësia e gjinisë në sitemin ligjor dhe dirkiminim kundër grave në sferat private të jetës.

3. Duke pranuar se disa forma të diskriminimit racor kanë ndikim unik dhe konkret te gratë, Komisioni me punën e vet do të përpiqet që ti marr parasysh edhe faktorët e gjinisë të cilat mund të jenë të ndërlidhura me diskriminimin racor. Komisioni beson se një rritje e diskriminimit racor në bazë të gjinisë nuk mund të vazhdohej më tutje, nëse Shtetet anëtare së bashku me Komisionin zhvillojnë një qëndrim të vazhdueshëm dhe sistematik për mbikqyrjen e diskriminimit racor kundër grave, poashtu edhe pengesat dhe vështirësitë me të cilat ballfaqëhen grate.

4. Sipas kësaj, gjatë shqyrtimit të formave të diskriminimit racor Komisioni do të përpiqet edhe më tepër për integrimin e perspektivave të gjinisë, ti inkorporoj analizat e gjinive dhe ta inkurajoj përfshirjes e gjuhës së grave në metodat e mbledhjeve punuese, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e raporteve të dorëzuara nga Shtetet Anëtare, kokludimet, mekanizmat për paralajmërim të hershëm dhe ecuritë për veprim urgjent dhe rekomandimet e përgjithshme.

5. Si pjesë e metodologjisë për marrjen parasysh të dimensioneve të diskriminimit racor të gjinisë, Komisioni në metodat e veta të mbledhjeve do ti kqç edhe analizat e marrëdhënieve midis diskriminimit racor dhe ate të gjinisë, veçanarisht duke i shqyrtuar:

- a) format dhe manifestimin e diskriminimit racor;
- b) rrethanat ku paraqitet diskriminimi racor;
- c) pasojat e diskriminimit racor; dhe

d) dhe mundësitë për qasje te mekanizmat për dëmshpërblime dhe ankesa për diskriminim racor.

6. Duke vërejtur se raportet e dorëzuara nga Shtetet Anëtare shpesh nuk përmbajnë informata konkrete ose të mjaftueshme për implementimin e Konventës për sa u përket grave, nga Shtetet Anëtare kërkohet që ti përshkruajnë, sa më mire që munden edhe në pikpamjen kualitative dhe sasiore, faktorët që ndikojnë dhe vështirësitë e përjetuara që tu sigurojnë grave të drejta të barabarta siç është paraparë në Konventën. Të dhënat të cilat janë të ndara në kategori sipas races ose përkatësisë etnike do tu mundësojnë Shteteve Anëtare dhe Komisionit që ti identifikojnë, krahasojnë dhe të marrin hapa që ti dëmshpërblejnë format e diskriminimit racor kundër grave të cilat përndryshe do të ngelnin të pavërejtura dhe paadresuara.

Rekomandimi i Përgjithshëm XXVI lidhur me Nenin 6 të Konventës (sesioni 56, 2000)

1. Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor beson se shkalla se deri ku aktet e diskriminimit racor dhe fyerjet racore e dëmtojnë botëkuptimin e pales për reputacionin e tij/saj shpesh nënvlerësohet.

2. Komisioni i njohton Shtetet Anëtare se, sipas tij, e drejta që të kërkosh dëmshpërblim të drejtë dhe të duhur për çfarëdo dëmi të pësuar si pasojë e diskriminimit të tillë, e cila gjë është e paraparë në nenin 6 të Konventës, nuk arrihet vetëm me ndëshkimin e kriminalit për diskriminim; Njëkohësisht gjyqet dhe organet tjera kompetente duhet që të japin kompenzim për dëmin e pësuar nga viktima, qoftë materiale apo morale.

Rekomandimi i Përgjithshëm XXVII lidhur me Diskriminimin kundër Romëve (sesioni 57, 2000)

Duke i pasur parasysh dokumentet që Shtetet Anëtare i dorëzojnë te Konventa Ndërkombëtare mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, raportet e tyre periodike sipas nenit 9 të Konventës, si edhe Konkludimet e miratuara nga Komisioni lidhur me shqyrtimin e raporteve periodike të Shteteve anëtare;

Pas organizimit të një debate tematike mbi çështjen e diskriminimit kundër Romëve dhe pas pranimit të kontributeve të anëtarëve të Komisionit, si edhe kontributet nga ekspertët e organeve të KB-ve dhe traktateve tjera dhe prej organizatave rajonale,

Poashtu pas pranimit të kontributeve të organizatave joqeveritare të interesuara edhe gjatë mbledhjeve joformale gojarisht me ta edhe nëpërmjet informatave në formë të shkruar,

Duke i marrë parasysh klauzulat e Konventës,

Rekomandon që Shtetet Anëtare të Konventës, duke i pasur parasysh situatat e tyre konkrete, ti miratojnë për

të mirën e anëtarëve të komuniteteve të Romëve, midis tjerash, të gjithë ose një pjesë të masave që vijojnë.

1. Masa të natyrës së përgjithshme

1. Ta rishqyrtojnë dhe miratojnë ose ndryshojnë legjislacionin e tyre, siç duhet, me qëllim të zhdukjes së të gjitha formave të diskriminimit racor kundër Romëve sikurse për të gjithë personat ose grupet tjera që të jenë në përputhje me Konventën.

2. Të miratojnë dhe zbatojnë programe dhe strategji dhe të shprehin vullnet politik të vendosur dhe udhëheqje morale me qëllim të përmirësimit të gjendjes së Romëve dhe ti mbrojnë që të mos diskriminohen nga organet Shtetërore si edhe ti mbrojnë kundër nga ndonjë person ose organizatë.

3. Ti respektojnë dëshirat e Romëve deri aty ku duhet dhe grupin cilit dëshirojnë ti takojnë.

4. Të sigurojnë që legjislacioni lidhur me nënshtetësinë dhe marrjen e nënshtetësisë nuk i diskriminon anëtarët e komuniteteve të Romëve.

5. Ti marrin të gjitha masat e nevojshme që të evitojnë çfarëdo forme të diskriminimit kundër emigrantëve ose azilkërkuesëve me përkatësi Rome.

6. Në të gjitha programet e tyre dhe projektet e planifikuara dhe ato të implementura ta marrin parasysh gjendjen e grave Rome, të cilat shpesh janë viktima të diskriminimit të dyfishtë.

7. Të marrin masa të duhura që anëtarëve të komuniteteve të Romëve t'ju sigurojnë dëmshpërblime efikase dhe të sigurojnë që drejtësia tërësisht dhe në kohë kryhet në raste kur ka të bëjë me shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre fundamentale.

8. Të zhvillojnë dhe nxisin modalitete të duhura për komunikim dhe dialog midis komuniteteve të Romëve dhe pushtetit qendror dhe lokal.

9. Të përpiqen që ti përmirësojnë marrëdhëniet midis komuniteteve të Romëve dhe të tjerëve me anë të nxitjes së dialogut të sinqertë, këshillimeve ose mjeteve të tjera të duhura, në veçanti në nivelet lokale me qëllim të promovimit të tolerimit dhe tejkallimit të paragjykimeve dhe stereotipeve negative të dy pale, që të përpiqen për adaptimin e tyre në vend dhe të evitohet diskriminimi, si edhe të sigurojnë se të gjithë personat tërësisht i kënaqin të drejtat dhe liritë e tyre.

10. Ti pranojnë gabimet e bëra gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër komuniteteve të Romëve duke i deportuar ose zhdukur dhe të shqyrtojnë mënyra për ti kompenzuar.

11. Ti marrin masat e nevojshme së bashku me shoqërinë qytetare dhe të fillojnë me projekte që ta zhvillojnë

kulturën politike dhe ta arsimojnë tërë popullsinë për mosdiskriminimin, ti respektojnë te tjerët dhe në veçanti të kenë durim për Romët.

2. Masat për mbrojtje nga dhuna racore

12. Të sigurojnë mbrojtje për sigurinë dhe integritetin e Romëve pa asnjë diskriminim duke miratuar masa për parandalimin e veprave me qëllime diskriminuese kundër tyre; të sigurojnë veprim të shpejtë nga policia, nga prokuroria dhe sistemi gjyqësor për hetimin dhe ndëshkimin e veprave të tilla; dhe të sigurojnë që kryesit e atyre veprave të të mos ngelin të pandëshkuar.

13. Të marrin masa që ta parandalojnë përdorimin e fuqisë joligjore nga policia, në veçanti gjatë arrestimit ose mbajtjes në arrest.

14. Të nxisin që të mirëmbahet komunikimi midis policies dhe komuniteteve dhe organizatave të Romëve me qëllim të parandalimit të konflikteve në bazë të paragjytimeve racore dhe të luftojnë kundër veprave me motiv racor kundër anëtarëve të këtyre komuniteteve, si edhe kundër personave tjerë.

15. Ta inkurajojnë punësimin e Romëve në polici dhe në agjensionet tjera policore.

16. Të promovojnë zhvillim në rajonet pas mbarimit të konflikteve nga Shtetet Anëtare dhe nga Shtetet ose organet tjera përgjegjëse me qëllim të parandalimit të dhunës dhe shpërnguljes së komuniteteve të Romëve.

3. Masat në sferën e arsimit

17. Ta përkrahin përfshirjen e të gjithë fëmijëve me përkatësi Rome në sistemin shkollor dhe ta zvoglojnë numrin e atyre që nuk pranohen nëpër shkolla, në veçanti vajzat Rome dhe për këtë qëllim në mënyrë aktive të bashkëpunojnë me prindërit e Romëve, shoqatat dhe bashkësitë.

18. Sa më shumë që munden ta parandalojnë dhe ecitojnë ndarjen e studentëve Rom, duke e mbajtur të hapur mundësinë për shkollim dygjuhësor ose në gjuhën e nënës; për këtë qëllim, të përpiqen që ta zmadhojnë cilësinë e arsimit nëpër shkolla dhe nivelin e arritjes së nxënësve që u takojnë pakicave nëpër shkolla, të punësojnë nëpër shkolla anëtarë të komuniteteve të Romëve dhe ta avancojnë arsimimin ndërkulturor.

19. Të miratojnë masa për të mirën e fëmijëve Rom në fushën e arsimit në bashkëpunim me prindërit e tyre.

20. Me vendosshmëri të veprojnë kundër ndonjë diskriminimi ose maltretim racor të studentëve Rom.

21. Ti marrin masat e nevojshme që të sigurojnë një proces të arsimit themelor për nxënësit Rom, ato që udhëtojnë, duke i pranuar përkohësisht nëpër shkolla

lokale, duke mbajtur mësim në vendet e tyre ku janë vendosur përkohësisht ose duke përdorur teknologji të reja për mësim nga distanca.

22. Të sigurojnë se programet, projektet dhe fushatat e tyre në fushën e arsimit i marrin parasysh grupet e marginalizuara të grave dhe vajzave Rome.

23. Të marrin masa urgjente dhe të qëndrueshme për aftësimin e mësimitdhënësve, edukatorëve dhe asistentëve që gjenden në mesin e studentëve Rom.

24. Të veprojnë për përmirësimin e dialogut dhe komunikimit ndërmjet kuadrit mësimitdhënës dhe fëmijëve Rom, komuniteteve Rome dhe prindërve duke përdorur më shpesh asistent të zgjedhur nga mesi i Romëve.

25. Të sigurojnë skema dhe forma adekuate për arsimim për anëtarët e komuniteteve të Romëve që janë mbi moshën shkolllore që ta avancojnë diturinë e tyre.

26. Të përfshijnë në librat e mësimit, në të gjithë nivelet e dhura, kapituj për historinë dhe kulturën e Romëve dhe ta inkurajojnë ose përkrahin botimin dhe shpërndarjen e librave dhe materialeve tjera botuese, si edhe emitimin e programeve të televizionit dhe radios për historinë dhe kulturën e tyre, duke i përfshirë edhe gjuhët që ata i flasin.

4. Masa për përmirësimin e kushteve të jetesës

27. Të miratojnë ose ta bëjnë legjisllacionin që të jetë më efikas për ndalimin e diskriminimit gjatë punësimit dhe të gjitha praktikat diskriminuese në tregun e fuqisë punëtore që ndikon te anëtarët e komuniteteve të Romëve dhe ti mbroj atë nga ato praktika.

28. Të ndërmarrin masa të veçanta që ta avancojnë punësimin e Romëve në institucionet publike dhe administrate, si edhe në firmat private.

29. Të miratojnë dhe jetësojnë, kur të munden, në nivelin qendror ose lokal, masa të veçanta në favor të Romëve në punësimin publik si psh, kontrata publike dhe aktivitetet tjera që ndërmiren ose financohen nga qeveria ose ti aftësojnë Romët për shkathtësi dhe profesione të ndryshme.

30. Të zhvillojnë dhe implementojnë politika dhe projekte që synojnë ta evitojnë segregacionin e Romëve në fushën e banimit; ti kyçin komunitetet e Romëve dhe shoqatat si partner së bashku me personat tjerë në ndërtimin banesor, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen.

31. Fuqimisht të veprojnë kundër ndonjë praktike diskriminuese që ka ndikim te Romët, kryesisht nga pushteti lokal ose pronarët privat në lidhje me marrjen e shtëpive banuese dhe qasje në ndërtimin e banesave; fuqimisht të veprojnë kundër masave lokale që u

mohojnë banim Romëve ose i përzejnë dhe të mos i vendosin Romët në kampe jashta vendeve të banuara të cilat janë të izoluara dhe nuk kanë qasje te spitali ose objektet tjera.

32. Ti marrin masat e nevojshme që Romëve nomad ose Udhëtues tu ofrojnë vende për kampim për karavanet e tyre me të gjitha objektet e nevojshme.

33. Tu sigurojnë Romëve qasje të barabartë te institucionet shëndetësore dhe shërbimet për sigurim social dhe ti zhdukin praktikat diskriminuese që ushtrohen kundër tyre në kët fushë.

34. Të nisin dhe implementojnë programe dhe projekte për Romët, në fushën e shëndetësisë, kryesisht për gratë dhe fëmijët, duke e pasur parasysh gjendjen e tyre të pavolitshme për shkak të varfërisë së madhe dhe nivelit të ulët arsimor, si edhe dallimet në kulturë; ti kyçin shoqatat dhe komunitetet e Romëve dhe përfaqësuesit e tyre, kryesisht gratë, në dizajnimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve shëndetësore për Romët.

35. Ti parandalojnë, eliminojnë dhe në mënyrë të duhur ti ndëshkojnë praktikat diskriminuese lidhur me qasjen e anëtarëve të komuniteteve të Romëve te të gjithë vendet dhe shërbimet që janë të destinuara për shfrytëzim nga opinioni i përgjithshëm, duke i përfshirë restaurantet, hotelet, teatret dhe sallat muzikore, diskotekat dhe të tjera.

5. Masat në fushën e medimeve

36. Të veprojnë siç kërkon nevoja për eliminimin e ideve të dominimit racor ose etnik, të urrejtjes racore dhe nxitje për diskriminim dhe dhunë kundër Romëve në medime, në përputhje me klauzurat e Konventës.

37. Të inkurajojnë rritjen e vetëdijes në mesin e profesionistëve të të gjithë medimeve që janë të një përgjegjësie të veçantë që të mos përhapin paragjykime dhe tu shmangen emitimeve të incidenteve që i përfshinë vetëm anëtarët individual të Romëve në mënyrë që i fajëson komunitetet e tilla si të tëra.

38. Të zhvillojnë fushata arsimore dhe të medimeve që ta arsimojnë popullin për jetën, shoqërinë dhe kulturën e Romëve dhe rëndësinë e ndërtimit të një shoqërie në të cilën të gjithë marrin pjesë duke i respektuar të drejtat dhe identitetin e Romëve.

39. Të inkurajojnë dhe lehtësojnë qasjen e Romëve në medime, duke i përfshirë edhe gazetat dhe programet televizive dhe radiot, themelimin e medimeve të tyre, si edhe trajnimin e gazetarëve Rom.

40. Të inkurajojnë metoda për vetmbikqyrjen nga mediumet, nëpërmjet një kodi për sjellje për organizatat e medimeve që ti shmangen gjuhës së njëanshme, racore ose diskriminuese.

6. Masat në lidhje me pjesëmarrjen në jetën publike

41. Të marrin hapa të nevojshëm, duke përfshirë edhe masa të veçanta, që të sigurojnë të drejta të barabarta për pjesëmarrjen e grupeve ose komuniteteve të Romëve në të gjitha organet qendrore dhe të qeverisjes lokale.

42. Të zhvillojnë modalitete dhe struktura për këshillim me partite politike, shoqatat dhe përfaqësuesit e Romëve, edhe në nivelin lokal edhe në atë qendror gjatë shqyrtimi të çështjeve dhe miratimin e vendimeve që kanë rëndësi për komunitetet e Romëve.

43. Ti kyçin komunitetet, shoqatat dhe përfaqësuesit e Romëve, në fazat e hershme, në zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe programeve që ka të bëjë e ta dhe të sigurojnë transparencë të mjaftueshme për ato politika dhe programe.

44. Të promovojnë më shumë vetëdijësim për anëtarët e Romëve për nevojën e pjesëmarrjes së tyre më aktive në jetën publike dhe shoqërore dhe për promovimin e intereseve të tyre, për shembull, arsimimin e fëmijëve të tyre dhe pjesëmarrja e tyre në trajnime profesionale.

45. Të organizojnë programe trajnuese për zyrtarët dhe përfaqësuesit publik të Romëve, si edhe për kandidatët me perspektive trajnim më profesional në lidhje me përgjegjësitë, që do të ketë për qëllim përmirësimin e aftësive të tyre politike, marrjen e vendimeve dhe aftësi për administratën publike.

Komisioni *poashtu rekomandon* që:

46. Shtetet Anëtare në raportin e tyre periodik të kyçin, në një formular të duhur, të dhëna për komunitetet e Romëve brenda juridiksionit të tyre, duke përfshirë edhe të dhëna statistikore për pjesëmarrjen e Romëve në jetën politike dhe për gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë edhe nga pikpamja e gjinisë informata për implementimin e këtij rekomandimi të përgjithshëm.

47. Organizatat ndërqeveritare, në projektet e tyre për bashkëpunim dhe asistencë për Shtetet Anëtare, siç paraqitet nevoja, merren me situatën e komuniteteve të Romëve dhe e favorizojnë avancimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor.

48. Komesarijati i Lartë për të Drejtat e Njeriut e shqyrton mundësinë e formimit të një pike kryesore për çështjet e Romëve brenda Zyrës së Komesarijatisë të Lartë.

Komisioni *më tutje rekomandon* se:

49. Konferenca Botërore kundër Racizmit, Diskriminimit Racor, Ksenofobisë dhe Mosdurimit u dha një shqyrtim të duhur rekomandimeve të lartëpërmendura duke e marrë parasysh vendin e

komuniteteve të Romave, të cilët gjenden në një pozitë të disfavorshme dhe shumica e tyre u nënshtrohen diskriminimeve në këtë botë bashkohore.

SHTOJCA IV: Tekstet e plota të deklaratave të miratuara nga CERD-i

Deklarata për të drejtat e njeriut të Kurdëve (sesioni 54, 1999)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor është shumë i shqetësuar për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut që u shkaktohen njerëzve për shkak të prejardhjes së tyre etnike ose kombëtare. Antagonizmat etnike, veçanarisht kur përzihen me kundërshtime politike, mund të shkaktojnë shumë forma të konflikteve të dhunshme, duke përfshirë edhe vepra teroriste dhe operacione ushtarake.

Në shumë vende të botës, ato shkaktojnë vuajtje jashtë mase, me humbjen e shumë jetërave, shkatërimin e trashëgimisë kulturore dhe shpërngulje masive të popullsisë. Në këtë kontekst, Komisioni e shpreh shqetësimin e vet për veprat dhe politikat e shtypjes së të drejtave fundamentale dhe identitetit të Kurdëve si një popull që dallohet. Komisioni thekson se Kurdët, kodo që jetojnë, duhet të jenë në gjendje që të jtojnë një jetë dinjitoze, ta ruajnë kulturën e tyre dhe të kenë një shkallë të lartë të autonomisë. Komisioni u bën apel organeve kompetente të KB-ve dhe të gjithë organeve dhe organizatave që punojnë për paqe drejtësi dhe për të drejtat e njeriut ti vënë në përdorim të gjithë përpjekjet e nevojshme që të arrihet marrëveshje paqësore e cila do të jetë e drejtë për të drejtat fundamentale dhe liritë e njeriut të popullit Kurd.

Deklarata për Afrikën (sesioni 55, 1999)

Komisioni mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor,

I shqetësuar shumë për konfliktet etnike që sa e më shumë rriten dhe mungesa e përpjekjeve për parandalimin dhe zbutjen e tyre në rajonin Great Lakes dhe disa pjesë tjera të Afrikës,

Duke i përsëritur vendimet, delaratat dhe konkludimet e tija të paradokohshme, si psh, vendimi 3 (49) të 22 gushtit 1996 për Liberinë, rezolluta 1 (49) e 7 gushtit 1996 për Burundin, vendimet 3 (51) të 20 gushtit 1997, 1 (52) të 19 marsit 1998, dhe 4 (53) të 18 gushtit 1998 për Republikën Demokratike të Kongos, deklarata e 13 marsit 1996 për Ruandën, konkludimet për Ruandën më 20 mars 1997, konkludimet për Burundin më 21 gusht 1997, vendimet 4 (52) të 20 marsit 1998, 5 (53) të 19 gushtit 1998 dhe 3 (54) e 19 marsit 1999 për Ruandën, vendimi 5 (54) më 19 March 1999 për Sudanin, të cilat ishin si rrjedhojë e shqyrtimeve të Komisionit lidhur me konfliktet etnike në këta Shtete Anëtare sipas paralajmërimit të hershëm të tij dhe ecuritë për veprim të shpejtë brenda kontekstit të Konventës,

I vetëdijshëm për iniciativat e rëndësishme të ndërmarra rishtazi nga Organizata e Unitetit Afrikan, e cila poashtu kishte propozuar që të merren ecuri urgjente që ta

përballojnë situatën tragjike në Afrikën Qendrore dhe e shprehte faleminderimin e tij për përpjekjet e jashtëzakonshme për ndërmjetësim nga Shefat e katër shteteve të Afrikës në mbledhjen e tyre në Afrikën Jugore më 8 gusht 1999, që u reflektua në një delaratë solemne me qëllim të tejkalimit të krizës momentale dhe konflikteve etnike,

Duke iu falemnderuar Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve për raportin etij për shkaqet e konfliktit dhe për promovimin e një paqe të qëndrueshme dhe një zhvillimi në Afrikë (A/52/871-S/1998/318, data 13 prill 1998), që iu prezantua Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit të Sigurimit, në të cilin Ai theksonte se palët luftuese dhe grupet nuk kanë për qëllim vetëm ti shkatërrojnë vetëm ushtritë por edhe civilët dhe grupe të tëra etnike, dhe sugjeroi masa konkrete, midis tjerash, promovimin e paqes, hormonizimin e politikave dhe akcioneve të faktorëve të jashtëm, mobilizimin e përkrahjes ndërkombëtare për paqe, përpirësimin e efikasitetit të sanksioneve dhe zmadhimin e rolit të KB-ve për paqeruajtje në Afrikë,

Duke iu falemnderuar Komisarijatit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të KB-ve për iniciativat e saja më të reja dhe të rëndësishme që drejtëpërsëdrejti ndërliiden me konfliktet në Afrikë, lartë të përmendura, dhe përkrahjen e plotë të tij për veprat e Komisarijatit,

1. E shpreh shqetësimin e vet për shkeljet flagrante të të drejtave të njeriut të popujve dhe komuniteteve etnike në Afrikën Qendrore, në veçanti, masakret dhe gjenocidet e kryera kundër komuniteteve etnike dhe si rrjedhojë u shkaktova shpërngulje masive të njerëzve, me milione refugjatë dhe konfliktet etnike edhe më tej u thelluan.

2. U apelon KB-ve që të ndërmarrin akcione urgjente dhe masa efikase sipas Kartës së KB-ve që t'u jap fund këtyre konflikteve në Afrikën Qendrore, ti ndërpres masakret dhe gjenocidet dhe të ndihmoj në kthimin e sigurt të refugjatëve dhe personave të shpërngulur në shtëpitë e tyre.

3. U apelon të gjithë Shteteve dhe organeve të KB-ve që ti mbështesin iniciativat dhe apelet e Organizatës për Unitet të Afrikës dhe poashtu u apelon kryetarëve të katër Shteteve Afrikane që të kërkojnë një zgjidhje për krizën momentale dhe konfliktet etnike në Afrikën Qendrore.

SHTOJCA V: Teksti i ICERD-it

“ E miratuar dhe e hapur për firmosje dhe ratifikim nga rezolluta e Asamblesë së Përgjithshme 2106 (XX) më 21 dhjetor 1965

hyn në fuqi më 4 janar 1969, në pajtim me Nenin 19

Shtetet Anëtare të kësaj Konvente,

Duke pasur parasysh se Karta e Kombeve të Bashkuara bazohet në parimet e dinjitetit dhe barazisë që është në natyrën e brendshme të të gjithë qenieve njerëzore dhe se të gjithë Shtetet Anëtare janë zotuar se do të ndër marrin veprime të ërbashkëta dhe individuale, në bashkëpunim me Organizatën, për arritjen e njëres prej qëllimeve të Kombeve të Bashkuara e cila është që të promovoj dhe inkurajoj respect të përgjithshëm dhe mbikqyrje të të drejtave të njeriut dhe liritë fundamentale për të gjithë, pa dallim race, gjinie, gjuhe ose religjioni,

Duke pasur parasysh se Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut deklaron se të gjithë qeniet njerëzore kanë lindur të lire dhe të drejta të barabarta dhe se secilit i takojnë të gjithë të drejtat dhe liritë të paraqitura në këtë deklaratë, pa asnjë dallim, veçanarisht pa dallim të races, ngjyrës ose prejardhjes kombëtare,

Duke pasur parasysh se të gjithë qeniet njerëzore janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë para ligjit kundër ndonjë diskriminimi ose ndonjë nxitje për diskriminim,

Duke pasur parasysh se Kombet e Bashkuara e kanë dënuar kolonializmin dhe të gjitha praktikat e segregacionit dhe diskriminimit në çfarëdo qoftë formë dhe se Deklarata për Dhënien e Pavarësisë Shteteve dhe Popujve më 14 dhjetor 1960 (rezolluta e Asamblesë së Përgjithshme 1514 (XV)) ka vërtetuar dhe në mënyrë solemne e ka shpallur domosdoshmërinë për dhënien fund kolonializmit,

Duke pasur parasysh se Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të 20 nëntorit 1963 (rezolluta e Asamblesë së Përgjithshme 1904 (XVIII)) në mënyrë solemne e vërteton domosdoshmërinë për një eliminim të shpejtë të diskriminimit racor anekënd botës në të gjitha format dhe manifestimet që ekziston dhe për sigurimin e mirëkuptimit dhe respektit për njerëzit,

I bindur se çdo doktrine për dominim e bazuar në dallimet racore shkencëtarisht është e remmë, moralisht e dënueshme, e padrejtë dhe e rrezikshme në mënyrë shoqërore dhe se nuk ka justifikim për diskriminimin racor, në teori ose praktikë, kudoqoftë,

Duke rivërtetuar se diskriminimi ndërmjet qenieve njerëzore në bazë të races, ngjyrës ose prejardhjes etnike është një pengesë për zhvillimin e marrëdhënive miqësore dhe paqësore midis popujve dhe është në gjendje që ta prish paqen dhe sigurinë midis popujve dhe harmoninë e njerëzve që jetojnë afër njëri tjetrit bile edhe atyre që jetojnë në një shtet,

I bindur se ekzistimi i pengesave racore urrehet nga idealet e çdo shoqërie njerëzore,

I shqetësuar nga manifestimet e diskriminimit racor që ende ekziston në disa rajone të botës dhe nga politikat e

qeverive që bazohen në dominimin ose urrejtjen e tjetrit, si që është politika e aptheadit, segregacionit ose ndarjes,

I vendosur që ti miratoj të gjitha masat e nevojshme për eliminim të shpejtë të diskriminimit racor në të gjitha format dhe manifestimet që ekziston dhe ti parandaloj dhe luftoj doktrinën dhe praktikën raciste me qëllim të promovimit të mirëkuptimit ndërmjet racave dhe të ndërtoj një bashkësi ndërkombëtare pa asnjë formë të diskriminimit racor ose segregacionit racor,

Duke e mbajtur ndër mend Konventën lidhur me diskriminimin në raport me Punësimin dhe Profesionin e miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës më 1958 dhe Konventën kundër Diskriminimit në Arsim e miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë më 1960,

Duke pasur dëshirë që ti implementoj parimet e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe për të siguruar një miratim sa më të hershëm të masave praktike për ate qëllim,

Janë marrur vesh si vijon:

PJESA I

Neni 1

1. Në këtë Konventë, termi diskriminim racor do të nënkuptoj çdo dallim, përjashtim, kufizim ose anësi në bazë të races, ngjyrës, prejardhjes ose përkatësisë kombëtare ose etnike të cilat kanë për qëllim shfuqizimin ose dëmtimin e njohjes, kënaqjes ose ushtrimit të të drejtave njerëzore dhe lirive fundamentale në sferën politike, ekonomike, sociale, kulturore ose në ndonjë sferë tjetër të jetës publike.

2. Kjo Konventë nuk do të vlejë për dallimet, përjashtimet, restriksionet ose anësitë që bëhen nga ndonjë Shtet Anëtarë në këtë Konventë midis qytetarëve dhe të huajve.

3. Asgjë në këtë Konventë nuk mund të interpretohet se ka ndikim në ndonjë mënyrë në klauzulat e Shteteve Anëtare për sa i përket kombësisë, nënshtrësisë ose marrjen e nënshtrësisë, me kusht që klauzulat e tilla të mos bëjnë diskriminim e ndonjë kombësie të caktuar.

4. Masat e veçanta të ndërmarra për qëllimin e vetëm për sigurimin e avancimit të duhur të disa individeve ose grupeve racore ose etnike që kërkojnë mbrojtje të tillë siç kërkon nevoja me qëllim të sigurimit të të drejtave të barabarta dhe lirive fundamentale nuk do të quhet diskriminim racor, mirëpo me kusht që ato masa të mos çojnë kah mbajtja e të drejtave të veçanta për grupe të ndryshme racore dhe se masat e tilla nuk do të vazhdojnë më tej pas arritjes së qëllimeve për të cilat edhe janë ndërmarrë ato masa.

Neni 2

1. Shtetet Anëtare e dënojnë diskriminimin racor dhe angazhohen që të ndjekin me të gjitha mjetet e duhura dhe pa vonesë një politikë të zhdukjes së diskriminimit racor në të gjitha format që ekziston dhe të promovojnë një mirëkuptim ndërmjet të gjithë racave dhe për këtë qëllim:

- (a) Çdo Shtet Anëtarë angazhohet që të mos marrë pjesë ose ushtroj ndonjë diskriminim racor kundër personave, grupeve të personave ose institucioneve dhe të siguroj se të gjithë organet publike dhe institucionet në të gjitha nivelet do të veprojnë në përputhje me këtë obligim;
- (b) Çdo Shtet Anëtarë angazhohet që të mos sponsoroj, mbroj ose përkrah diskriminimin racor nga ndonjë person ose organizatë;
- (c) Çdo Shtet Anëtarë do të marr masat efikase për rishqyrtimin e politikës qeveritare, kombëtare dhe lokale dhe ti ndryshoj, anuloj ose shfuqizoj ato ligje dhe dispozita të kanë për qëllim krijimin ose përjetësimin e diskriminimit racor kudoqë ekziston;
- (d) Çdo Shtet Anëtarë do ta ndaloj dhe jap fund- me të gjitha mjetet e duhur, duke përfshirë edhe legjislativonin siç e kërkojnë rrethanat- diskriminimit racor nga personat, grupet ose organizatat;
- (e) Çdo Shtet Anëtarë angazhohet për inkurajimin organizatave për përfshirjen shumëracore në ta dhe mjete tjera për eliminimin e pengesave ndërmjet racave dhe të ti kundërshtoj ato që kanë tendencë që ta përforcojnë ndarjen racore.

2. Shtetet Anëtare do të marrin masa të veçanta dhe konkrete, në ato rrethana që paraqiten, në fushën sociale, ekonomike, kulturore dhe fusha tjera, me qëllim që të siguroj mbrojtjen dhe zhvillimin adekuat të disa grupeve racore ose individeve të u takojnë atyre që tu garantojnë të drejta të plota dhe liri fundamentale. Këta masa në ansjë rast nuk do të paraqesin si rrjedhojë që të ketë të drejta jo të barabarta ose të veçanta për grupe të ndryshme racore pasi që qëllimet për të cilat janë marrë ato masa janë arritur.

Neni 3

Shtetet Anëtare e denojnë në veçanti segragacionin dhe apartheidin racor dhe angazhohen për parandalimin, ndalimin dhe çrrënjësien e të gjitha praktikave të kësaj natyre në territoret që janë nën juridiksionin e tyre.

Neni 4

Shtetet Anëtare e dënojnë propagandën dhe të gjitha organizatat që janë bazuar në ide ose teori të dominimit të një race ose grupi të personave të një ngjyre ose përkatësisë etnike, ose ato të cilat mundohen ta justifikojnë ose promovojnë urrejtjen racore dhe diskriminim në çfarëdo formë dhe Shtetet angazhohet që të miratojnë masa të menjëhershme dhe pozitive me qëllim që ti çrrënjësin të gjitha veprat për nxitje të diskriminimit dhe prandaj duke i pasur parasysh parimet e parapara në Deklaratën Univerzale për të Drejtat e

Njeriut dhe të drejtat qartë të konstatuara në nenin 5 të kësaj Konvente, përveç tjerash:

(a) Do ta shpall të ndëshkueshme me ligj ndonjë shkelje ose të gjithë ata që përhapin ide në bazë të dominimit racor ose urrejtjes, ato që nxisin për diskriminim racor, si edhe veprat e dhunës ose nxitjes për vepra të tilla kundër racave ose grupeve të personave të ndonjë ngjyre ose përkatësie tjetër etnike dhe poashtu dhënien e ndihmës për ndonjë aktivitet racist duke e përfshirë edhe financimin e tillë;

(b) Do ti shpall të joligjshme dhe ndaloj organizatat ose aktivitetet e organizuara dhe të gjitha propagandat tjera që nxisin diskriminim racor dhe pjesëmarrjen në ato organizata ose aktivitetet do ta shpall si shkelje e ndëshkueshme me ligj;

(c) Nuk do tu lejoj organeve publike dhe institucioneve qofshin lokale apo kombëtare, që të promovojnë ose nxisin diskriminim racor.

Neni 5

Në përputhje me obligimet fundamentale të parapara në nenin 2 të kësaj Konvente, Shtetet Anëtare angazhohen për ndalimin dhe eliminimin e diskriminimit racor në të gjitha format që ekziston dhe të garantoj për të drejtat e çdonjerit, pa dallim race, ngjyre, përkatësi kombëtare ose etnike, të jenë të barabartë para ligjit, në veçanti ti gëzojnë të drejtat vijuese:

- (a) Të drejtën për trajtim të barabartë para tribunaleve dhe të gjitha organeve tjera gjyqësore;
- (b) Të drejtën për sigurinë personale dhe mbrojtjen nga Shteti nga dhuna ose lëndimi trupor, pa marrë parasysh se a është shkaktuar nga zyrtarët e qeverisë ose nga ndonjë grup ose institucion;
- (c) Të drejtat politike, në veçanti të drejtën për pjesëmarrje në zgjedhje — të votoj dhe kandidohet për votim — në bazë të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë, të marrin pjesë në qeveri, si edhe kryerjen e punëve publike në çdo nivel dhe të kenë qasje të barabartë te shërbimet publike;
- (d) Të drejta tjera qytetare, në veçanti:

- (i) Të drejtën për lëvizje të lire dhe banim brenda kufijve të shtetit;
- (ii) Të drejtën për ta lëshuar shtetin, duke përfshirë edhe shtetin e vet dhe të kthehet në shtetin e vet;
- (iii) Të drejtën e kombësisë;
- (iv) Të drejtën e martesës dhe të zgjedh bashkëshort/e;
- (v) Të drejtë që të ketë prone vetë dhe së bashku me të tjerë;
- (vi) Të drejtën e trashëgimit;
- (vii) Të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë;
- (viii) Të drejtën e lirisë së bindjes dhe shprehjes;
- (ix) Të drejtën për grumbullim paqësorë dhe shoqërim;

(e) Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, në veçanti:

- (i) Të drejtën për punë, zgjedhje të lire të punësimit, për kushte të drejta dhe të volitshme të punës, për mbrojtje kundër papunësisimit, për page të barabartë për punë të barabartë, për shpërblim të drejtë dhe të volitshëm;
- (ii) Të drejtën për formim dhe bashkangjitje te sindikatet;
- (iii) Të drejtën e banimit;
- (iv) Të drejtën për shëndetësinë publike, përkujdesjen shëndetësore, sigurimin social dhe shërbimet sociale;
- (v) Të drejtën për tu arsimuar dhe aftësuar;
- (vi) Të drejtën për pjesëmarrje të barabartë në aktivitete kulturore;
- (f) Të drejtën për të hyrë në çdo vend ose shërbim që është për përdorim të publikut të përgjithshëm, si psh transporti, hotelet, restaurantet, kafenetë, teatrot dhe parqet.

Neni 6

Shtetet Anëtare duhet të gjithëve tu sigurojnë mbrojtje dhe dëmshpërblime efikase, nëpërmjet tribunaleve kompetente shtetërore dhe institucioneve tjera shtetërore, kundër çdo vepre të diskriminimit racor të cilat i shkelin të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale sipas kësaj Konvente, si edhe të drejtën që prej tribunaleve të tilla të kërkoj dëmshpërblim të drejtë dhe të duhur për ndonjë dëmi të shkaktuar për shkak të diskriminimit të tillë.

Neni 7

Shtetet Anëtare angazhohen për miratimin e masave efikase dhe të menjëhershme, veçanarisht në fushën e mësimdhënies, arsimit, kulturës dhe informatikës, me qëllim të luftimit të paragjyqimeve që shkaktojnë diskriminim racor dhe të promovojnë mirëkuptim, tolerim dhe miqësi midis kombeve dhe grupeve racore ose etnike, si edhe për propagandimin e qëllimeve dhe parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Deklarata Univerzale për të Drejtat e Njeriut, Deklarate e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe këtë Konventë.

PJESA II

Neni 8

1. Do të formohet një Komision mbi Eliminimin e Diskriminimit Racor (në tekstin e mëposhtëm si Komision) që do të përbëhet prej 18 ekspertëve me një qëndrim të lartë morali dhe paanësi të njohur të cilët do të zgjedhen nga Shtetet Anëtare nga pjesëtarët e tyre, të cilët do të shërbejnë me kapacitetin e tyre personal, duke e marrë parasysh edhe hapësirën e barabartë gjeografike dhe përfaqësimin e formave të ndryshme të qytetërimit, si edhe sistemet kryesore ligjore.

2. Anëtarët e Komisionit do të zgjedhen me votim të fshehtë nga lista e personave të emëruar nga Shtetet

Anëtare. Çdo Shtet Anëtarë mund të emëroj një person nga Shteti i vet.

3. Zgjedhjet e para do të mbahen 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Së paku tre muaj para dates së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve do t'ju dërgoj një letër Shteteve Anëtare ku i thërret që ti dorëzojnë emërimet e tyre brenda dy muajve. Sekretari i Përgjithshëm do të përgatis një list të të gjithë personave të emëruar në rënditje alfabetike, duke i paraqitur Shtetet Anëtare që i kanë emëruar ato persona dhe do tua dorëzoj Shteteve Anëtare.

4. Zgjedhjet e anëtarëve të Komisionit do të mbahen në një mbledhje të Shteteve Anëtare të konvokuar Sekretari i Përgjithshëm në lokalet e KB-ve. Në mbledhjen, kuvorumi I të cilës duhet të jetë dy të tretat e Shteteve Anëtare, personat që do të zgjedhen për te Komisioni do të jenë ato që do të marrin numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të Shteteve Anëtare të pranishëm dhe në votim.

5. (a) Anëtarët e Komisionit do të zgjidhen për një mandat katër vjeçar. Mirëpo, mandati i 9 anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e para do të mbaroj në fund të dy viteve; menjëherë pas zgjedhjeve të para, emërat e këtyre nëntë anëtarëve do të zgjidhen me short nga Kryesuesi i Komisionit;

(b) Për plotësimin e vendeve të lira, Shteti Anëtarë, ekspertit të cilit i ka kaluar mandati si anëtarë i Komisionit do të caktoj një ekspert tjetër nga Shteti i vet i cili duhet të aprovohet nga Komisioni.

6. Shtetet Anëtare do të jenë përgjegjëse për shpenzimet e anëtarëve të Komisionit derisa i kryejnë detyrat e Komisionit.

Article 9

1. Shtetet Anëtare i dorëzojnë Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve një raport për masat legjislative, gjyqësore, administrative ose masa tjera që ato i kanë miratuar dhe me anë të së cilave hynë në fuqi klauzurat e kësaj Konvente, të cilin raport e shqyrton Komisioni:

(a) brenda një viti pas hyrjes në fuqi të Konventës për Shtetin përkatës; dhe

(b) pastaj çdo dy vite duhet ti dorëzohet Komisionit raport ose kur kërkon Komisioni. Komisioni mund të kërkoj informata plotësuese nga Shtetet Anëtare.

2. Komisioni do ti raportoj çdo vit Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, për aktivitetet e veta dhe mund të japë sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme duke u bazuar në shqyrtimin e raporteve dhe infomatave të pranuar nga Shtetet Anëtare. Sugjerimet dhe rekomandimet e tilla të përgjithshme do ti raportohen Asamblesë së Përgjithshme nga Shtetet Anëtare, së bashku me ndonjë koment nëse ekziston.

Neni 10

1. Komisioni vetë do të miratoj rregullat e ecures së vet.
2. Komisioni anëtarët e vet do të zgjedh për një mandat prej 2 viteve.
3. Sekretarijati i Komisionit do jipet nga Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve.
4. Mbledhjet e Komisionot zakonisht do të mbahen te Shtabi i KB-ve.

Neni 11

1. Nëse Shteti Anëtarë mendon se ndonjë Shtet tjetër Anëtar nuk i miraton klauzurat e Konventës, këtë gjë mund tia përcjell Komisionit. Komisioni pastaj do tia përcjell komunikatën Shtetit Anëtarë përkatës. Brenda tre muajsh, Shteti që e pranon komunikatën duhet ti dorëzoj Komisionit sqarime në formë të shkruar ose deklarata që e sqarojnë çështjen e lartpërmendur, nëse ekziston.
2. Nëse çështja nuk rregullohet në atë mënyrë që të dyja palët të jenë të kënaqura, qoftë me negociata dypalëshe ose me ndonjë ecure tjetër të hapur nga ta, brenda gjashtë muajsh pas pranimi të komunikatës nga Shteti që duhet ta pranoj, të dyja shtetet do të kenë të drejtë që ti drejtohen kësaj çështje para Komisionit por duke e njohtuar Komisionin dhe shtetet tjera.
3. Komisioni do të merret me ndonjë çështje që ngritet sipas paragrafit 2 të këtij neni, pasi që do të ketë konstatuar se të gjitha mjetet e shtetit janë shterur lidhur me çështjen në përputhje me parimet e pranuar në përgjithësi të ligjit ndërkombëtarë. Mirëpo nuk do të vlejë për ato vende në të cilat zbatimi i dëmshpërblimeve prolongohet pa arsytim.
4. Për çdo çështje Komisioni mund ti bëj thirrje Shtetit Anëtarë përkatës që të siguroj informata tjera relevante.
5. Kur ndonjë çështje që del nga ky nen shqyrtohet nga Komisioni, Shtetet Anëtare përkatëse do të kenë të drejtë të dërgojnë një përfaqësues që të marr pjesë në mbledhjen e Komisionit, pa të drejtë votimi, deri shqyrtohet çështja.

Neni 12

1. (a) Pasi që Komisioni i ka pranuar dhe mbledhur të gjitha informatat e nevojshme, Komisioni do të caktoj një Nënkomision për Pajtim (në tekstin e mëposhtëm si Nënkomision) që do të përbëhet prej pes personave të cilët mund të jenë ose mos jenë anëtarë të Komisionit. Anëtarët e Nënkomisionit do të caktohen me pëlqimin unani të palëve të kontestuara dhe zyrat e saja do të jenë në disponim të palëve përkatëse me qëllim të arritjes së zgjidhjes miqësore të çështjes duke e respektuar këtë Konventë;

(b) Nëse Shtetet Anëtare të kontestuara dështojnë në gjetjen e marrëveshjes brenda tre muajsh për të gjithë ose një pjesë të përbërjes së Nënkomisionit, anëtarët e Nënkomisionit do të zgjedhen me vota të fshehta nga dy të tretat e votave të Komisionit nga anëtarët evet.

2. Anëtarët e Nënkomisionit do të shërbejnë në kapacitetin e vet. Ata nuk do të jenë pjesëtarë të Shteteve Anëtare të kontestuara ose anëtarë të ndonjë Shteti që nuk është anëtarë i Konventës.
3. Nënkomisioni do ta caktoj kryesuesin e vet do ti miratoj rregullat e veta të ecures.
4. Mbledhjet e Nënkomisionit zakonisht do të mbahen në Zyrat e KB-ve ose në ndonjë vend tjetër që do ta cakton Nënkomisioni.
5. Sekretariati që do të sigurohet sipas neni 10, paragrafi 3 i kësaj Konvente poashtu do ti ofroj shërbime Nënkomisionit kurtdo që shfaqet ndonjë kontest midis Shteteve Anëtare.

6. Shtetet Anëtare të kontestuara do ti ndajnë shpenzimet e anëtarëve të Nënkomisionit në mënyrë të barabartë në përputhje me vlerësimet që do ti siguroj Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve.

7. Sekretari i Përgjithshëm do të autorizohet që ta bëj pagesën e shpenzimeve të anëtarëve të Nënkomisionit, nëse duhet, para se Shtetet e kontestuara ta bëjnë pagesën e tyre sipas paragrafit 6 të këtij neni.

8. Informatat e pranuar dhe grumbulluara nga Komisioni do të vihen në disponim të Nënkomisionit dhe Nënkomisioni mund ti ftoj Shtetet Anëtare të kontestuara që të japin informata tjera relevante.

Neni 13

1. Pasi që Nënkomisioni plotësisht e shyrton çështjen, do të përgatis dhe dorëzoj Kryesuesit të Komisionit një raport në të cilën do të përfshihen zbulimet e të gjitha pyetjeve dhe fakteve relevante ndërmjet palëve dhe do të përmbaj rekomandime të tilla që ofron zgjidhjen miqësore të kontestit.

2. Kryesuesi i Komisionit do t'ua dërgoj raportin e Nënkomisionit Shteteve Anëtare të kontestuara. Këta Shtete duhet që brenda tre muajsh ta informojnë Kryesuesin e Komisionit se a i pranojnë rekomandimet e përmbajtura në raportin e Nënkomisionit ose jo.

3. Pas periudhës së dhënë në paragrafin 2 të këtij neni, Kryesuesi i Komisionit do tua dërgoj raportin e Nënkomisionit dhe deklaratat e Shteteve Anëtare të kontestuara Shteteve Anëtare të Konventës.

Neni 14

1. Shteti Anëtarë në çdo kohë mund të deklaroj se e pranon kompetencën e Komisionit që të pranoj dhe

shqyrtoj komunikata nga individët ose grupeve të individeve brenda jurisdikcionit të vet të cilët pohojnë se kanë qenë viktimë, nga ndonjë Shtet Anëtarë, të ndonjë shkelje të të drejtave të paraqitura në këtë Konventë. Asnjë komunikatë e tillë nuk do të pranohet nga Komisioni nëse ka të bëjë me ndonjë Shtet Anëtarë që nuk ka bërë një deklaratë të tillë.

2. Çdo Shtet Anëtarë që e bën deklaratën e paraqitur në paragrafin 1 të këtij neni mund të formoj një organ në kuadër të rendit të vet ligjor i cili do të jetë kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e peticioneve nga individët ose grupeve të individeve brenda jurisdikcionit të vet, të cilët individë ose grupe pohojnë se kanë qenë viktimë të ndonjë shkelje të të drejtave të parapara në këtë Konventë dhe të cilët i kanë shterur të gjitha institucionet lokale të vendit.

3. Deklarata e bërë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni dhe emri i organit të formuar ose caktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni do të bëhet nga Shteti Anëtarë përkatës me Sekretarin e Përgjithshëm të KB-ve, i cili do tu dorëzoj kopje Shteteve tjera Anëtare. Deklarata mund të tërhiqet në çdo kohë duke e njohtuar Sekretarin e Përgjithshëm, për një tërheqje e tillë nuk do të ketë ndikim te komunikatat që janë në procedure para Komisionit.

4. Do të mbahet një regjistër për peticionet nga ana e organit të formuar ose caktuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe kopjet e verifikuara të regjistrit do të kategorizohen çdo vit nëpërmjet kanaleve të duhura me Sekretarin e Përgjithshëm lidhur me ate se përmbajtja e tyre nuk duhet të zbulohet publikisht.

5. Në rast se organi i formuar ose i caktuar dështon ta bëjë punën e vet sipas paragrafit 2 të këtij neni, ai që e bën peticionin do të ketë të drejtë që kët çështje t'ia dërgoj Komisionit brenda gjashtë muajsh.

6. (a) Komisioni në mënyrë sekrete do tua përcjell komunikatat Shteteve Anëtare përkatëse të cilat e bëjnë shkeljen e ndonjë klauzule të kësaj Konvente, por identiteti i individit ose grupit të individeve nuk do të zbulohet pa pëlqimin e tij/saj. Komisioni nuk do të pranoj komunikata anonime;

(b) Brenda tre muajsh, Shteti Anëtarë përkatës duhet që ti dorëzoj Komisionit sqarime të shkruara ose deklarata që e sqarojnë çështjen dhe institucionet, nëse ekzistojnë, që kanë qenë të involvuara për atë çështje.

7. (a) Komisioni do ti shqyrtoj komunikatat në bazë të të gjitha informatave që Shteti Anëtarë ia ka dorëzuar tij dhe nga ai që e ka shkruar peticionin. Komisioni nuk do ta shqyrtoj komunikatën nga asnjë peticionist nëse nuk ka konstatuar se peticionisti i ka shterur të gjitha institucionet e Shtetit përkatës që janë në disponim. Mirëpo, kjo nuk do të vlen në ato raste kur dëmshpërblimet prolongohen pa asnjë arsyetim;

(b) Komisioni do t'ia dërgoj sugjerimet dhe rekomandimet, nëse ka, Shtetit Anëtarë përkatës dhe peticionistit.

8. Komisioni në raportin e vet vjetor do të përfshijë një përmbledhje të sqarimeve dhe deklaratave të Shteteve Anëtare përkatëse dhe rekomandimet dhe sugjerimet e veta.

9. Komisioni do të jetë kompetent për kryerjen e funksioneve të veta sipas këtij neni, vetëm atëherë kur 10 Shtete Anëtare japin deklarata sipas paragrafit I të këtij neni.

Neni 15

1. Gjatë arritjes së piksynimeve të Deklaratës për Dhënie Pavarësi Shteteve dhe Popujve Kolonist, që përfshihet në rezollutën e Asamblesë së Përgjithshme 1514 (XV) të 14 dhjetorit 1960, klauzurat e kësaj Konvente në asnjë mënyrë nuk do ta kufizoj të drejtën për peticion që iu është dhënë këtyre popujve nga instrumentet tjera ndërkombëtare ose nga Kombet e Bashkuara dhe agjencionet speciale të saja.

2. (a) Komisioni i themeluar sipas nenit 8, paragrafit 1 të kësaj Konvente do të pranoj kopje të peticioneve dhe pas shqyrtimit do të japë rekomandime për ta para organeve të KB-ve të cilat drejtëpërsëdrejti merren me çështjet e parimeve dhe piksynimeve të kësaj Konvente, të cilat peticione i marrin nga Territorët që Nuk Qeverisen Vetë dhe nga të gjitha territoret për të cilat vlen rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 1514(XV), në lidhje me çështjet që kjo Konventë i mbulon;

(b) Komisioni do të pranoj nga organet kompetente të KB-ve kopje të raporteve lidhur me masat për legjislacionin, sistemin gjyqësor, administratën dhe masat tjera që kanë të bëjnë me parimet dhe piksynimet e kësaj Konvente dhe të cilat masa zbatohen nga Fuqitë qeverisëse në kuadër të Territoreve të përmendura në nënparagrafin (a) të këtij paragrafi, dhe do tu jap mendime dhe rekomandime këtyre organeve.

3. Në raportin e vet që Komisioni do t'ia dërgoj Asamblesë së Përgjithshme do të përfshijë një përmbledhje të peticioneve dhe raporteve që i ka pranuar nga organet e KB-ve dhe mendimet dhe rekomandimet e Komisionit lidhur me peticionet dhe raportet përkatëse.

4. Komisioni do të kërkoj prej Sekretarit të Përgjithshëm të gjitha informatat relevante për piksynimet e kësaj Konvente dhe të jenë në disponim për të lidhur me Territorët e përmendura në paragrafin 2 (a) të këtij neni.

Neni 16

Klauzurat e kësaj Konventë për sa u përket zgjidhjes së kontesteve ose ankesave do të zbatohen pa paragjykim ndaj procedurave tjera për zgjidhjen e kontesteve ose ankesave në fushën e diskriminimit të paraqitura në pjesët përbërëse të konventave të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe agjensioneve të tija të specializuara,

dhe nuk do ti parandaloj Shtetet Anëtare që të mos gjejnë rrugë tjetër për procedura tjera për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me marrëveshjet e përgjithshme ose të veçanta që janë në fuqi.

PJESA III

Neni 17

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për çdo Shtet Anëtar të KB-ve ose anëtarë të ndonjë agjencie të specializuar të KB-ve, për çdo Shtet Anëtar të Statutit të Gjyqit Ndërkombëtar dhe për çdo Shtet tjetër të cilin Asambleja e Përgjithshme e KB-ve e ka ftuar që të bëhet Anëtar në këtë Konventë.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e ratifikimit duhet ti lihen sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 18

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për çdo Shtet si që u përmend më lartë në nenin 17, paragrafi 1 i Konventës.
2. Hyrja do të bëhet me ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve.

Neni 19

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tredhjetë pas ditës së depozitimit të Sekretarit të Përgjithshëm i KB-ve instrumentin e 27 të ratifikimit ose instrumentin e hyrjes.

2. Për çdo shtet që e bën ratifikimin e kësaj Konvente ose hyn në të pas depozitimit të instrumentit të 27 të ratifikimit ose instrumentit të pranimit ose hyrjes, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e tredhjetë pas ditës së depozitimit të instrumenteve të veta për ratifikim ose instrumenteve të hyrjes ose pranimit.

Neni 20

1. Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve do të pranoj dhe do t'ua dërgoj të gjithë Shteteve të cilat janë ose mund të bëhen Anëtarë të kësaj Konvente vetëpërbajtjet e treguara nga Shtetet gjatë kohës së ratifikimit ose pranimit. Çdo Shtet që e kundërshton vetëpërbajtjen, Brenda një periudhe prej 90 ditëve nga data e komunikatës përkatëse, do ta njohtoj Sekretarin e Përgjithshëm se nuk e pranon atë.

2. Një vetëpërbajtje që nuk është në përputhje me qëllimin dhe piksynimin e kësaj Konvente nuk do të lejohet, as edhe vetëpërbajtja efekti I të cilit mund ta ndaloj punën e organeve të themeluara nga kjo Konventë nuk do të lejohet. Një vetëpërbajtje do quhet mospërfillëse ose ndaluese nëse së paku dy të tretat e Shteteve Anëtare të kësaj Konvente e kundërshtojnë atë.

3. Vetëpërbajtjet mund të tërhiqen në çdo kohë duke e njohtuar për këtë Sekretarin e Përgjithshëm. Njohtimet e tilla do të hynë në fuqi në datën kur pranohen.

Article 21

Ndonjë Shtet Anëtar mund ta denoncoj këtë Konventë duke i shkruar një njohtim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas pranimit të njohtimit nga sekretari i Përgjithshëm.

Article 22

Çfarëdo kontesti ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Anëtare në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, cili kontest nuk është zgjidhur sipas negociatave ose procedurave të kësaj Konvente, do ti përcillet Gjyqit Ndërkombëtarë për të marrë vendim, me kërkesë të cilësdo pale të kontestit, vetëm nëse palët e kontestuara nuk merren vesh për ndonjë mënyrë tjetër për rregullimin e kontestit.

Neni 23

1. Kërkesë për rishqyrtimin e kësaj Konvente mund të bëj çdo Shtet Anëtarë në çdo kohë duke e njohtuar në formë të shkruar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.
2. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara do të vendos për hapat, nëse ka, që duhet të merren lidhur me kërkesën e tillë.

Neni 24

Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve do ti njohtoj të gjithë Shtetet që u përmendën në nenin 17, paragrafi 1 i kësaj Konvente për të dhënat vijuese;

(a) Nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet sipas nenit 17 dhe 18;

(b) Datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente sipas nenit 19;

(c) Komunikatat dhe deklaratat e pranuar sipas nenit 14, 20 dhe 23;

(d) Denoncimet sipas nenit 21.

Neni 25

1. Kjo Konventë, për të cilën tekstet Kineze, Angleze, Franceze, Ruse dhe Spanjole janë njësoj autentike, do të ruhet në arkivin e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve do tu dërgoj kopje të vërtetuara të kësaj Konvente të gjitha Shteteve që u takojnë kategorive të përmendura në nenin 17, paragrafin 1 të Konventës.

SHĚNIME

1 See, for example, General Recommendation XXI on the right to self-determination, and General Recommendation

XXIII on the rights of indigenous peoples.

2 See also the *Manual on Human Rights Reporting*, Geneva, UN, 1997; and van Boven, T., The concept of discrimination in the International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, in W. K lin, (ed.), *Das Verbot ethnisch-kultureller Diskriminierung: Verfassungs-und menschenrechtliche Aspekte*, Basel, Geneva, Munich, Helbing und Lichtenhahn, 1999.

3 *CERD Annual Report*, 1996, UN doc. A/51/18, para. 352.

4 General Recommendation VIII (38).

5 CERD s General Guidelines Regarding the Form and Contents of Reports to be submitted by States Parties under Article 9, para. 1, of ICERD (CERD/C/70/Rev. 4).

6 *Ibid.*, see new para. 9 adopted by CERD at its 55th session in August 1999 (CERD/C/70/Rev.4).

7 General Recommendation XI (42).

8 Initial report of Switzerland to CERD (CERD/C/270/Add. 1), para. 56.

9 *CERD Annual Report*, UN doc. A/53/18, para. 57.

10 General Recommendation XIV (42).

11 General Recommendation XIII (42).

12 General Recommendation XIX (47).

13 *Ibid.*

14 General Recommendations VII (32) and XV (42).

15 Van Boven, *op. cit.*

16 At the relevant time Article 266 (b) provided: Any person who, publicly or with the intention of disseminating

it to a wide circle (videre kreds) of people, makes a statement, or other communication, threatening, insulting or degrading a group of persons on account of their race, colour, national or ethnic origin or belief shall be liable to a fine or to simple detention or to imprisonment for a term not exceeding two years.

17 Article 23, para. 1, reads: A provision establishing a criminal offence shall apply to any person who has assisted the commission of the offence by instigation, advice or action. The punishment may be reduced if the person in question only intended to give assistance of minor importance or to strengthen an intent already resolved or if the offence has not been completed or an intended assistance failed.

18 *CERD Annual Report*, UN doc. A/45/18, para. 56, quoted in van Boven, *op. cit.*

19 *Jersild v. Denmark*. The full text of the judgment of the European Court of Human Rights is available on: <http://www.dhcour.coe.fr/hudoc/ViewRoot.asp?Item=0&Action=Html&X=1017232056&Notice=0&Noticemode=&RelatedMode=0>.

20 See Human rights seminar condemns promotion of

racism on the internet, *UN Press Release HR/97/76*, 17 November 1997.

21 Recommendations adopted at the 6th meeting of the Persons Chairing the Human Rights Treaty Bodies, in September 1995, UN doc. A/50/505, para. 20.

22 The Committee on Economic, Social and Cultural Rights was established according to the ECOSOC resolution 1985/17, and not formally as a treaty body under the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights. The Covenant had envisaged ECOSOC to serve as a monitoring body.

23 The usual practice is for a session to last three weeks, but on a trial basis the Committee held four-week sessions in August 1999 and 2000.

24 Examples are missions to Croatia, Guatemala and Yugoslavia (Serbia and Montenegro).

25 At its 56th session held in March 2000, CERD decided

to discuss and adopt a uniform approach in dealing with states reports, which might alter some of the practices mentioned in this manual.

26 *CERD Annual Report*, UN doc. A/45/18, para. 29.

27 The manual can be ordered directly through UN Publications/

Bookshop (see Useful addresses at the back) or via the internet: <http://www.unhchr.ch/>

28 Article 9, para. 1 of ICERD reads: States Parties undertake to submit to the Secretary-General of the United Nations, for consideration by the Committee, a report on the legislative, judicial, administrative or other measures which they have adopted and which give effect to the provisions of this Convention [] .

29 CERD s General Guidelines Regarding the Form and Contents of Reports to be submitted by States Parties under Article 9, para. 1, of ICERD, *op.cit.*

30 UN doc. CERD/C/319/Add. 2, submitted by the State Party on 1 April 1997 and considered by CERD at its 52nd session in March 1998.

31 Van Boven, T., The petition system under the International

Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination; a sobering balance sheet ,

ICERD: A GUIDE FOR NON-GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS

United Nations Yearbook, vol. 4, 2000, pp. 271—87.

32 General Recommendation XXVII — See the annexes to this manual.

33 Article 71 of the Charter of the United Nations, and ECOSOC resolution 1996/31. If your NGO wishes to obtain consultative status, see the Useful addresses section at the back of this manual. Note, however, that NGOs have no official right to participate in the working processes of CERD, which is not an ECOSOC body.

34 The services ARIS offers to NGOs include: making official UN documents available to them; keeping them informed of CERD s schedule; assisting them in their lobbying efforts with governments; reporting on the outcome of the discussion of their governments

reports by supplying them with the country report that ARIS prepares after the session, and further, upon request, the official annual report of the Committee; encouraging human rights groups in the countries that have not accepted Article 14 of the Convention to exert pressure on their governments to do so; assisting human rights groups, where appropriate, in filing individual complaints; and, sending UN press releases, immediately after discussion by CERD, to the major news media in the countries concerned.

(From ARIS leaflet, Geneva, September 1999.)

35 Communication to IMADR from Mr Martin Scheinin.

36 Banton, M., Decision-taking in the Committee on the Elimination of Racial Discrimination, presented at a public lecture on 13 November 1997 convened by the International Law Association (British Branch) and the British Institute of International and Comparative Law.

37 Examples of reports which have been submitted by NGOs, or at least a list of such NGOs, might be consulted through the CERD Secretariat or ARIS. See Useful addresses at the back of this manual.

38 Forum Against Racism, *Racism in Switzerland: First NGO report of Switzerland to the UN*, February 1998.

39 As from 2001, some of the sessions may also be held at a Conference Room in the Palais Wilson which houses the Office of the High Commissioner for Human Rights. Should its request be granted by the General Assembly, CERD may also hold one of its two annual sessions at the UN headquarters in New York.

40 CERD/C/35/Rev.3, of 1 January 1989, in particular Rules 80 to 97.

41 See communication no. 6/1995 (Z.U.B.S. v. Australia), and communication no. 8/1996 (B.M.S. v. Australia).

42 Communication no. 8/1996 (B.M.S. v. Australia), paras 6.1 and 6.2.

43 *CERD Annual Report*, UN doc. A/54/18, Annexe III. A.

Bibliografija e Zgjedhur

Alfredsson, G. and Ferrer, E., *Minority Rights: A Guide to United Nations Procedures and Institutions*, Minority Rights Group and Raoul Wallenberg Institute of Human Rights and Humanitarian Law, 1998.

Basic Facts about the United Nations, New York, United Nations, 1995.

Banton, M., Decision-taking in the Committee on the Elimination of Racial Discrimination, presented at a public lecture on 13 November 1997 convened by the International Law Association (British Branch) and the British Institute of International and Comparative Law.

Banton, M., *International Action Against Racial Discrimination*,

Oxford, Clarendon Press, 1996.

Bidault, M., *Le Comité pour l'Élimination de la Discrimination*

Raciale; analyse d'une dynamique institutionnelle, Paris, Montchrestien, 1997.

Van Boven, T., United Nations strategies to combat racism and racial discrimination; a sobering but not hopeless balance-sheet, in F. van Hoof and J. Smith (eds), *The Role of the Nation-State in the 21st Century; Human Rights, International Organisations and Foreign Policy — Essays in Honour of Peter Baehr, Monique Casterman-Holleman*, The Hague, Kluwer, 1998.

Van Boven, T. The concept of discrimination in the International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, in W. Klein (ed.), *Das Verbot ethnisch-kultureller Diskriminierung: Verfassungs-*

—und menschenrechtliche Aspekte, Basel, Geneva, Munich, Helbing und Lichtenhahn, 1999.

Van Boven, T., The petition system under the International

Convention on the Elimination of all Forms of Racial Discrimination; A sobering balance-sheet, *Max Planck Yearbook of United Nations Law*, vol. 4, 2000.

Decaux, E., *Le Droit Face au Racisme*, Paris, Editions A.

Pedone, 1999.

English, K. and Stapleton, A., *The Human Rights Handbook:*

A Practical Guide to Monitoring Human Rights, Colchester, Human Rights Centre/University of Essex, 1995.

Human Rights Fact Sheet No. 7: Communications Procedures, Geneva, United Nations, 1989.

Human Rights Fact Sheet No. 12: The Committee on the

Elimination of Racial Discrimination, Geneva, United Nations, 1991.

International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination: full text and an unofficial

summary of the Convention's main provisions (revised version), Geneva, Anti-Racism Information Service,

1999.

Lerner, N., *The UN Convention on the Elimination of All*

Forms of Racial Discrimination, Alphen a.d. Rijn, Sijthoff and Noordhoff, 1980.

Manual on Human Rights Reporting, Geneva, United Nations, 1997.

Meron, T., The meaning and reach of the International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, *The American Journal of International Law*, vol. 79, 1985, pp. 283—318.

O'Leary, M., *Human Rights and the UN, Practice before the treaty bodies*, London, Sweet and Maxwell, 1996.

Partsch, K.J., The Committee on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination, in P. Alston (ed.), *The United Nations and Human Rights: A critical appraisal*, Oxford, Clarendon Press, 1992.

The First Twenty Years: Progress Report of the Committee

on the Elimination of Racial Discrimination, New York, United Nations, 1991, HR/PUB/91/4.

Gjetja e Dokumenteve dhe informatave në Internet

(ju lutemi ta shënoni se informatat e prezentuara në këtë publikim janë të sakta përfundimisht me datën 21 Korrik 2000, por janë të ndryshueshme)

United Nations

UN Office of the High Commissioner for Human Rights
<<http://www.unhchr.ch>>

A. (Choose) OHCHR programmes — conventional mechanisms

(*treaty-monitoring bodies*)

Committee on the Elimination of Racial Discrimination
<<http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/cerd.htm>>

¥ introduction

¥ Press releases

¥ sessions (State party reports, Concluding Observations)

since 50th session in March 1997

¥ individual complaints

<<http://www.unhchr.ch/html/menu2/8/art14.htm>>

¥ Overview of procedure

¥ Statistical survey of individual complaints considered

¥ Jurisprudence (selected decisions)

¥ Other communications/complaints procedures

Introduction — Fact Sheet 7: Communications Procedures

— (general information on various communication procedures)

¥ Model questionnaires for communications/complaints

B. (Choose) OHCHR programme documents

Treaty bodies database

<<http://www.unhchr.ch/tbsdoc.nsf>>

¥ Committee members

¥ Reporting status

¥ Status of ratification

¥ Documents by treaty

Committee on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination

¥ Jurisprudence

(communications considered under Art. 14)

¥ State party report

¥ Concluding Observations/comments

¥ Summary record

¥ Additional info from state party

¥ Sessional/annual report of Committee

¥ Basic reference document incl.

¥ General guidelines regarding the form and contents of reports to be submitted by states parties under Article 9, paragraph 1, of the convention

¥ Rules of procedure

¥ Other treaty-related documents

¥ Decision

¥ General comments

(General Recommendations)

¥ Provisional agenda

¥ Review of implementation

C. (Choose) treaties — International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination

(*under Prevention of discrimination*)

<http://www.unhchr.ch/html/menu3/b/d_icerd.htm>

Full text of ICERD

United Nations, Headquarters <<http://www.un.org>>

(Choose) International Law — Treaties — United Nations

treaty collections — Sample access

Status of Multilateral Treaties Deposited with the Secretary-

General <<http://untreaty.un.org/English/sample/EnglishInternetBible/bible.asp>>

(Choose) — Chapter IV (Human Rights) — International

Convention on the Elimination of All Forms of Racial

Discrimination <<http://untreaty.un.org/ENGLISH/bible/englishinternetbible/partI/chapterIV/treaty2.asp>>

Status of ICERD (list of states parties to ICERD, Reservations, Declarations made under

Article 14, etc.)

Article 14, etc.)

Others

Interights international law reports: On-line database engine on recent decisions of tribunals applying international

human rights law <<http://www.interights.org/search.asp>>

(Choose) ICERD under treaties / (choose) CERD under organs

Recent communications considered by CERD

Adresa të dobishme

United Nations

Kombet e Bashkuara

Office of the High Commissioner for Human Rights

Zyrra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut

Palais des Nations, CH-1211 Geneva 10, Switzerland

CERD Secretariat

CERD Sekretarijati

Office of the High Commissioner for Human Rights

Zyrra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut

Palais des Nations, CH-1211 Geneva 10, Switzerland

Tel. 41 22 917 9288

Fax. 41 22 917 9022

For UN official documents including states reports:

Për dokumente zyrtare të OKB-së, nënkuptuar edhe raportet shtetërore

Documents Distribution Office

Zyrra për Distribuimin e dokumenteve

Door 40, Palais des Nations

CH-1211 Geneva 10, Switzerland

Tel. 41 22 917 4712 or 4900

General enquiries:

Kërkesa të Përgjithshme

NGO Liaison Office,

Zyrra për lidhje me OJQ-të

Palais des Nations

Room 153, CH-1211 Geneva 10, Switzerland

Tel. 41 22 917 2127

Fax. 41 22 917 0583

To apply for NGO Consultative Status:

Për Aplikim për Status Konsultativ per OJQ-të

Section of NGO, Division of Economic and Social Council Support and Coordination

Sekcioni për OJQ-të Departamenti i Këshillit për të Drejta Ekonomike dhe Sociale dhe Koordinim

Department of Economic and Social Affairs

United Nations, Room DC1-1480

New York, NY 10017, USA

Tel. 1 212 963 4842

Fax. 1 212 963 9248

Website: <http://www.un.org/esa/coordination/ngo>

To order UN publications:

Për të porositur publikime të KB

United Nations Publications

Publikime të Kombeve të Bashkuara

2 United Nations Plaza

Room DC2-853, Dept. C001

New York, N.Y. 10017, USA

Tel. 1 212 963 8302 or 1 800 253 9646

Fax. 1 212 963 3489

E-mail: Publications@un.org

Or

ose

Sales Office and Bookshop,

Zyrra e shitjes dhe Libraria

Palais des Nations

CH-1211 Geneva 10, Switzerland

Tel. 41 22 917 2614 (orders),

2613 (enquiries regarding publications, orders),

2615 (subscriptions and standing orders)

Fax. 41 22 917 0084

United Nations Bookshop

Libraria e Kombeve të Bashkuara

Concourse Level, 46th Street and 1st Avenue

New York, NY 10017, USA

Tel. 1 212 963 7680 or 1 800 553 3210

Fax. 1 212 963 4910

Regional human rights bodies

Trupa rajonale për të Drejtat e Njeriut

Inter-American Commission on Human Rights

Komisioni Inter-Amerikan për të Drejtat e Njeriut

1889 F Street, NW, Washington, DC 20006 USA

Tel. 1 202 428 3967

Council of Europe

Këshilli i Europës

European Commission against Racism and Intolerance

(ECRI), Secretariat, Directorate of Human Rights

F-67075 Strasbourg CEDEX, France

Website: <http://www.ecri.coe.int>

African Commission on Human and Peoples Rights

Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të popujve

Kairaba Ave., PO Box 673, Banjul, The Gambia

Tel. 220 392 962;

Fax. 220 390 764

Information services (NGOs)

General assistance/information service for NGOs in regard to CERD:

Ndihmë e Përgjithshme/shërbime informative për OJQ-të

Në lidhje me CERD-in

Anti-Racism Information Service (ARIS)

Qendra Informative Anti-racistike

14, avenue Trembley, 1209 Geneva, Switzerland

Tel. 41 22 740 3530

Fax. 41 22 740 3565

E-mail: aris@antiracism-info.org

Website: <http://www.antiracism-info.org>

General assistance/information service for NGOs regarding any UN human rights bodies:

*Ndihmë e Pergjithshme/shërbime informative për
OJQ-të*
*Në lidhje me cilindo trup të KB-ve lidhur me të drejtat
e njeriut*

International Service for Human Rights
Qendra Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut
PO Box 16, 1 rue de Varembe
1211 Geneva, 20 CIC, Switzerland
Tel. 41 22 733 5123
Fax. 41 22 733 0826
Website: <http://www.ishr.ch>

Association for Democratic Initiatives (ADI) - Macedonia

Gostivar, B. Jovanoski St.61 Tel +389 42 22 11 00
Fax: +389 42 22 11 02
E-mail: adi@adi.org.mk
URL: <http://www.adi.org.mk>

Contact Albert Musliu Executive Director
albert@adi.org.mk
Shpend Imeri President
shpend@adi.org.mk

Skopje Pirinska St. 8/4 Tel/fax: +389 2 372 458
Contact: Nicci Lee
niki@adi.org.mk

Association for Democratic Initiatives (ADI) - USA

Contact: Dalip Turkeshi
2566 Ocean Avenue Suite 3
Brooklyn NY, 11229
tel: +1 718 207 9985
e-mail: dturkeshi@adi.org.mk

Association for Democratic Initiatives (ADI) Kosovo

Contacts: Sanita Jashari
Mother Teresa Blvd. 48/12
38000 Prishtina, Kosova
Cell +377 44 173 232
E-mail sanita@adi.org.mk

Association for Democratic Initiatives (ADI) Albania

Contact: Albana Qatipi
Him Koli, No. 45
Tirana, Albania
T/F +355 42 32 739
E-mail albanaqatipi@hotmail.com



E-mail: adi@adi.org.mk

URL: <http://www.adi.org.mk>



Asociacioni për Iniciativa Demokratike-ADI është organizatë rajonale, joqeveritare, jopartiake dhe joprofitabile. ADI është themeluar më 1994 me qëllim të promovimit të shoqërisë civile, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe zhvillimit.

ADI aktivitetet e veta i realizon përmes programeve për:

Edukimi i qytetarëve dhe votuesve

Programi për edukim të qytetarëve dhe votuesve është me shumë nivele dhe përveç komponentës educative ka edhe atë të kyçjes së qytetarëve në proceset e demokratizimit të shoqërisë si dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendosjes. Programi ka për qëllim afrimin e qytetarëve dhe njoftimin e tyre të përafërt me qëllim të qasjes së tyre më aktive në procesin e sjelljes së vendimeve që kanë të bëjnë me jetën e përditshme.

ADI ka trajnuar më tepër se 500 vulnetarë për vëzhgim të zgjedhjeve lokale, parlamentare dhe presidenciale në vitet 1994, 1996, 1998 dhe 1999. Në vitin 1996 ADI e organizoi debatin e parë publik të kandidatëve në Maqedoni me pjesëmarrje të më shumë se 600 qytetarëve, ADI poashtu ka organizuar anketime të shpeshta të opunioneve publike si dhe shumë tubime të qytetarëve.

Programi për zhvillim të marrëdhënieve ndëretnike

Ky program ka për qëllim të kultivojë dhe zhvillojë shoqërinë multikulturore si dhe komponentë për zgjedhjen dhe preventivën e konflikteve, ndërmarjen e masave për besim të ndërsjellë midis anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike, fetare dhe gjuhësore në Maqedoni. Programi realizohet me ndihmën e edicioneve dhe studimeve që theksojnë ngajshmëritë para dallimeve që ekzistojnë midis grupeve të ndryshme etnike, fetare dhe gjuhësore në Maqedoni dhe mundësitë për bashkëjetesë paqësore dhe tolerancë.

Qendrat e resurseve për OJQ-të dhe iniciativat qytetare

ADI ka hapur tre Qndra të resurseve në Tetovë, Gostivar dhe Shtip. Qendrat ofrojnë kurse të gjuhëve të huaja dhe punë me kompjutorë si dhe ndihmë juridike falas për OJQ-të dhe individë, grupe dhe iniciativa qytetare. OJQ-të në zhvillim mund që, pa kompenzim, të përdorin mjetet teknike dhe premisat e qendrave. ADI ofron ndihmë dhe përfaqësi juridike falas për grupe të marginalizuara të qytetarëve.

Të drejtat e njeriut

Programi për të drejtat e njeriut nënkupton:

- Mbledhjen e informative për respektimin e të drejtave të njeriut. Organizimi i seminareve dhe punëtorive të ndryshme. Për zhvillim të teknikave për mbledhje të këtyre informatave,
- Kompletimi i raporteve për implementimin e konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në lëminë e të drejtave të njeriut
- Mbrojtjen dhe ngritjen e vetëdijes për respektimin e të drejtave të njeriut në pajtueshmëri me dokumenta dhe marrëveshje të lëmisë së të drejtave të njeriut si dhe njohtimin me mekanizma dhe institucione të ndryshme ndërqeveritare për mbrojtjen e tyre
- Organizimi i seminareve dhe punëtorive në lëminë e të drejtave të njeriut në përgjithësi si dhe në lëminë e të drejtave të grave, fëmijëve dhe minoriteteve
- Shtypja dhe distribuimi i raporteve, librave dhe botimeve tematike në lëminë e të drejtave të njeriut
- Pjesëmarrje në rrjete të ndryshme ndërkombëtare të OJQ-ve në lëminë e të drejtave të njeriut

Programi për të rinjtë

Programi për të rinjtë është i disajnuar me qëllim të kyçjes së tyre në aktivitete siç janë sporti, gjuhët e huaja, muzika, arti, literaturata dhe aktivitete tjera me interes për të rinjtë, me qëllim të kultivimit të ndjenjave për miqësi, jetë shoqërore, dallime, tolerance, kreativitet etj. Këto aktivitete implementohen në dy mënyra:

- Edukativ – përmes dhënies së kurseve në gjuhë të huaja dhe kompjutorë, me qëllim të rritjes së aftësive të tyre komunikuese, konkurrencën si dhe programe për këmbim të studentave dhe nxënësve
- Psiho-social, përmes organizimit të aktiviteteve rinore në lëminë psiho-social si dhe në lëminë e artit, sportit, muzikës, teatrit dhe aktivitete tjera.